

DETAJET E DARKES ME GAZETARET

PROMOVIMI I LIBRIT/ Alastair Campbell: Si u njoha me kreun e PS, takimi me Fugën

KESHILLTARI I RI I RAMES

ZEDHENESI I BLAIR, PUNON ME PS

Pyetjet për fyerjet e Berishës në parlament për nënën dhe babain e Edi Ramës. Vlerësimi i zëdhënësit të Blair: Unë jam i majtë. Si po punon PS me laboristët për sondazhet parazgjedhore

▶ Faqe 5

PROGRAMI

▶ Faqe 7

Servet Pëllumbi: OK fryma dhe ekipi i ri në PS

ZBULOHET SEKRETI

▶ Faqe 21



"Big Brother", Zhigoloja? Është Marselino...

ITALIA VOTON

▶ Faqe 12-13

Fiton mosqeverisja Surpriza Grillo, e majta më shumë vota



Në foto: Takimi i djeshëm i Edi Ramës me Alastair Campbell, ish-zëdhënësi i Tony Blair me Edi Ramën gjatë promovimit të librit, botim i UET

Koment



NGA AFRIM KRASNIQI

Oferta (a)morale e pushtetit

Partia më e madhe e qeverisë, PD, e ka shprehur synimin e saj për një mandat të tretë, me çdo kusht dhe mjet, pa dilema dhe pa droje morale apo etike. Më 2009 ajo zgjodhi LSI si partner kryesor për të krijuar dhe mbetur në qeveri, më 2011 ajo zgjodhi Partinë Komuniste ai aleate për të fituar Bashkinë e Tiranës dhe tani, kur tetë vitet e pushtetit janë në ikje dhe bilanc negativ, po kërkon skema të reja a(morale) për të mbetur në pushtet. Dy ditët e fundit tre deputetë të PD, një nga të cilët është eksponent kryesor në ekipin drejtues të saj, mbështetën në media idenë e një koalicioni të madh paszgjedhor midis Partisë Demokratike dhe Partisë Socialiste. Alibia mbetet e njëjtë si më 2009: për hir të interesave të qytetarëve dhe të vendit.

Që në Shqipëri të ketë bashkëqeverisje midis PD e PS jemi mësuar disa herë gjatë tranzicionit. më 1991 dy palët krijuan qeveri të përbashkët, më 1992 qeveria teknike ishte fryt i përbashkët, më 1997 dy palët përsëri sollën në jetë koalicionin e madh, më 1998 perëndimi dhe Kosova imponuan disa muaj paqe, më 2002 dy palët patën 6-7 muaj mjalti në bashkëqeverisje, më 2008 dy palët ndryshuan së bashku kushtetutën dhe sistemin politik. Kanë qenë së bashku sa herë bëhet fjalë për interesa politike të ditës, gjatë hartimit dhe miratimit të Kodeve Zgjedhore, gjatë ndarjes së vendeve në KKRT apo në Bankën e...

▶ vijon në faqe 20

ARRESTOHEN AUTORET

Fjalët e fundit të Komisarit: Më vranë, ndihmomëni!

Gruaja e Dritan Lamajt e sëmurë, do operohej në mars

TIRANE

ELONA ELEZI

Pak orë pas ekzekutimit mafioz të kryekomisarit Dritan Lamaj, dëshmitarët okularë në vendin e ngjarjes zbardhën një sërë detajesh për Shqiptarja.com. Ata rrëfejnë, se si përfundoi gjithçka brenda 30 sekondash, si u realizua prita ndaj 41-vjeçarit Lamaj...

▶ Faqe 2-3



Dritan Lamaj



Grand Froku



Arben Froku



SEKRETET

▶ Faqe 16-17

Hazbiu- Kapos në '70: Janë shtuar vetëvrasjet

NERANXI

... gjithmonë një hap përpara...

Lëndë të para për restorante, piceri, kreperi dhe fast food.



Rama

"Është e treta herë që në një kohë jashtë mase të shkurtër, ne vijmë këtu për t'i dhënë lamtumirën një shërbëtori të shtetit, një komisar; e treta viktimë që tregon se krimi e ka vënë përfund shtetin; e treta dëshmi ulëritëse për të kthyer shtetin në krye të detyrës



Berisha

"Ky akt kriminal e barbar do të marrë të gjithë ndëshkimin e merituar ligjor. Qeveria do të mobilizojë çdo burim, çdo mundësi që autorët e këtij akti të shëmtuar të përballen me drejtësinë e rreptësinë e ligjit shqiptar. Ngushëllimet më të thella për të gjithë."



Topi

"Shpreh publikisht shqetësimin e thellë për rritjen e nivelit të kriminalitetit, si dhe dështimin e organeve përgjegjëse për parandalimin e akteve të tilla. Drejtuesit duhet ta kuptojnë, se nuk janë aty për të bërë retorika politike, por për të përbushur detyrimin e tyre".

Në lagjen e komisarit, morti në shtëpi dhe "heshtja"

Fjalët e fundit: Më ndihmoni, më vranë...

"Si u masakrua para nesh Dritan Lamaj"

Lajmi

Pak orë pas ekzekutimit mafioz të kryekomisarit Dritan Lamaj, dëshmitarët okularë në vendin e ngjarjes zbardhën një sërë detajesh për Shqiptarja.com. Ata rrëfejnë, se si përfundoi gjithçka brenda 30 sekondash, si u realizua prita ndaj 41-vjeçarit Lamaj dhe si u tmerruan banorët e zonës.

TIRANE

ELONA ELEZI

Njerëz me çadra në duar dhe fytyra të trishta. Gra të veshura me të zeza fund e krye dhe burra që pijnë duhan në heshtje e që përpiqin të fshihin sytë e përplotur. Ora shënon 11:40. Në rrugën "Petro Korçari" në Tiranë, një makinë funerale ka bllokuar hyrjen e një pallati, në portën e jashtme të të cilit janë rreshtuar familjarë e miq të Dritan Lamaj, kryekomisarit të masakruar me një breshëri plumbash Kallashnikov mbrëmjen e së dielës, 12 korora me lule dhe dhjetëra buqeta me krizantema, karafllë të kuq dhe të bardhë. Anila, bashkëshortja e Dritanit, mbahet fort nga krahët nga gra të tjera të familjes, pasi rrezikon të humbë ndjenjat nga çasti në çast. E ëma dhe e motra vënë kujën, duke vajtur humbjen e djalit dhe të vëllait. Miq dhe shokë mbajnë sytë ulur, për t'u shkëputur sado pak nga gjendja e nderë e ceremonisë mortore, e cila është në momentet e para të nisjes së saj. Ora 11:45. Makina funebre largohet me trupin e pajetë të Dritanit, të bërë shoshë nga plumbat e një nate më parë. "E kanë veshur me kostum", rrëfen një grua mes lotëve. "Djali i nënës, ezhdukën..." - thotë me mllaf gruaja e moshuar, e cila ikën nga sytë këmbët. E tekta makina dhe njerëzit largohen, në lagjen e policit të vrarë, frika dhe dyshimet nga mendja dhe shpirti i fqinjëve nuk janë larguar ende. "Shqiptarja.com ka mundur të sigurojë disa dëshmi të njerëzve që janë ndodhur aty ku u vra dy ditë më parë, ish-Shefi i Komisarariatit nr.6.

DËSHMIA E PARË

"Nga të shtënat u tmerruan të gjithë. Patëm shumë



Skema e ndërtuar nga të dhënat e grupit hetimor

Familja

Gruaja e kryekomisarit me probleme të rënda shëndetësore

Kryekomisar Dritan Lamaj, i datëlindjes 05.04.1972, lindur në Tepelenë, me arsim të lartë, ishte i martuar dhe kishte një vajzë 11-vjeçare. Lamaj është titulluar officer policie dhe pranuar në strukturat e Policisë së Shtetit, në vitin 1995 në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Gjirokastrë. Ka shërbyer në strukturat e Policisë së Shtetit nga viti 1995 deri në vitin 2013. Gjatë kësaj periudhe ka kryer detyra të ndryshme në strukturat e policisë së Komisarariatit të Policisë së Gjirokastrës, Vlorë dhe në Komisarariatet e Policisë Tiranë. Nga 01.11.2012, ka kryer detyrën e specialistit, në Departamentin për Sigurinë Publike në



(në rreth) Gruaja e Dritan Lamaj

frikë. Klientët u shtrinë barkas. Unë jam futur poshtë banakut, që të mbrohesha". Kështu e nis rrëfimin një grua, e cila punon në një nga lokalet në rrugën "Petro Korçari", i cili ndodhet vetëm pak metra larg vendit ku të dielën qëndronte i parkuar automjeti tip "Lancia" i Dri-

tan Lamaj. Ajo, ashtu si dhe të gjithë personat me të cilët kontaktoi Shqiptarja.com, duan të mbeten anonimë. Janë të frikësuar tej mase

nga vrasja. Flasin mirë për Tanin, siç preferojnë t'a quajnë. Por nuk duan të pranojnë se ai ka vdekur. Ajo rrëfen, se e gjitha çka mban mend nga krimi, është zhurma e Kallashnikovit, për të cilën thotë se nuk do të mund t'a harrojë dot kurrë. "Ishte zhurmë e

PYETJE PERGJIGJE

■ Kur u ekzekutua Dritan Lamaj?

Kryekomisar Dritan Lamaj u qëllua me Kallashnikov rreth orës 18:20 të datës 24 shkurt. Plumbat me breshëri dolën nga një automjet BMW, ku dy autorët e dyshuar i kishin zënë pritë Lamaj në lagjen ku 41-vjeçari banonte.

■ Me sa plumba u qëllua Dritan Lamaj?

Në vendngjarje ekspertët kriminalistë gjetën vetëm 4 gëzhoja, por dyshohet se autorët qëlluan nga brenda makinës, dhe pjesa më e madhe e plumbave ka mbetur brenda BMW-së së autorëve. Dyshohet se drejt Lamaj u qëllua plot 26 herë.

■ Kush u arrestua në lidhje me ngjarjen?

24 orë pas ngjarjes, Policia e Shtetit tha zyrtarisht se u prangosën Arben Firroku dhe Jakë Jaku, si autorë të dyshuar të ngjarjes. Ata u kapën në Selanik të Greqisë.

tmerrshme. Për disa minuta kemi qëndruar të fshehur në lokal" - përfundon ajo.

DËSHMIA E DYTË

Një djalë rreth të 20-ave, i cili ka në pronësi një biznes në zonën ku ndodhi vrasja, thotë: "Tani (Dritan Lamaj) edhe kur dilte në lagje, nuk rrinte më shumë se 5 ose 10 minuta në kafe. Largohej shpejt. Kohë e fundit dukej i qetë, sikur nuk kishte asnjë shqetësim. Por kur ka qenë shefi Komisarariatit nr.6, mbante shoqëruar me vetë dhe lëvizte me makinë policie. Madje në lagje vinte dhe një furgon policie që patrullonte rregullisht. Men-



NË FOTO: Ekspertët në vendin e ngjarjes

doj se autorët i kanë ditur të gjitha lëvizjet e Tanit. Pse erdhën pikërisht të dielën, dhe jo në ditë javë? Sepse e kanë ditur shumë mirë që lagja është thuhet bosh të dielën. S'ka këmbë njeriu" - thotë i riu.

DËSHMIA E TRETË

Një tjetër person që ka dëgjuar të shtënat dhe është gjendur shumë pranë tyre, është edhe një vajzë e cila zotëron një biznes thuhet ngjitur me vendin ku ishte parkuar makina atë natë. Ajo shpjegon se gjithçka ka ndodhur brenda 30 sekondash. "Dëgjova breshërinë e parë. Pati pak pauzë dhe pastaj u dëgjua breshëria më e fortë dhe më e gjatë. Jam mbyllur në banjon e biznesit tim dhe nuk kam dalë që aty, derisa erdhi policia dhe i sqarova çfarë pashë. Kanë qenë dy djem me maska, të cilët janë larguar më pas me makinë. Dëgjova që Tani (Dritan Lamaj) ka mundur të dalë nga makina dhe ka thirrur "Më ndihmoni. Më vranë...". Vajza shpjegon se policia ka mbërritur shumë vonë në vendngjarje, dhe se të pranishmit nuk kanë mundur të dalin nga vendet ku ndodheshin, kryesisht në kafenet e zonës, për shkak të frikës. Ajo tregon edhe për personin që u pretendua se i kishte prerë rrugën Lamaj. "Ka qenë një djalë jo më shumë se 15-16 vjeç. Shpërndarës p-cash. Është trembur aq shumë i shkrei, sa kur dolëm të shohim ç'kishte ngjarë dhe i hodhëm ujë se ishte trembur, na pyeste nëse ishte mirë dhe nëse kishte plumba në trup" - rrëfen vajza.



Halimi

Sërish një krim i rëndë, i ndodhur mbrëmë. Krimi goditi sërish duke vrarë një komisar policie, e duke goditur në fakt gjithë policinë. Ata që qëlluan mbi komisar Lamajn, dhe të gjithë ata që guxojnë të qëllonin mbi policinë, nuk duhet të dënohen më pak se 38 vjet burgim



Braçe

"Berishës i kanë dalë vrasësit jashtë kontrollit. Ka ndodhur një vrasje. Eshtë vrarë një kryekomisar në Polinë e Shtetit. Njëri pas tjetrit, që pas 2009-tës, kohë kur pushteti vendosi marrëdhënie të drejtpërdrejta me krimin për të vjedhur zgjedhjet, nuk numëroj dot sa policë janë vrarë.



Noka

"Kjo humbje na ka pikëlluar të gjithëve. Policia e Shtetit, gjithë efektivet e saj, janë më të vendosur se kurrë për të goditur krimin dhe çdo element kriminal, në ruajtje të rendit publik. Ju garantoj se kriminelët do të përballen me gjithë forcën e ligjit".



ARRESTIMI DJE/ Policia: Arben Frroku e Jak Jaku u kapën në Selanik

TIRANE

Telefonata me Greqinë tradhëtoi biznesmenin

6 muaj më parë kryekomisari rrahu 44-vjeçarin

Fiks 24 orë pas ekzekutimit me kallashnikov të kryekomisarit Dritan Lamaj, Policia e Shtetit tha zyrtarisht, se u arrestuan dy autorët e dyshuar të vrasjes. Arben Frroku, 44 vjeç dhe Jak Jaku, 31, u ndaluan në Selanik të Greqisë, për llogari të policisë shqiptare. Gjatë hetimeve u arrestua edhe 21-vjeçari Ndrek Jaku, i cili u kap me një arsenal armësh dhe sasi kokaine e heroine. Pasditën e së hënës policia gjeti në Domje edhe automjetin tip "BMW" ngjyrë gri, me të cilën dyshohet se udhëtuan autorët e krimit.



Dritan Lamaj

Zanafilla



I arrestuari, Arben Frroku

Konfliktet mes dy ish-miqve, nga sherret te dhuna fizike

Më 25 shtator të vitit 2012, biznesmeni Arben Frroku denoncoi zyrtarisht përplasjen me shefin e Komisarariatit Nr.6 të asaj kohe, Dritan Lamajt. Pronari i disa prekur lokaleve me logon "Xhoi Loto", "Inkas Kafë" si dhe aksioneri i klubit sportiv "Tërbuni", denoncoi në "Qendrën për Drejtësi dhe Solidaritet", se Lamaj i kishte bërë shantazh në 14 mars të po atij viti. Dikur miq të pandarë, Lamaj dhe Frroku ishin kthyer në armiqtë e përbetuar për gjatë dy viteve të fundit. Në pretendimet e Frrokut gjatë muajit shtator, u tha se gjithçka e kishte zanafilla më 14.03.2012. Ai tha, se po shkonte familjen rreth orës 12:00 të asaj dite në biznesin e tij në Kombinat, në portën hyrëse të të cilit kishte parë një makinë policie, e cila i kishte bllokuar hyrjen. Frroku pretendonte, se punonjësit policorë i kishin thënë që t'i ndiqte për në ambientet e Komisarariatit Nr.6, ku atë

HETIMET

Nga hetimet e deritanishme të grupit hetimor, është konkluduar se automjeti tip "Lancia", në të cilin gjendej edhe kryekomisar Dritan Lamaj, ka qenë i ndaluar përpara bllokut të lokaleve në afërsi të banesës së 41-vjeçarit. Autorët, të cilët kanë qenë në ndjekje të tij përgjatë gjithë kohës, janë afuar nga pas me automjetin tip "BMW" ngjyrë gri me targa të Durrësit, DR 1944 F. Makina e tyre ka ndaluar nga ana e drejtuesit të automjetit, Lamajt, dhe njëri prej autorëve ka qëlluar në drejtim diagonal majtas, drejt shenjestrës së tij, duke qëlluar me breshëri plumbash. Burime të besueshme policore bënë të ditur se në vendin e ngjarjes policia gjeti dhe sekuestroi vetëm 4 gëzhoja arme zjarri të llojit Kallashnikov. Edhe pse dëshmitarët okularë deklaruan gjatë marrjes në pyetje se kishin dëgjuar dy breshëri të njëpasnjëshme armësh, fakti se u gjetën vetëm 4 gëzhojat, përforcoi dyshimet, se autorët kishin qëlluar nga brenda automjetit të tyre dhe pjesa më e madhe e gëzhojave kishin rënë aty. Nga ekspertimet në vendin e ngjarjes ka rezultuar, se në drejtim të kryekomisarit është qëlluar 26 herë dhe 12 nga plumbat kanë prekur organet jetësore të Lamajt, i cili dyshohet të jetë struktur në makinë në momentet kur

TIMS

Sipas të dhënave të sistemit policor TIMS, Arben Frroku dhe Jakë Jaku, dy autorët e dyshuar të ekzekutimit, kanë kaluar në pikën e kalimit kufitar të Kapshticës në orën 21:24.

kanë filluar të shtënat. Pjesa më e madhe e plumbave të Kallashnikovit i kanë prekur zemrën dhe veshkat.

ARRESTIMET

Mbrëmjen e djeshme, Policia e Shtetit deklaroi zyrtarisht se arrestoi autorët e dyshuar të ngjarjes, Arben Frrokun, 44 vjeç, dhe Jak Jakun, 31 vjeç. Sipas zëdhënësit të policisë, pas shkëmbimit të informacioneve me policinë greke, dy personat e dyshuar u kapën në Selanik të Greqisë. Nga burime të sigurta policore mësohet se në bazë të të dhënave të marra nga sistemi TIMS, ata kanë kaluar kufirin në orën 21:24 të ditës së dielë. Burimet thonë, se Frroku është "tradhtuar" nga telefoni celular, ku gjatë një telefonate pas ngjarjes, ai ka telefonuar një të njohurin e tij në Greqi,

ku e vinte në dijeni se po nisej për andej. Zyrtarisht policia tha se, u arrit në konkluzionin se vrasja e kryekomisarit Dritan Lamaj ishte kryer nga autorët e dyshuar për shkak të detyrës së punonjës policie. Po sipas deklaratës publike të Policisë së Shtetit, gjatë ditës së djeshme u ushrua kontroll në banesat e autorëve të dyshuar, ku në banesën e Jakë Jakut dhe Ndue Jakut u gjetën: një snajper, dy armë zjarri kallashnikov, një pistoletë tip "Bereta", 2 armë gjahu dhe një sasi e konsiderueshme fishekësh e municionesh të llojeve të ndryshme. Gjithashtu në të njëjtën banesë agjentët policorë gjetën dhe sekuestruan 529 gram heroinë, 396 gram kokainë dhe 35 gram marijuanë. Pas kontrollit policia arrestoi 21-vjeçarin Ndue Jakun.

Makina



BMW e vjedhur në Durrës, u gjet në Domje

Përgjatë së premtes së kaluar, Fatmir Lila nga Durrësi, kishte denoncuar në Komisarariatin e këtij qyteti vjedhjen e automjetit të tij "BMW" ngjyrë gri me targa të Durrësit, DR 1944 F. Nga përshkrimet e bëra të dëshmitarëve okularë që panë ekzekutimin e Lamajt, të dhënat përputheshin me makinën me të cilën kishin lëvizur autorët gjatë kryerjes së krimi. Një ditë pas ngjarjes, në fshatin Domje të Tiranës, policia gjeti të braktisur dhe pa targa, automjetin tip "BMW", i cili u sekuestrua në cilësinë e provës materiale.



Muçmataj zyrtarisht kandidat i PS, Nishani e liron si prokuror

Konfirmohet përfundimisht kandidimi i Prokurorit Vexhi Muçmataj për deputet në Kuvendin e Shqipërisë, nën siglën e PS ashtu sikurse e kishin lajmëruar ditë më parë një pjesë e mediave, mes të cilave dhe gazeta jonë. Lajmin e ka zyrtarizuar përfundimisht Presidenti i Republikës Bujar Nishani, i cili përmes dekretit presidencial firmos largimin nga detyra të Muçmataj

me kërkesën e këtij të fundit. Kështu me dekret Nr.7955, datë 19.2.2013 me siglën për largim prokurori dhe në mbështetje të nenit 149 pika 3 të Kushtetutës si dhe të nenit 8 pika 2 germa "c" dhe të nenit 27 pika 1, germa "a" të ligjit nr.8737, 12.2.2001 "Për organizimin e funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozim të Prokurorit të Përgjithshëm

Presidenti ka deklaruar se "dekretoj që zoti Vexhi Muçmataj prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me kërkesën e tij, të largohet nga kjo detyrë". Dekret ky që ka hyrë në fuqi menjëherë duke i hapur në këtë mënyrë udhë në mënyrë dhe ligjore kandidimit të Vexhi Muçmataj si deputet në listën rajonale të qarkut të Kukësit në zgjedhjet parlamentare të 23 qershorit të këtij viti.

Konstucionalisti i njohur thotë se s'lejohen zgjedhje me ndarjen e vitit 2009

Jaho: Jokushtetuese ndarja e mandateve nga Kuvendi

"Vetëm në zgjedhjet e parakohëshme s'rishikohet ndarja"

Lajmi

Konstucionalisti Njazi Jaho është kundër vendimit të Kuvendit për lënien në fuqi të ndarjes së mandateve sipas vendimit të 2009. Për të është antikushtetuese sepse shkelet Kodi, por dhe Kushtetuta në parimin e barazisë së votës për gjithë qytetarët.



Vendimi

"Sipas nenit 76, pika 3 të Kodit Zgjedhor "numri i mandateve për çdo zonë zgjedhore nuk rishikohet në rast të zgjedhjeve të parakohëshme". Dispozita e mësipërme është e qartë dhe e prerë, që do të thotë se numri i mandateve duhet të rishikohet kur ka zgjedhje të zakonshme".

NË FOTO: Njazi Jaho

■ ■ ■ TIRANE
JAKIN MARENA

Konstucionalisti Njazi Jaho në një intervistë për gazetën "Shqiptarja.com" thotë se ligji nuk parasheh që të bëhen zgjedhje me ndarjen e zonave zgjedhore dhe mandatet e mëparshme, në rastin konkret me afat të 2009. Ndaj cilësohet si antikushtetues vendimi i Kuvendit që lë në fuqi ndarjen e 2009 të mandateve. Ai thotë se një gjë të tillë ndodh vetëm në rast zgjedhje të parakohëshme.

Kuvendi ka vendosur që numri i mandateve për çdo zonë zgjedhore në zgjedhjet e 23 qershorit 2013 të mbetet po ai i zgjedhjeve të 2009. Në aspektin ligjor, e cilësoni të bazuar këtë vendim?

Para se t'i përgjigjem pyetjes, e shikoj të nevojshme të përmend se, lidhur me caktimin e mandateve për çdo zonë zgjedhore janë shprehur publikisht fill pasi KQZ nuk arriti kuorumin e nevojshëm për miratimin e kësaj ndarjeje, që pasoi kërkesën e administratës së KQZ drejtuar Kuvendit. Jam shprehur pikërisht më datën 18 janar 2013. Në atë kohë mendoja se Kuvendi s'duhej të angazhohej me shqyrtimin e kësaj çështjeje, sepse KQZ kishte mundësi dhe kohë për t'ju rikthyer këtij diskutimi dhe të arrinte konsensusin e nevojshëm (kam parasysh se "vendimi" me 4 vota pro nuk duhet i miratuar. Kjo thuhet

shprehimisht në ligj. Në këtë vështrim nuk kishte asnjë dispozitë ligjore që të ndalonte KQZ t'i rikthehej shqetësimit të çështjes së mësipërme).

Fakti është se Kuvendi vendosi...?

Po. Ky është fakt, megjithëse të them të drejtën nuk di si

"Vendimi i Kuvendit bie ndesh jo vetëm me nenin 75 dhe 76 të Kodit Zgjedhor por çënon parimet kushtetuese për një proces të rregull ligjor dhe barazinë e votës"

është argumentuar që caktimi i numrit të mandateve për çdo zonë zgjedhore të ngelej po ai që ishte miratuar në

zgjedhjet parlamentare të vitit 2009. Kam mendimin se vendimi i Kuvendit nuk është as i ligjshëm dhe as i bazuar, sepse sipas nenit 76, pika 3 të Kodit Zgjedhor "numri i mandateve për çdo zonë zgjedhore nuk rishikohet në rast të zgjedhjeve të parakohëshme". Dispozita e mësipërme është e qartë dhe e prerë, që do të thotë se numri i mandateve duhet të rishikohet kur ka zgjedhje të zakonshme (jo të parakohëshme). Neni 76, pika 3 nuk lë shteg për interpretime. Veç kësaj në Kodin Zgjedhor, nuk ka ndonjë nen ku të thuhet se në rastet kur KQZ-ja nuk arrin të miratojë caktimin e numrit të mandateve për çdo zonë zgjedhore, Kuvendi mund të vendosë lënien në fuqi të numrit të mandateve të caktuar në zgjedhjet e zakonshme të mëparshme.

Po në rastin më të keq, ndoshta të jashtëzakonshëm, KQZ nuk do të arrinte deri në fund të miratonte vendimin për caktimin e zonave, sipas jush si duhej të vepronte Kuvendi?

Në këtë rast mendoj se kompetent për çbllokimin e gjendjes së krijuar duhet të ishte Kuvendi, por jo duke miratuar numrin e caktimit të mandateve që u zbatuan në vitin 2009, por duke e shqyr-

Çlirim Gjata:

"Mandatet, Kushtetuesja shqyrton ndarjen pasi flet gjykata më e ulët"



Çlirim Gjata

Ish-kreu i KQZ-së, Çlirim Gjata, deklaroi se bazuar në nenin 131 të Kushtetutës, Gjykata nuk mund ta marrë në shqyrtim këtë ankesë të PS-së. "E vetmja pikë ku parashikohet ndarja e mandateve nga Parlamenti është në Kodi. Atëherë duke qenë një çështje thjesht zgjedhore, a duhet t'i drejtohet Kolegjit? Po të marrim nenin 131 të Kushtetutës, në asnjë nga gërmat e këtij neni, po ta marrim si objekt kushtetues padie, s'bën pjesë kjo lloj padie kundër këtij vendimi të Parlamentit sepse parashikohet në Kodin Zgjedhor për punë tjetër. I vetmi moment është germa F, ku thotë: Gjykimi përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljet e drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregull ligjorë, pasi të jenë shterur të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave", u shpreh Gjata për mediat kohë më parë.

tuar çështjen në themel d.m.th në mbështetje të materiale dhe të dhënave që Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes civile i kishte dërguar Kuvendit dhe në zbatim të kritereve ligjore të parashikuara në nenin 75 të Kodit Zgjedhor. Në fund të fundit dhe vendimi që mund të merrte KQZ për këtë çështje do ishte propozim për Kuvendin sepse përfundimisht ishte Kuvendi që do të vendoste.

PS i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese kundër vendimit të mësipërm të Kuvendit, se e konsideron atë antikushtetues. Çfarë mendoni për këtë këtë?

Sipas nenit 134 pika 1 germa "F" të Kushtetutës, partitë politike kanë të drejtë të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për çështje që lidhen me interesat e tyre në radhë. Ka raste që jo më pak se një e pesta e de-

putetëve mund t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese. S'jam në dijeni të përmbajtjes së kërkesës drejtuar Gjykatës Kushtetuese. Megjithëkëtë, kam mendimin se çështja e caktimit të numrit të mandateve për çdo zonë zgjedhore ka të bëjë me barazinë e votës. Në këtë vështrim mendoj se vendimi i Kuvendit bie ndesh jo vetëm me nenin

"Kompetent për çbllokimin e gjendjes së krijuar duhet të ishte Kuvendi, por jo duke miratuar numrin e caktimit të mandateve që u zbatuan në vitin 2009", tha Jaho.

75 dhe 76 të Kodit Zgjedhor por çënon parimet kushtetuese për një proces të rregull ligjor dhe barazinë e votës (neni 42, pika



1 dhe neni 45 pika 3 e Kushtetutës). Ai bie ndesh gjithashtu dhe me pikën 3 të nenit 1 të Kushtetutës ku thuhet se "qeveria bazohet në një sistem zgjedhesh të lira, të barabarta, të përgjithshme dhe periodike". Në kodin e Praktikës së mirë, në çështjet zgjedhore miratuar në vitin 2002 nga Komisioni i Venecias, midis të tjerave theksohet se "Parimet që duhen respektuar në të gjitha rastet janë të barazisë në votën numerike, barazia përsa i përket fuqisë elektorale dhe mundësisë të barabarta (botim shqip fq.17). Lidhur me këtë çështje është shprehur qartë dhe Kushtetuesja (shih vendimet e saj, nr.1 datë 7.01.2005 e nr.32 datë 21.06.2010).

Ka mendime se PS apo grupi i saj parlamentar, për të kundërshtuar vendimin e Kuvendit duhej t'i drejtohej Gjykatës së zakonshme dhe jo gjykatës Kushtetuese. Mendimi juaj?

Megjithëse nuk jam në dijeni të këtyre mendimeve dhe si pasojë dhe të argumenteve që janë paraqitur në këtë drejtim, jam i mendimit se një problem i tillë nuk është në juridiksionin as të Kolegjit Zgjedhor të Gjykatës së Apelit që është folur më parë) dhe as të gjykatave të tjera të zakonshme.

Lidhur me këtë çështje çfarë qëndrimi mund të mbahet nga Gjykata Kushtetuese?

Aspekti ligjor i trajtimit të çështjes nuk lejon supozime apo paragjykimë se çfarë qëndrimi mund të mbajë Gjykata Kushtetuese. Ajo i nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe kur është rasti bën interpretimin përfundimtar të saj.



Panariti lobim për Shqipërinë në Këshillin të Drejtave të Njeriut e të Drejtave të njeriut

Ministri i Jashtëm Edmond Panariti është duke marrë pjesë në punimet e segmentit të lartë të sesionit të 22-të të Këshillit të të Drejtave të Njeriut, organ i OKB-së, në Gjenevë. Krahas punimeve të këtij aktiviteti, kreu i diplomacisë së jashtme shqiptare, Panariti do të zhvillojë takime në kuadrin e lobimit për kandidaturën e Shqipërisë në këtë organ për periudhën 2015-2017. Gjithashtu, ai do të

takohet me Komisioneren e Lartë për të drejta e njeriut, znj. Pillay, si dhe me Drejtorin e Përgjithshëm të Zydrës së OKB-së në Gjenevë, z. Tokayev. Më herët ministri është takuar me presidentin gjerman Joackim Gauck, ku u vlerësua vizita e ministrit të jashtëm gjerman në Shqipëri, Guido Westerwelle. Ministri Panariti e falenderoi Presidentin gjerman për mbështetjen që Gjermania i ka dhënë

Shqipërisë në drejtim të zhvillimit ekonomik dhe integritimit në strukturat euro-atlantike. Presidenti Gauck përshëndeti progresin që ka shënuar Shqipëria vitet e fundit dhe konfirmoi vullnetin e Gjermanisë për të forcuar bashkëpunimin dypalësh dhe mbështetur Shqipërinë në rrugën e integritimit evropian. Më pas ai u takua dhe me Ministrin britanik të Shtetit, baroneshën Sayeeda Warsi.



Konventa PS

Fransua Holland letër Ramës: Bashkë kundër konservatorizmit

Presidenti francez, Fransua Holland, nëpërmjet një letre uron Partinë Socialiste lidhur me Konventën 2 ditore si dhe shpalojten e programit politik të kësaj partie. "I dashur Edi, më 22 dhe 23 Shkurt 2013 PS është duke u mbledhur në një Konferencë Kombëtare, që do zbulojë Manifestin "Një Program i Ri për një Rilindje Shqiptare". Kjo Konferencë vjen tamam në kohë si një arritje tepër e rëndësishme përpara zgjedhjeve të ardhshme legjislativ të Qershorit 2013. Në emër të PS Franceze e në emrin tim, unë dëshiroj t'ju shpreh partisë suaj e juve personalisht të gjithë mbështetjen tonë për suksesin e fushatës suaj. Manifesti juaj është padyshim një



Faksimile e letërës së urimit të Fransua Holland, dërguar Ramës

udhërrëfyes për integritimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian dhe ç'ka është akoma edhe më e rëndësishme, ajo është gjithashtu një përgjigje për pritsmëritë legjitime të popullit tuaj për një jetë më të mirë dhe për një të ardhme më të mirë, njëllot të drejtë për të gjithë. Lufta kundër masave shtrënguese, rikthimi i mirëqenies, krijimi i më shumë vendeve të punës dhe sigurimi i një të ardhmeje për qytetarët tanë", thotë ai. Ndër të tjera citohet se: "Familja jonë socialiste është alternativa kundër konservatorizmit dhe populizmit e ne mbështetemi te socialistët shqiptarë për të dhënë kontributin e tyre për zhvillimin e një demokracie paqësore në Ballkan" tha ai.

Dje prezantimi i librit të tij "Ditar". I pranishëm kreu i PS

Zëdhënësi i Tony Blair në fushatën e Edi Ramës

Takimi me Endri Fugën, si e pranoi "detyrën" e re

TIRANE
Alastair Campbell, emri i njohur si zëdhënës i Tony Blair në vitet e qeverisjes së liderit laburist në Britaninë e Madhe, është kontraktuar për të qenë këshilltar i marrëdhënieve me publikun i kreu të Partisë Socialiste Edi Rama.

Detajet surprizë u bënë të ditura ditën e djeshme, gjatë promovimit të librit të tij ditar për vitet me Tony Blair, një botim i Universitetit Evropian të Tiranës, në ambientet e Hotel Tirana International. Në praninë e kreu të PS Edi Rama dhe shumë deputetëve socialistë, pedagogëve, gazetarëve, ambasadorit anglez në Tiranë, Alastair Campbell tregoi disa nga detajet sesi ishte njohur me Endri Fugën, drejtor i komunikimit në PS dhe pse e konsideronte atë një "spin doctor" në fushatën aktuale të liderit socialist.

Alastair Campbell, pranoi në një farë mënyre gjatë fjalës së tij, se kishte takuar Endrin, pas një mesazhi që ky i fundit i kishte dërguar në faqen e tij në facebook. I kishte treguar për pozicionin, dhe kishte shprehur dëshirën për të pirë një kafe. Gjithçka ishte realizuar në një kohë të shkurtër dhe po ashtu, bashkëpunimi mes Ramës dhe Campbell, kishte marrë një rrugë pa kthim.



NË FOTO: Erion Veliaj, Alastair Campbell dhe Endri Fuga dje në selinë e PS-së

me disa analistë në rezidencën e saj, ku ishin të ftuar shumë pak drejtues mediash, në një ambient ku do të diskutohesh për politikën me ish zëdhënësin e Tony Blair Alastair Campbell. Në atë darkë, ishte Henri

Çili, botues i gazetës Mapo, Blendi Fevziu, drejtues i emisionit Opinion në TV Klan, Sokol Balla, drejtues i emisionit Top Story në Top Channel, Anila Basha, drejtoreshë e gazetës shqiptarja.com, Ilva Tare, drejtuese e emisionit Tonight në Ora News, Skënder Minxhozi, drejtues i Revistës Java. Gjatë asaj darke informale, Alastair Campbell po pyeste drejtuesit e medias se cili ishte trendy politik në Shqipëri, dhe po ashtu, shprehu shumë habi për deklaratat e kryeministrit Sali Berisha për familjen e Edi Ramës në Parlament, e më së shumti akuzat kundrejt nënës së tij Aneta Rama, por edhe ndaj të atit Kristaq Rama. Darka zgjati më shumë se tre orë. Alastair interesohet, pyeste dhe kërkonte të kuptonte se çfarë po ndodhte në Shqipëri. Kërkesa e Endri Fugës së PS i ishte bërë në facebook, por ai kishte lënë një kafe, dhe ende nuk kishte kthyer përgjigje. E pas kësaj, duket se ajo kafe e fiksur në Rogner, por që vazh-

doi edhe më pas, u bë pikënisja e udhëtimit të ish zëdhënësit të Tony Blair, në këshillat e tij për fushatën e Edi Ramës për

zgjedhjet e vitit 2013.
DJE KONFIRMIMI
Henri Çili duket se nuk

donte ta mbante për vete shpalljen e këtij afrimi të Campbell me Edi Ramën. Ia faturoi këto fjalë gazetares Ilva Tare, e cila në fakt, ka bërë një parathënie për librin e Alastair. Vetë ish zëdhënësi i Tony Blair, nuk e mohoi atë që dëgjoi nga dy gazetarët Çili e Tare. Edi Rama, e shoqëroi me buzëqeshje gjithë këtë "skenë" e përfundimisht u konfirmua se çfarë po ndodhte.

Kishte kohë që Alastair Campbell rrinte në zyrat e PS. Shumë shpesh pyeste edhe funksionarët të ndryshëm sesi do të donin ta shihnin Edi Ramën. Pjesa më e madhe e tyre, sipas informacioneve, i kishin kërkuar Edi Ramën e 8 viteve më parë, plot pasion dhe energji, të moderuar në fakt me Edi Ramën lider të PS më vonë se kaq.

Dhe pas kësaj, duket se edhe sugjerimet e fjalës së Ramës në konventën e PS, ku ai u kthye në "identitet" kanë qenë sugjerimet e Alastair Campbell. Ecejaket e këtij të fundit, nga Londra drejt Tiranës ishin bërë tashmë më të shpeshta, ndërkohë që një pjesë e mirë e lidhjeve që po vendosen me Laburistët dhe Londrën, kanë autorësinë e tij. Po ashtu, edhe për pjesën më të madhe të sondazheve, që vijnë nga grupi laburist. Ndërkohë që nuk konfirmohet asgjë për pagesën e ish zëdhënësit të Tony Blair, apo edhe për faktin, nëse ai do të jetë i vendosur për një kohë të gjatë në Shqipëri deri në zgjedhje. Ajo që konfirmohet është fakti se gjatë këtyre dy ditëve që do të jetë në Tiranë, takimet e tij me Ramën janë edhe më të shpeshta. **an.ba.**

KABINETI SALAJ

APARATE DËGJIMI

Mbi bazën e një experience 10-vjecare në fushën e vendosjes së APARATEVE të dëgjimit kabinetit "SALAJ" ju vjen në ndihmë në këto shërbime:

- ☞ Matjen e dëgjimit (audiogram) FALAS.
- ☞ Marrjen e masës si dhe përgatitjen e saj (silikon apo akrilike) në kohë rekord brënda dy ditëve.
- ☞ Përcaktimin dhe programimin e aparatit sipas shkalës së dëgjimit.
- ☞ Shërbime (servis) për të gjitha tipet e aparateve.

Adresa: Pallatet e Shallvareve,
Rr. Dëshmorët e 4 Shkurtit, përballë Tatiëan
Nd. 24, Shk. 4, Ap.5 - Tiranë
Tel: +355 4 2262 304 / Mob: 068 23 800 95
E-mail: info@salajakustik.com
Ebsite: eee.salajakustik.com

SI ERDHI AFËR PS
Ishte vjeshta e vitit 2012 kur ish ambasadorja britanike Fiona McMillan shtroi një darkë



**Dule: Poli i tretë
është i dobishëm,
ende s'kemi vendim**

Ende nuk është vendosur mënyra e kandidatimit të PBDNJ-së në zgjedhje, por nuk përjashtohet krijimi i Polit të Tretë me LSI-në. Kreu i saj, Vangjel Dule shpjegon arsyet e shkëputjes nga PS. Ditë pas dite po flitet për një bashkëpunim të mundshëm të PBDNJ-së me LSI-në në zgjedhjet e 23 qershorit. Të dyja këto forca politike mund të jenë katalizatorët e një Polit të Tretë, aq të përfolur sot. Por, kreu i PBDNJ-së, Vangjel

Dule, pasi pranon domosdoshmërinë e këtij poli në politikën shqiptare, thotë se ende nuk ka asgjë konkrete. "Jemi përgatitur për të gjitha variantet potenciale të kandidatimit në zgjedhjet e ardhshme, duke filluar nga kandidatimi me vetë, e deri me koalicion me një apo më shumë parti", shton ai. "Lidhur me një pol të mundshëm të tretë, teorikisht do të ishte shumë i dobishëm, jo vetëm për forcat politike që do ta përbënin atë, por edhe për jetën

politike në vend. Do të thyehte bipolaritetin politik që, për mëse dy dekada, e mban vendin në një stacion politik, ekonomik dhe shoqëror; do të thyehte polarizimin e tij artificial dhe shterp, që ka frenuar civilizimin e jetës dhe klasës politike". I thotë Dule. Sipas tij, një nga variantet kryesorë të bashkëpunimeve, jo vetëm për PBDNJ-në, por edhe për forca të tjera, do të jetë edhe ai i krijimit të një poli të tretë.

Shtyhet buxheti, në pritje të fondit për sensibilizimin

Komisionerët, 219 mln lekë shpërblime

3.4 milionë fletë votimi për 23 qershorin

Lajmi

KQZ debatoi dje lidhur me buxhetin e hartuar për zgjedhjet e 2013, ku anëtarët e propozuar nga opozita kundërshtuan shpërblimet e larta të komisionerëve të ndryshëm. Në 23 qershor do të përdoren mbi 3 milionë fletë votimi dhe mbi 3 mijë kuti votimi.



TABELA E STRUKTURËS SË SHPENZIMEVE BUXHETORE PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E 2013

Nr.	PAGAT	Art.600	Art.601	Art.602	Art.231	Totali
		1	2	3	4	
I						5(1+2+3+4)
PAGAT		270,826,818	6,737,152			277,563,970
1	Pagat personelit te perkohshem ne KQZ	51,934,818	6,737,152			58,671,970
3	Shpërblimi i anetarëve te KZAZ, KQV, GNV, ZR, trajnujes, BHM	218,892,000				218,892,000
II						174,495,381
MALLRA				174,495,381		174,495,381
1	Materiale specifike			111,595,796		111,595,796
2	Materiale (prodhimë specifike), brenda vendit			7,893,600		7,893,600
3	Materiale te tjera (karburant)			8,000,000		8,000,000
5	Materiale (shtypshkrime)			36,492,666		36,492,666
6	Materiale (kancelari)			10,513,319		10,513,319
III						232,298,460
SHERBIME						232,298,460
1	Sherbime transporti			20,380,000		20,380,000
2	Sherbime udhëtimi e diëta			16,167,000		16,167,000
3	Sherbime per njoftime			1,080,000		1,080,000
4	Sherbime per qerramarrje			19,870,000		19,870,000
5	Sherbime te ndryshme			26,390,100		26,390,100

TIRANE

ARTEMISA HOXHA

Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve shtynë me konsensus miratimin e buxhetit që do të përdoret për zgjedhjet e 23 qershorit, kjo pas debateve të shumta lidhur me shumën e larta për zëra të ndryshëm në buxhet. Kryesisht u debatua për fondin që i është

akorduar komisionerëve të ndryshëm, fushatës publicitare etj. Kostoja që pritet t'i kushtojë buxheti të KQZ vetëm për shpërblimet e komisionerëve zgjedhorë është plotë 219 milionë lekë të reja. Janë parashikuar të shpërblehen 712 anëtarët e KZAZ-ve, 38,500 anëtarët e KQV-ve për ditën e zgjedhjeve, 3,784 anëtarët e GNV-ve për ditët e procesit të numërimit. Masa e shpërblimit

Nga buxheti është hequr fondi i trajtimit ushqimor, i gjysmëditës prej 1 mijë lekësh në ditë, për komisionerët

do të jetë e njëjtë me atë të zgjedhjeve të mëparshme për organet e qeverisjes vendore 2011. Kryetari dhe zv/kryetari i KZAZ-së është paguar me 65 mijë lekë, anëtarët dhe sekretari i KZAZ-së me 60 mijë lekë. Për zgjedhjet KQZ ka miratuar procedurat për mbledhjen, administrimin dhe publikimin e informacionit për pjesëmarrjen në zgjedhje ditën e votimit, të

cilat do të kryhen nga një person i emëruar nga KQZ ja pranë çdo KZAZ-je, në total 89. Anëtarët e KQZ-së, Hysen Osmani, kërkoi shpjegime për pagesën shumë të lartë të Komisionerëve, të cilët edhe pse punojnë vetëm një ditë, marrin 25 mijë lekë të reja. Pas kësaj, kryetarja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Lefteri Lleshi, kërkoi nga administrata që brenda kësaj

jave të paraqesin dhe fondin për fushatën sensibilizuese të zgjedhjeve, në mënyrë që buxheti të jetë i plotë.

FLETËT E VOTIMIT

Në buxhetin e detajuar janë përcaktuar edhe numri i fletëve të votimit dhe shumën që ato kushtojnë. Në zërat për materiale specifike, bëhet e ditur se do të përdoren plotë 3,355,946 fletë votimi që do të kushtojnë 41.479.491 lekë. Sipas projektbuxhetit të përgatitur nga administrata, vetëm një fletë votimi do të kushtojë 12 lekë të reja. Për të realizuar procesin do të blihen dhe 3000 kuti të cilat do të përdoren për materiale zgjedhore. Kjo sasi e kutive do t'i shtohet kutive të zgjedhjeve të 2011-s dhe do të ketë të njëjtat karakteristika. Në zgjedhjet e 23 qershorit do të përdoren plotë 119.700 vula sigurie, të cilat do të kushtojnë plotë 17.236.800 lekë. Ndërkohë që vula për 89 KZAZ dhe 5500 KQV do të jenë 16,589 copë që do të kushtojnë 19.989.745 lekë.

Poli i Tretë

Meta: Mazhoranca vetëm nga një parti, arrogante

Kreu i LSI-së tha se Poli i Tretë është ide e rëndësishme: Koalicion me të gjitha forcat progresiste

Aleati më i madh i Berishës në koalicionin qeverisës, Ilir Meta shprehet në mënyrë të qartë në favor të krijimit të një poli të tretë të politikës shqiptare, me argumentin se qeverisja e një partie të vetme nuk është e përhashtshme për shqiptarët. Kështu, kryetari i Lëvizjes Socialiste për Integrim ka nënvizuar se ideja e një poli të tretë është një ide e cila nuk do të lejonte që të kishim një mazhorancë arrogante. Sipas tij duhet të ketë një ekuilibër në mazhorancën e ardhshme. "Ideja e një poli të tretë apo të qendrës, në thelbin e saj është ideja e mospasjes së një mazhorance të plotë nga një forcë e vetme për arsye se eksperiencat

e kanë treguar që mazhoranca të tilla sillen me një arrogancë dhe për të frenuar këtë sjellje është e rëndësishme të ketë një ekuilibër në çdo mazhorancë të ardhshme, e cila do të jetë edhe baza e një bashkëpunimi me të përgjithshëm edhe në Parlament, edhe në tërësi në të gjithë sistemin e qeverisjes së vendit", tha kreu i LSI, Ilir Meta në një deklaratë për "TCH". Lideri i Lëvizjes Socialiste për Integrim, Ilir Meta, është shprehur se LSI do të bëjë koalicion për zgjedhjet e ardhshme vetëm me ato forca politike që janë progresiste, konstruktive dhe bashkëpunuese. "Për ne ekzistenca në qeveri nuk është e lidhur domos-



doshmërisht me ekzistencën e LSI-së. Përkundrazi! Sepse LSI është krijuar si forcë opozitare dhe duke u distancuar nga qeverisja e asaj periudhe. Për ne është më e rëndësishme që kjo forcë politike t'i shërbejë stabilitetit të vendit, një klime më konstruktive dhe më pozitive, më bashkëpunuese dhe njëkohësisht t'i shërbejë përsëritimit të atyre reformave që i japin Shqipërisë më shpejt statusin e vendit kandidat të Shqipërisë në Bashkimin Europian por, edhe e ndihmojnë për të përmirësuar situatën ekonomike në vend", ka thënë Meta. Ndërkohë që i pyetur në lidhje nëse e përjashton apo jo ndonjë forcë politike për

bashkëpunim në zgjedhje kreu i LSI është përgjigjur se "Duke qenë partizan i një politike pozitive edhe konstruktive, nuk do të preferoja të shprehesh në mënyrë mohuese se me kë nuk do të bëjmë, por në mënyrë pohuese, që do të bëjmë me të gjitha ato forca, të cilat japin mesazhe progresiste, konstruktive dhe bashkëpunuese". Çka të lë të hapur mundësinë e një koalicioni parazgjedhor me çdo forcë politike në Shqipëri, njafton që në themel të saj të ketë përpjekjen për integrimin e vendit në BE. Këto qëndrime kreu i LSI Meta i ka bërë vetëm pak javë përpara se të startojë fushata zgjedhore për zgjedhjet e 23 qershorit.



PS: Duke u marrë me opozitën s'zgjidhen problemet e vendit

Partia Socialiste reagoi pasi kryeministri Sali Berisha nuk foli në mbledhjen e grupit parlamentar të PD për gjendjen e rënduar të sigurisë në vend, por sulmoi kundërshtarët politikë dhe përgojoi konventën e tyre. "Sot është një ditë e rëndë. Sot u zhvilluan homazhe për drejtuesin e tretë të lartë të Policisë së Shtetit që ekzekutohet brenda 6 muajve të fundit. Pikërisht sot ne prisim që në

mbledhjen e grupit të tij parlamentar Berisha ta trajtonte këtë problem të rëndë me deputetët dhe ministrat përgjegjës për situatën", bën apel PS. Por sipas saj, kryeministri shfaqet me broçkullat e zakonshme, duke marrë nëpër gojë opozitën dhe duke i caktuar Presidentit e institucioneve të tjera të pavarura detyrat e objektivat për muajt e ardhshëm. "Një nga problemet që Europa ka me Shqipërinë është

pikërisht ndërhyrja e pushtetit ekzekutiv, qeverisë të pushtet e tjera të pavarura. Qoftë Europa qoftë SHBA si aleatët tanë, e kanë bërë të qartë se kusht për marrjen e statusit janë zgjedhjet. I kujtojmë kryeministrin se duke hedhur balë mbi opozitën, as situata e krimit s'zgjidhet, as vende pune s'hapen e as shërbimi shëndetësor s'përmirësohet. Është ai e qeveria e tij që paguhet për të qeverisur", tha Harito.

Kreu i PS mbledh ekipin e programit, ja elementët e rinj

Pëllumbi: OK fryma dhe ekipi i ri në PS

Rama: Me "skuadrën" e re, për programin final

- GRUPI I PUNËS I PROGRAMIT TË PS**
- Edi Rama
 - Ilir Beqja
 - Blendi Klosi
 - Eduard Shalsi
 - Taulant Balla
 - Milena Harito
 - Mimi Kodheli
 - Auron Tare
 - Vasilika Hysi
 - Eglantina Gjermani
 - Alfred Peza
 - Agron Duka
 - Ledi Shamku
 - Keti Bazhdari
 - Lindita Nikolla
 - Mimoza Hafizi
 - Besnik Baraj
 - Artan Lame
 - Erjon Veliaj
 - Klodiana Spahiu
 - Petrit Ago
 - Blerina Gjylameti
 - Olta Xhaçka
 - Arbër Mazniku

Lajmi

Kryetari i PS ka mbledhur ekipin e ri të programit qeverisës të PS, me të cilin do t'i japë dorën përfundimtare përpara se ta hedhë në fushatën elektorale të 23 qershorit. Profesori i PS Servet Pëllumbi shprehet pro frymës e ekipit të ri socialist.

TIRANE

JAKIN MARENA

Kreu socialist Edi Rama ka mbledhur dje grupin e punës për programin e Partisë Socialiste, duke deklaruar se është në fazën finale të përfundimit të tij. Sikurse e cilëson Rama "skuadra e programit të socialistëve" dhe në profilin e tij personal të rrjetit social Facebook, ky grup pune është i përbërë nga elementët e rinj, të cilët sëbashku si ekip i ri kanë marrë përsipër që të paraqesin para shqiptarëve platformën qeverisëse të PS pas 23 qershorit, teksa nënvizohet se do të ketë një fitore plebishitare. Ajo që vihet re fare lehtë në "skudrën e Programit" të PS është se pjesa më e madhe janë të rinj. Jo thjeshtë të rinj në moshë, por në frymë dhe në mentalitet të ri, aq i nevojshëm për të paraqitur para shqiptarëve frymën e së resë, të ndryshimit dhe të qeverisjes ndryshe të vendit me ardhjen e të majtës në pushtet pas zgjedhjeve, ashtu siç pretendon lideri i opozitës. Në të njëjtën gjatësi vale ka qënë dhe profesori i socialistëve, njëri ndër të urtët e Partisë Socialiste, Servet Pëllumbi teksa ka përsëritur idenë e kahershme të tij se ka qënë dhe është gjithnjë për frymën e re në PS por dhe për ndërtimin e ekipeve të reja në këtë parti. "Unë gjithnjë jam shprehur për frymën e re në Partinë Socialiste. Ndaj dhe tani e them me plot gojë që kam qënë dhe jam për frymën e re dhe për ekipet e reja në Partinë Socialiste", është shprehur shumë shkurt në linjë telefonike për gazetën "Shqiptarja.com" profesori i socialistëve Servet Pëllumbi. Duket se kreu i PS Rama ka mbështetje të përgjithshme në qëndrimin e tij për të afruar



Ekipi

"Skuadra e programit të socialistëve" është i përbërë nga elementët e rinj, të cilët sëbashku si ekip i ri kanë marrë përsipër që të paraqesin para shqiptarëve platformën qeverisëse të PS pas 23 qershorit.



Servet Pëllumbi

iste për fushatën e zgjedhjeve të 23 qershorit por dhe për qeverisjen sipas tyre, pas fitores.

Kreu i PS Rama ka mbledhur grupin e punës për programin final vetëm dy ditë pas përfundimit të Konferencës dyditore të socialistëve në Pallatin Kongreseve, në të cilën u prezantua përmes fjalës së tij përmblylëse por dhe përmes grupeve të punës programi elektorale, i cili do të përmbilidhet më pas një programin final qeverisës me të cilin do

së më shumë të rinj dhe për të kontribuar në ekipin që do punojë për zgjedhjet e 23 qershorit. Ajo që vihet re në listën e emrave që përbëjnë atë që Rama e quan "skuadra e programit" janë përfshirë dhe elementët të rinj, duke filluar nga gazetari i mirënjoh

ur Alfred Peza, Auron Tare, Keti Bazhdari, Milena Harito, Lindita Nikolla, Artan Lame, Petrit Ago, Blerina Gjylameti, Olta Xhaçka, Arbër Mazniku, pa përfshirë Agron Dukën, Erjon Veliaj e Klodiana Spahiu. Një ekip tërësisht i ri që sëbashku me Eduard

Shalsin, Ilir Beqjen, Vasilika Hysin, Eglantina Gjermanin, Mimi Kodhelin, Ledi Shamkun, Mimoza Hafizin por dhe Besnik Barajn, Blendi Klosin e Taulant Ballën që përbëjnë formatin e ri të grupit të punës që do t'i japë dorën e fundit programit të Partisë Social-

të kërkohet nga qytetarët shqiptarë vota më 23 qershor. Mësohet se shumë shpejt ky program do të shpërndahet në formë broshure në të gjitha organizatat e PS, që nga qendra e deri në bazë, për të shërbyer si bazë për premtimet në fushatën elektorale.

Grupi i PD

Berisha: Ramës s'ia fal njeri 21 janarin

Kreu i PD kërkoi nga Rusmali të përgatisë kërkesën për referendum për tre ligjet e bllokuara në Kuvend

TIRANE

Kryeministri Berisha akuzoi Ramën se e ka kthyer PS në një parti 99-ash, duke përjashtuar eksponentët e vjetër. "Statusi bllokohet nga zoti Rama e ligjet janë në Parlament. Z.Rusmali, si Kryetar i Komisionit parlamentar të Ligjeve, formuloni tekstin kërkesë që këto ligje të shkojnë në proces referendumi. Duhet ta dorëzoni këtë kërkesë sa më shpejt në KQZ, në mënyrë që Presidenti të ketë mundësinë, gjatë muajit mars, për ta shqyrtuar dhe për të dhënë verdiktin e tij për këtë akt madhor në historinë e integritimit të vendit. Unë ju garantoj se, siç do ta shihni, zoti Edi Rama po përgatit me vendosmëri skenarin e vitit 2009.



Ai në konventën e tij dekapitoi de facto PS dhe i vuiri asaj atë kokë që ka kohë që e drejton dhe e sundon, i vuiri asaj 99-shat, një grusht më të ngushtë neoblokkmenësh. Dhe ju e patë se kush e paraqiti programin e Nastradimit", tha Berisha duke akuzuar që nga Ilir Beqja e deri te Erjon Veliaj dhe duke thënë se do të firmosë i pari në kërkesën për Referendum. Njëherësh ai ka thënë se qytetarët s'do t'ia fallin Ramës puçin e 21 janarit, duke e cilësuar atë një aventurier. "Ajo që është e sigurt, zoti Rama e di që në zgjedhje ka të garantuar humbjen. Kjo jo vetëm për faktin se në tërësinë e tij ky ka në biografinë politike, jo në atë biologjike, numrin e disfatave më të mëdha, të rreshtuara njëra

pas tjetres se çdo politikan tjetër në Evropë. Pra ky e di që është një politikan siç do t'i thoshte një diplomat i shquar, shumë, shumë i mirë, për të qëndruar në opozitë. Ai e di, që shqiptarët nuk mund t'ia fallin puçin që organizoi për marrjen e pushtetit dhe e ndëshkuan në zgjedhjet e 8 majit, më nënryrë me të merituar. Shqiptarët s'mund të shohin në krye aventurier të etur për pushtet, që mendonin se edhe me zjarr do të mund të vinin në krye të vendit" tha Berisha. Sipas Berishës Rama ka një frikë të madhe nga vota, ndaj është përgatitur të mos njohë rezultatin. Njëherësh në mbledhjen me dyer të mbyllura ai ka kërkuar që të vijojë fushata derë më derë me qytetarët për votën.



Spahiu: Të largojmë Berishën nëse duam zgjedhje të lira

Kreu i Aleancës Kuq e Zi, Kreshnik Spahiu gjatë një takimi me banorë të komunës së Përgut deklaroi se Aleanca Kuq e Zi është e vendosur për të larguar Kryeministrin Sali Berisha nga pushteti para zgjedhjeve, duke e parë këtë si të vetmen mundësi që shqipëria të ketë zgjedhje të lira e të ndershme. Teksa është ndalur edhe tek fëmijet e Kryeministrit ai i ka pohuar se ata janë të vetmit që njihen

nga qytetarët shqiptarë, ndërsa fëmijet e ish-kryeministrave para tij janë të panjohur për publikum. "Po nuk ishe nip i Saliut dhe i Ridvanit, je i destinuar të jesh i varfër gjithë jetën. Ne duhet t'i japim drejtim kësaj dhe drejtimi është postbloku. Nuk ka përse të hynë ata as në Korçë, as në Pogradec, asgjekundi tjetër. Ne po shkojmë derë më derë, e fshat më fshat dhe po ju jap një premtim, që

ne nuk do e lejojmë atë deri më 23 qershor, ne duhet t'i japim një mesim përpara, se diktatorët nuk largohen me votë, diktatorët largohen ashtu sic meritohet të largohen që të mos i gëzojnë as paratë e tyre", tha Spahiu. Me herët Spahiu ka zhvilluar edhe një takim me komunitetin rom në qytetin e Pogradecit prej ku ka akuzuar kreun e Qeverisë se është duke posthuar dhe diskriminuar këtë shtresë.

Debate në Komisionin e Integritimit për lejen e armëve

PS: Burgim për armëmbajtje pa leje

Ristani: Ligji s'ka lidhje me rritjen e krimit

Lajmi

Ligji për "Armët" u miratua dje vetëm me votat e mazhorancës, pasi PS ishte kundër në disa pika të rëndësishme që kishin të bënin me lejen e armatosjes së deputetëve, ministrave etj. Ata kërkuar një moratorium për armët, gjë që u rrëzua.

■ ■ ■ TIRANE
ARTEMISA HOXHA

Opozita në Komisionin e Integritimit ishte kundër miratimit të pr. ligjit të hartuar nga Ministria e Brendshme lidhur me përdorimin e armëve. Sipas të majtëve, referuar dhe ngjarjeve të fundit në vendin tonë, argumentuan se ajo që duhet është pikërisht një moratorium për armët dhe jo një zgjerim i kategorisë që përfshijnë autorizim për përdorimin e tyre. PS kërkoi gjithashtu heqjen e dënimit me gjobë për armëmbajtës pa leje, siç e parashikon ligji, por burgosjen e tyre në çdo rast. Deputeti, Taulant Balla propozoi amendimin në këtë formë të ligjit të armëve që prej javësh diskutohet në Kuvend, duke i lënë të drejtën e armatosjes së ligjshme vetëm punonjësve të policisë dhe Ministrisë së Brendshme. Por, sipas zëvendësministrit të Brendshëm, Arben Ristani, kjo ndërhyrje mund të bëhet vetëm në Kodin Penal me shumicë të cilësuar votash. "Miratojmë një ligj për armët që nuk i lejon askujt në Shqipëri të mbajë armë, përveç se Policisë së Shtetit dhe forcave të Ministrisë së Mbrojtjes. Të gjithë të tjerët të barabartë përpara ligjit të mos guxojnë të mbajnë armët", deklaroi Balla. Ndërsa Ristani u shpreh: "Në rast se shikoni



Komisioni i Integritimit

Ligjet

Ky ligj u miratua vetëm me votat e mazhorancës në Komisionin e Ligjeve, pasi PS kishte propozuar një sërë ndryshimesh që nuk u morën parasysh nga mazhoranca në këtë komision.

pasi duhet të jenë organe kompetente në këtë fushë që të përcaktojnë llojin e blerjeve.

DODA

Deputetja demokrate, Mesila Doda ngriti në mbledhje shqetësimin se s nga do të kontrollohen përdoruesit e armëve që zotërojnë njohuri në përdorimin e tyre, pasi shumica e personave që përdorin armë në vendin tonë nuk janë profesionist. "Ky ligj vjen si një përmirësim i ligjit të vjetër. Ka subjekte që do të licencohen për të trajnuar persona që do të mbajnë dhe përdorin armë", iu kundërpërgjigj Ristani.

Akti për legalizimet

Pallatet, qeveria asnjë shifër për përfituesit

PS voton kundër aktit normativ për pajisjen me leje, Shalsi: Të mos bëhet për klientët e bashkisë

■ ■ ■ TIRANE

Opozita kundërshtoi dje në Komisionin e Veprimtarive Prodhuese aktin normativ "Për pajisjen me leje përdorimi të strukturave të ndërtuara me shkelje të lejes së ndërtimit përpara fillimit me efekte të plota të ligjit për urbanistikën" pasi sipas tyre, ky duhet të jetë një ligj. I ftuar në këtë mbledhje, zv.ministri i Transporteve, Ernest Noka bëri të ditur se qeveria nuk ka shifra të sakta për saktësi përkatëse numrit të familjeve që do të përfittojnë nga procesi i legalizimit. Për më tepër, duket se ligjet dhe aktet e shumta normative që janë nxjerrë nuk kanë arritur t'i japin fund këtij procesi. I pyetur nga deputeti i PS, Eduard Shalsi, për numrin e familjeve



që përfittojnë, zv/ministri nuk ka ditur të japë përgjigje. Procesi i legalizimit të banesave që nisi në vitin 2007 pritet të përfundojë brenda këtij viti. Për Tiranën janë 253 pallate, të cilat kanë shkelje të rregullave të lejeve të ndërtimit do të përfittojnë nga akti normativ i nxjerrë së fundmi nga qeveria, ndërkohë që nuk dihet numri i saktë i përfituesve në të gjithë Shqipërinë. Debate të forta kanë shoqëruar këtë nisim, pasi deputetët demokratë thane se po rregullonin gabimet e bëra nga ish kryetari i bashkisë Rama. Socialistët e kanë konsideruar këtë një nisim politike, e cila jo vetëm që mbrohet interesat klienteliste, por bëhet pas ardhjes në bashkinë e Tiranës të Lulzim Bashës, në një kohë që për disa vite rresht pushteti vendor nuk kishte asnjë kompetencë për legalizimin e

zonave informale. "U deshën të kalonin 8 vjet që kjo qeveri të jepte një zgjidhje me akt normativ, u bë i vit nga ardhja në krye të detyrës e Bashës për të sjellë një akt normativ. Ky akt i shërben një pjesë tjetër afër pushtetit dhe jo qytetarëve, ky akt normativ e bën situatën më kaotike. Nuk ka asnjë argument që ky akt të zgjidhë këtë problem. U zhvendosën të gjitha dosjet të ALUZINI dhe u hoqën nga Bashkia në vitin 2008 dhe nga ajo kohë deri më sot asgjë nuk ka ndodhur. Po të shohësh mënyrën si është konceptuar ligji përfittojnë 2-3 klientë afër oborrit të qeverisë. Merrret përsipër zgjidhja me një akt normativ dhe nuk dihet sa do jenë përfituesit dhe kush do të jenë përfituesit e këtij akti. Do jenë qytetarët apo do jenë klientët e qeverisë", u shpreh Shalsi.

Replikat

Debatet dhe fyerjet në komision për prezantimin e ligjit

■ ■ ■ TIRANE

Bushati: Zonja Doda, ju lutem shumë mos ngrini zërin aq më tepër sot.

Doda: Mos iu drejto një gruaj me atë ton. Ke kolegun tënd përballë që e filloi debatin i pari. Tërhiqi vëmendjen.

Bushati: Unë për gratë kam shumë respekt

Doda: Atëherë zotëri tërhiqi atij vëmendjen, jo mua

Balla: Ti u bërë shkaktese se je përfaqësues e mazhorancës.

Doda: Ti mos më ngri zërin mua.

Bushati: Ne kemi vendosur një rregull këtu. Kryeministri juaj në mbledhje grupi ka thënë që për të prezantuar ligjin do vijmë njerëz me mandat politik. Zv.ministri juaj ka frikë të prezantojë ligjin, kështu që kalojmë te drejtori sa t'i dalë frika zv.ministrit tuaj. Vazhdojmë me prezantimin e projektligjit.

Ristani: Ne vimë në respektin tuaj për të rregulluar një ligj.

Balla: Ne s'kemi nevojë për respektin tuaj, jeni në respekt të ligjit. Vazhdoni flisni.

Doda: Po lërimi mo zotëri



Mesila Doda, deputete e PD

që të flasë njëherë, e kthyet në muhabet kafeneje.

Balla: Miratoni disa masa konkrete që unë do t'i përmbledhja në një moratorium për armët. Jetojmë në një situatë, ku të paktën 24 orët e fundit ka pasur disa vrasje kriminale ku u vra dhe një officer i lartë i policisë. Në qendër të Tiranës dy persona të armatosur me armë që i tranportorin nga qendra kryen një vrasje.

Ristani: Ky ligj nuk ka lidhje fare me rritjen e krimit, ky është për përfarimin me legjislacionin europian. Të gjithë e kanë të miratuar.

Bushati: Si të kemi një shoqëri, ku kryeministri nuk vesh antipumbin dhe ju doni t'i jepni armë? A kanë armë Angela Merkel, Mario Monti etj?



Selanik, aksidenti çon në pranga trafikantin e klandestinëve

Një 34-vjeçar nga Shqipëria është vënë në pranga nga policia greke pasi akuzohet për trafik klandestinësh. Sipas policisë greke, të cilës i referohen uniforma blu të Gjirokastrës, shqiptari kishte në makinën e tij 3 shtetas, po shqiptarë, pa dokumente të rregullta, ndërsa u kishte marrë 100 euro me qëllim që t'i transportonte drejt Selanikut.

Policia u vu në ndjekje të tij, pasi 34-vjeçari nuk ndaloj makinën kur iu bë shenjë për kontroll nga një patrullë e policisë, por u largua me shpejtësi. Gjatë tentativës për t'u larguar, shqiptari, si pasojë e shpejtësisë me të cilët po drejtohej automjetin, është përfshirë në një aksident në qendër të qytetit, aty ku edhe u arrestua. Në këtë moment, ai ka

tentuar të largohet nga makina, të cilën e ka braktisur, por pas pak metrash është vënë në pranga, gjatë ndjekjes nga policia greke. Bashkë me të, janë ndaluar edhe tre klandestinët shqiptarë. Trafikanti do të akuzohet edhe për mosbindje ndaj patrullës së policisë, përveç trafikut illegal, ndërsa tre shqiptarët tjerë pritet të deportohen.

Krimet e Rënda analizojnë 2012: Jemi të pavarur

KLD: Avokatët po rrezikojnë proceset

Cefa: Po abuzoni, Gjykatat do ndërhyjnë

Lajmi

Nënkryetari i KLD-së, Elvis Cefa, ka deklaruar dje, se avokatët nuk do të lejohen më të bëjnë, që proceset gjyqësore të dëshojnë. Duke marrë shembull procesin ndaj Dritan Dajtit, në analizën vjetore të Gjykatës së Krimeve të Rënda, Cefa dha, se do të merren masa ndëshkuese.

TIRANE

Ek cilësuar si të suksesshme punën e Gjykatës së Krimeve të Rënda për vitin 2012. Por, ka bërë për "ujë të ftohtë" avokatët, sipas të cilëve, shumë procese gjyqësore rrezikojnë të dëshojnë.

CEFA

Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Elvis Cefa, i shoqëruar nga anëtarët tjetër të KLD-së Artan Broci, morën pjesë dje në analizën vjetore të Gjykatës së Shkallës së Parë dhe të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda. Në analizat në fjalë ishin gjithashtu të pranishëm kryeprokurori për Krimet e Rënda si dhe Kryetari i Dhomës së Avokatëve, Kryetarët e Gjykatave vlerësuan faktin se institucionet që ato drejtojnë kanë një rol të rëndësishëm në zbatimin e ligjit. Ndërsa Kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Sandër Simoni theksoi, se viti që lamë pas ishte një histori suksesi për Gjykatën e Krimeve të Rënda. Aplikimi i ligjit Antimafia ka sjellë rezultate shumë të mira.

Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Elvis Cefa, shprehu vlerësimin e tij dhe të KLD-së për punën e bërë nga Gjykatat për Krime të Rënda. Ai vuri theksin tek rëndësia që kanë këto gjykata në sistemin e drejtësisë, si dhe garantoi mbështetjen e ardhme të KLD për të gjithë trupën gjyqësore. Më tej, ai theksoi se, problematika e shkaktuar nga mungesa e avokatëve në sallën e gjyqit, siç e kanë konstatuar edhe nga institucionet ndërkombëtare duke e cilësuar këtë fakt, "si një problem tipik i sistemit shqiptar". Zëvendëskryetari



Gjykata e Krimeve të Rënda

Elvis Cefa, deklaroi më tej, se asnjë veprim që çënon ecurinë normale të proceseve gjyqësore nuk mund të tolerohet. Ai i bëri thirrje avokatëve të mos shfrytëzojnë hapësirat

që i njeh ligji për të zvarritur proceset gjyqësore dhe për t'u shmangur përgjegjësisë të tyre ligjore. Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në fund të fjalës së tij shprehu

bindjen se: "ndryshimet e bëra në ligjin për Avokatinë, si dhe ato të prishme në Kodin e Procedurës, do t'i japin mundësi gjykatave të marrin rolin udhëheqës në proceset

Dajti

Nënkryetari i KLD ka marrë shembull procesin ndaj Dritan Dajtit, kur ka sulmuar avokatët. Procesi "Dajti" është shtyrë afro 200 herë rresht, pasi asnjë avokat nuk pranon ta marrë në mbrojtje.

gjyqësore".

SIMONI

Kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Sandër Simoni, teksa publikoi shifrat e punës së një viti të institucionit që ai drejton, deklaroi, se "gjykata jonë është e pavarur, ndërsa ligjin antimafia rezultoi i suksesshëm". Simoni tha gjithashtu, se gjatë vitit të kaluar, janë gjykuar 1194 çështje, si dhe është përmirësuar infrastruktura.

Arrestimi

Ish-Sekretari i Ministrisë kërkon dëmshpërblim: Dua 1.2 mln lekë

TIRANE

Ish-sekretari i Përgjithshëm i ministrisë së Punës, Spartak Gjini, kërkon 12 milionë lekë dëmshpërblim, për burgim të padrejtë. Përgjatë së enjtes, ish-zyrtari i lartë i dënuar nën akuzën e "korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike", ka depozituar kërkesë-padinë në Gjykatën e Tiranës. Në çështjen civile që mban numrin 10062, Gjini ka paditur Degën e The-sarit dhe ministrinë e Financave, për kompensim nga burgimi i padrejtë. Do të jetë gjyqtarja Fida Osmani, ajo e cila do të shqyrtojë padinë me objekt: Detyrimin solidarisht të anës së paditur për kompensim për burgim të padrejtë, për periudhën prej 405 ditësh nga data 07.11.2011 deri më date 17.12.2008, në masën 1.215.000



Spartak Gjini

mijë leke të reja. Më 6 janar të vitit 2012, Gjykata e Tiranës anuloi dënimin me 5 vjet burg për Spartak Gjini. Ish-sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta u shpall i pafajshëm për mungesë provash. Pas afro 25 seancash

gjyqësore, Gjykata vendosi pafajësinë për ish-zyrtarin, ndërkohë që prokuroria pati kërkuar në leximin e pretendës shpalljen fajtor të Gjinit dhe dënimin e tij me 5 vjet burgim. Çështja ishte rikthyer për rigjykim nga e para në Gjykatën e Shkallës së Parë të Tiranës, pas një vendimi të marrë nga Gjykata e Lartë në muajin korrik të vitit 2010. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vendosi prishjen e vendimit të majit 2008 të Shkallës së Parë, e cila dënoi Gjini me 2 vite e 6 muaj burg. Gjykata e Lartë prishi gjithashtu edhe vendimin e Gjykatës së Apelit, e cila kishte lënë në fuqi vendimin e Shkallës së Parë. Gjini u akuzua se kishte marrë rryshetin prej 40 mijë eurosh për të favorizuar një kompani private për t'u përzgjedhur fituese në një tender rikonstruksioni të Ministrisë së Punës. Ai u arrestua në nëntor të vitit 2007 së bashku me disa persona të tjerë. el.e

LAJME SHKURT

Krujë, arrestohet 21-vjeçari se rrihte nënën

Policia e Fushë-Krujës arrestoi 21-vjeçarin A.L., i cili ishte shpallur në kërkim, pasi masës së arrestit nga gjykata, "arrest me burg". Drejtoria e Policisë së Durrësit njoftoi, se, e datën 20 shkurt, ky person, ka ushtruar dhunë fizike e psikologjike ndaj nënës së tij 51-vjeçare; ngjarje për të cilën është shpallur në kërkim më datë 20.02.2013.

Durrës, në pranga, goditi policët e patrullës

Një 41-vjeçar ka goditur policët e patrullës së përgjithshme në qytetin e Durrësit dhe për këtë është arrestuar. Sipas drejtrisë së Policisë së Durrësit, rreth orës 22.00 të së djelës, në pranga ka rënë Xhevit Elmazi. Ky person, dyshohet se rreth orës 16.00, në lagjen Nr.14, ka goditur për shkak të detyrës punonjësit e Patrullës së Përgjithshme të Policisë.

Vlorë, kapen hajdutët e telave dhe makinave

Uniformat blu të Drejtorisë së Policisë së Vlorës, kanë pranuar disa persona, të cilët vdhinjin tela elektrik dhe i shisnin për skrap. Kështu, në Himarë është vënë në pranga Aristotel dhe Perikli Garo, të cilët kishin vjedhur 600 metër tel të energjisë elektrike dhe e kishin shitur. Ndërsa në Delvinë, janë arrestuar Astrit Ruçi, 55 vjeç dhe Zef Prenga, 53 vjeç, të dy banues në Sarandë, pasi kanë vjedhur një furgon dhe disa shtylla hekuri në fshatin Bajkaj, të cilat i kanë shitur për skrap.

Sarandë, ndalohet trafikanti i klandestinëve

Një i shumëkërkuar nga komisarati i policisë së Sarandës dhe i shpallur në kërkim prej shumë kohësh, është arrestuar. Burime nga Drejtoria e Policisë së Vlorës kanë bërë të ditur për mediat, se në pranga ka rënë 26-vjeçari Denis Lushi, lindur në Lushnjë e banues në Shkodër. Sipas të njejtave burime, personë i sipërpërmendur, ishte dënuar në mungesë me 3 vjet e 4 muaj burg, për trafik klandestinësh, nga Shqipëria drejt Greqisë. Ai është ndaluar gjatë një kontrolli të rastësishëm të një autoveture



INSTAT: Janar, ulet ndjeshëm deficitin tregtar i vendit

Gjatë janarit 2013 u eksportuan 18.1 miliardë lekë mallra, me rritje 1.2 për qind në krahasim me dhjetorin dhe rritje me 34.6 për qind në krahasim me janarin 2012, njoftoi INSTAT. Ndërkohë, u importuan 34 miliardë lekë mallra, me ulje 27.3 për qind në krahasim me dhjetorin dhe ulje 8.1 për qind në krahasim me janarin 2012. Deficitin tregtar i këtij muaji

është 15.9 miliardë lekë, duke shënuar një ulje prej 44.9 përqindësh krahasuar me muajin paraardhës dhe një ulje prej 32.5 përqindësh krahasuar me janarin 2012. Tregtia me vendet e BE-së ze 71.6 për qind të totalit të import-eksportit. Partnerët kryesorë tregtarë vazhdojnë të jenë Italia dhe Greqia. Tregtia me Italinë ze 37.8 për qind, ndërsa me Greqinë 10 për qind të

totalit. Disa nga partnerët tanë tregtarë me të cilët eksporti dhe importi është rritur, janë për eksportin, Gjermani, Spanjë, Kinë, SHBA, Zvicër, etj. dhe për importin, Spanjë, Ukrainë, etj. Krahasimi me muajin paraardhës tregon që eksporti i lëkurës dhe artikujve prej saj u rrit 41.3%, i tekstilëve u rrit 11.6%, mineraleve dhe energjisë elektrike 8.8 për qind, etj.

Revista angleze BNE kundër idesë së Berishës

Shtetësia po vë në rrezik "Shengenin"

"Vendi, korrupsion e krim shumë të lartë"


Lajmi

Sipas revistës britanike BNE, qeveria shqiptare ka vënë në rrezik regjimin e përgjithshëm nga vizat Shengen për qytetarët e saj, pas marrjes së vendimit për dhënie të nënshtetësisë për të huajt që investojnë në vend 200 mijë dollarë

TIRANE
GENC KONDI

Berisha dhe Këshilli shqiptar i Ministrave kanë ngjallur zemërimin e Brukselit lidhur me një vendim për ofertë të nënshtetësisë për të huajt, që investojnë në vend 200 mijë dollarë, shkruan revista Business New Europe (BNE) me bazë në Pragë dhe Moskë, por me pronarë britanikë. Në një artikull kushtuar kryesisht problemeve të Malit të Zi për aderimin në Bashkimin Evropian, ndër të tjera, preket edhe çështja e Shqipërisë. Në artikull thuhet se "një tjetër shtet që aspiron të hyjë në BE rrezikon të zemërojë Brukselin. Kjo është Shqipëria. Që nga dhjetori i vitit 2010 ka hyrë në fuqi heqja e vizave drejt vendeve evropiane, që i lejon qytetarët shqiptarë të lëvizin lirish në zonën Shengen të Evropës pa kufij, por Tirana po e vë këtë në rrezik me një projektligj të hartuar nga qeveria, që do t'i jepte nënshtetësinë shqiptare kujtdo që investon të paktën 200 mijë dollarë në vend". Në artikull shtohet se, me bregdetin e fundit të pazhviluar të Evropës, çdo investitor i ardhshëm që do të sillte 200 mijë dollarë, do të kishte mundësinë të kapte një vend të privilegjuar në plazh.

Në aspektet pozitive rejditen: një taksë e ulët për të ardhurat personale dhe ato për bizneset; prania e bregdetit të fundit të pazhviluar në Evropë; afërsia me Korfuzin dhe një klimë mesdhetare. Sikurse duket qartë, tri nga katër kushtet Shqipëria i ka nga natyra dhe vetëm një është përcaktuar nga njerëzit. Por, nga ana tjetër, kushtet negative janë shumë të rënda. Sipas BNE, Shqipëria shquhet për një shkallë të



NË FOTO: (Majtas) Revista Business New Europe, varjanti elektronik në internet (Lart) Kryeministri Sali Berisha në mbledhjen e qeverisë në qytetin e Vlorës me rastin e 100-vjetorit të Pavarësisë

paraqiten në gjendje shumë të dobët ose mungojnë krejtësisht.

PROJEKTI

Që në mbledhjen simbolike të qeverisë, të zhvilluar në Vlorë në festime të 100-vjetorit të Pavarësisë, kryeministri Sali Berisha kërkoi rishqyrtim të ligjit për shtetësinë, duke thënë se "ligji duhet të përcaktojë kushte, në të cilat ata që kanë investuar 100 mijë euro të marrin shtetësinë shqiptare". Me pas, në mbledhjen e rradhës të 12 dhjetorit të vitit të kaluar, ai shtoi se shifra duhet të jetë 200 mijë dollarë dhe se ligji nuk duhet të miratohet para zgjedhjeve.

LAJME SHKURT

Kontrata e 4 HEC-ëve, në Kuvend për ratifikim
Qeveria shqiptare shprehet që të marrë së shpejti rreth 110 milionë euro nga shifra e hidrocentraleve Ulëz-Shkopet dhe Bistrica 1 e 2, blerësi i të cilave është kompania Kurum. Burime nga Kuvendi bëjnë të ditur se kontrata e shitjes së katër HEC-ve ka ardhur këto ditë për ratifikim në parlament. Pasi të rifikohet, procesi do të vijojë me dekretimin nga presidenti i Republikës, duke i hapur rrugën arkitimit të parave. Është nevojshme për momentin, në një kohë që të ardhurat në buxhet për vitin 2012 shënuan një performancë negative.

Kosovë e Shqipëri, rreth 150 mijë vetë lëvizën në janar
Cjfatë muajt janar kanë hyrë në Shqipëri nga Kosova 73.664 persona me 31.600 mjete të llojeve të ndryshme, ndërsa kanë dalë nga Shqipëria drejt Kosovës 72.150 persona me 31.400 mjete të llojeve të ndryshme, raportojnë burime të policisë kufitare. Në kufirin Shqipëri-Kosovë, me gjatësi prej 124 kilometrash, janë të hapura 6 pika të kalimit kufitar, prej të cilave 4 në rrethin e Kukësit (Morini, Shishtavec, Orgjosti dhe Borja) dhe nga një në rrethet e Hasit (Qafë Prushit) dhe të Tropojës (Qafë Morina). Lëvizjet më të shumta të udhëtarëve dhe mallrave mes dy vendeve kryhen përmes doganës së Morinit në rrethin e Kukësit.

Ristrukturohet hyrja e makinave në portin e Durrësit
Rruga hyrëse e automjeteve në portin e Durrësit është në proces rishikimi, që do të përfundojë në fillim të muajit maj, në sajë të një investimi prej 159 milionë lekësh nga Autoriteti Portual. Traseja e rrugës me gjatësi 740 metra dhe gjërësi 19 metra ka përfunduar tërësisht, ndërsa procesi i asfaltimit do të fillojë më 1 mars. Aktualisht po përfundojnë punimet inxhinjere në sistemin e kanalizimeve, spostimi i kablove dhe sistemi i ndriçimit dhe ka filluar puna për ndërtimin e Portës nr 4.

Tregu Sigurimet, xhiroja rritet me 30%

Pavarësisht nga luhajtjet e kohëve të fundit lidhur me tarifën, tregu i sigurimeve këtë vit duket se është rimëkëmbur ndjeshëm. Gjatë muajit janar, sipas Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, xhiroja e tij shënoi një rritje me 30.21%. Volumi i primeve të shkruara bruto u rrit me 175 milionë lekë dhe kapi shifrën 754



milionë mijë lekë. Ndërkohë, numri i kontratave arriti në 82.102, me ulje 0.39% krahasuar me janarin 2012. Volumi i primeve të shkruara bruto në veprimtarinë e Jo-Jetës kapi shifrën 634 milionë lekë, në rritje 35.79% krahasuar me janarin e vitit 2012. Ndërkohë numri i kontratave në sigurimin e Jo-Jetës kapi shifrën 75.930, ulje në masën

1.14% krahasuar me janarin e vitit 2012. Pas më shumë se një viti, edhe sigurimet e "Jetës" ndaluan rritimin e rënies. Volumi i primeve të shkruara bruto në veprimtarinë e Jetës kapi shifrën 120 milionë lekë, në rritje 6.96% krahasuar me janarin e vitit 2012. Gjithsej janë paguar 167 milionë lekë dëme ose 21.87% më shumë se një vit më parë.

KURSI I KËMBIMIT VALUTOR			
Burimi: Banka e Shqipërisë Data 25.2.2013			
\$	Dollari LEKË	105.46	NDRYSHIMI DITOR -0.25
€	Euro LEKË	139.68	NDRYSHIMI DITOR +0.01
£	Paund LEKË	159.65	NDRYSHIMI DITOR -1.76
SFr	Franga LEKË	113.82	NDRYSHIMI DITOR +0.25

Çmimet të ushqimeve në kryeqytet			
Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe USAID			
PERIME	Domate	183	FRUTA
	Kastravec	240	
	Spec	260	
	Spinaq	104	
	Lakër	44	
	Lulelakër	133	
Karrota	100	Mollë	79
Patëllxhan	270	Portokall	92
Kungull	267	Mandarina	185
Fasule	310	Limon	200
Qepë	74	Ullinj	172
Patate	82		

Çmimet në lekë/kg Data 25.2.2013



Ambasadorja e Çekisë në Shqipëri, Cekisë: CEZ-ERE shpresojmë në pajtim

Ambasadorja e Çekisë në Shqipëri, Tomasova, nga Korça ka folur dhe lidhur me situatën e tensionuar, të krijuar muajt e fundit mes qeverisë shqiptare dhe CEZ, pasi autoriteti rregullator i energjisë i ka hequr licensën operatorit çek të shpërndarjes, në janar të këtij viti. Ajo deklaroi se "shpresojmë që të ndodhë pajtim,

përpara se palët të shkojnë në Arbitrazh". Ambasadorja çeke, gjithsesi, ka pohuar se prishja e kontratës nuk ishte një hap pozitiv, ndërkohë që ka konfirmuar se CEZ ka ndërmarrë hapa për të filluar procedurën e arbitrazhit ndërkombëtar. CEZ po ndodhet së fundmi nën presion në rajon, ku, pas Shqipërisë, edhe Bullgaria ndërmori hapa për t'i hequr licensën

këtë operator. Kriza e kompanisë çeke në Bullgari arriti kulmin, kur, pas protestave të shumta të konsumatorëve lidhur me faturat e tyre të energjisë, qeveria bullgare vendosi më 19 shkurt t'i heqë kompanisë licensën e shpërndarjes së energjisë, pas akuzave për shkelje të ligjeve të prokurimit, por, pas kësaj, edhe vetë Ekzekutivi në vend dha dorëheqjen.

Profesori Petkov: Ukraina e Rumania pësuan zhgënjim nga "e sheshta" Eksperti, OK taksës progresive

"Në rast se Shqipëria zgjedh të ndryshojë modelin e taksimit, nga taksa e sheshtë, në progresive, hapi duhet të ndërmerret gradualisht e në konsultë me bizneset në vend"

Lajmi

Eksperti fiskal bullgar Krastio Petkov ka deklaruar dje në Tiranë se taksa e sheshtë në vendet ku aplikohet ka rritur informalitetin tek shtresat me të ardhura të mesme e të ulëta, ndërkohë që ajo progresive siguron stabilitet fiskal

■ ■ ■ TIRANE
GENC KONDI



NË FOTO: Eksperti fiskal bullgar Krastio Petkov

Taksat

Norma e taksimit të të ardhurave për individët në SHBA, Mbretëri e Bashkuar dhe Australi është progresive dhe llogaritet përkatësisht 15-35%, 40% dhe 17-45%, ndërsa për biznesin respektivisht 15-35%, 28% dhe 30%

tek shtresat e popullatës me të ardhura të mesme e të ulëta, ndërsa të ardhurat në buxhet

kanë rënë ndjeshëm në këto vende. Sipas profesorit bullgar, Ukraina dhe Rumania tashmë kanë rikthyer sistemin progresiv, si forma më e mirë e stabilitetit financiar.


NDRYSHIMI

Në rast se Shqipëria zgjedh të ndryshojë modelin e taksimit, nga taksa e sheshtë prej 10 për qind, në taksë progresive, atëherë ky hap duhet të ndërmerret në mënyrë graduale e në konsultë me bizneset e mëdha në vend. Sipas

Ndërkombëtarët

Kodheli: PS në pushtet rilidh marrëveshje me FMN-në

Partia Socialiste, edhe pse ende është në qeverisje të vendit, ka ide mjaft të qarta në lidhje me marrëdhëniet që do të ketë me institucionet kryesore financiare ndërkombëtare. Nënkrjetarja e Komisionit të Ekonomisë dhe deputete e PS-së Mimi Kodheli ka deklaruar dje para mediave se "pasi të vijmë në pushtet, do të kërkojmë marrëveshje të re me Fondin Monetar Ndërkombëtar". Gjithashtu, Kodheli foli edhe për synimin që ka partia ku ajo bën pjesë për të ulur shpenzimet e tepërta. Nga ana tjetër, ajo akuzoi qeverinë se është në krizë dhe se nuk po mbledh dot të ardhurat. Që nga viti 1991, Shqipëria ka patur marrëveshje të përhershme me Fondin Monetar, sipas të cilës ky i fundit jepte ndihmë financiare me interes të ulët, por e kushtëzonte këtë me kontrollin ndaj financave publike të vendit. Këtë rregull e prishi Berisha, për të rritur borxhin publik tej masës.



vend bashkohen duke propozuar secila ulje taksash apo edhe zerim të tyre. Por sipas profesor Petkov, kjo rrugë nuk shpie në një përmirësim të situatës ekonomike, e madje nuk mund të cilësohet as si një debat serioz për kushtet aktuale të ekonomisë.

FORMULAT

Mazhoranca qeverisëse në vend mbështet idenë e zhvillimit liberal të ekonomisë, ku rolin kryesor të zhvillimit ekonomik dhe të punësimit e marrin sipërmarrjet private. Ndërkohë, opozita mbështet idenë e taksimit progresiv, përmes të cilit shteti mund të garantojë edhe më shumë të ardhura, të cilat mund të përdoren më pas për zhvillimin ekonomik të vendit. Aktualisht, Mali i Zi është një nga vendet me taksën mbi fitimin për bizneset më të ulët, në 9%, ndiqet më pas nga Bullgaria, Serbia, Qiproja dhe Shqipëria, me 10%. Irlanda, Lituania e Hungaria ofrojnë gjithashtu nivel të ulët taksimi, përkatësisht 12.5% dhe 15%. Ndërkohë, vendet që kanë normat më të ulëta të taksimit të të ardhurave personale janë Hong Kongu me 2-17%, Egjipti dhe Serbia me 10-20%, Brazili 7.5-27.5%, Singapori 3.5-20%.

Shteti i Monakos nuk zbaton asnjë taksë mbi fitimin për individët.

Petkov, ndryshimi i menjëhershëm i modelit të taksimit do të sillte, jo vetëm kundërshtitë e forta të korporatave apo evazion fiskal, por edhe mund të ndikojë tek investimet e huaja, ndaj një pikënisjeje e mirë, sipas tij, do të ishte taksimi në këtë formë fillimisht i të ardhurave personale. Ky model

taksimi, sipas ekspertit bullgar, është një model që aplikohet nga vendet e zhvilluara, e që po rimerret edhe nga vendet që vitet e fundit kanë aplikuar taksën e sheshtë. Pavarësisht qëndrimeve të ndryshme lidhur me sistemin e taksimit që duhet të aplikohet në Shqipëri, të dy palët politike kryesore në

Reformat

Tatimet përurrojnë shërbimin e pagesës së taksës nga celulari

■ ■ ■ TIRANE

Kryeministri Berisha deklaroi dje se shërbimet "M-Tax", taksat nga celulari, përbëjnë hapin e parë në drejtim të projektit "M-Albania". I pranishëm në përrurimin e shërbimeve M-Tax dhe E-Pagesa, në mjediset e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, ai tha se këto janë dy shërbimet më inovative në administratën shqiptare, në atë tatimore në veçanti. Shërbimi M-Tax është aplikacioni i parë qeveritar për platformat celulare Apple (iPhone, iPad) dhe Android.



Kryeministri Sali Berisha

Ndërtimi i këtij aplikacioni është një investim i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, me vlerë 13 milionë lekë, me anë të të cilit çdo tatimpaguesi i mundësohet të kontrollojë të gjithë situatën e tij tatimore nga telefoni celular, si dhe e ndihmon tatimpaguesin të deklarojë dhe paguajë në kohë detyrimet tatimore, pa qenë e nevojshme të paraqitet në sportelet e shërbimit të administratës. Ndërsa E-Pagesa, pagesa elektronike, është një investim i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, me vlerë 10 milion lekë dhe lidhet me bankat për të realizuar pagesat nga biznesi për administratën tatimore.




Tregu më i madh në Shqipëri për shit-blerje

Shisni SHPEJT, THJESHT dhe PA PAGESË në merrjep.al!

Duke bërë njoftim në merrjep.al ju mund të shisni, blini, tregtoni, të kërkonit punë, të ofroni punë etj. Sigurisht që keni ca gjëra në shtëpi të cilat nuk ju duhen ose keni nevojë për ca gjëra që mund t'ju gjeni lehtësisht për t'blerë. Në këtë rast www.merrjep.al është vendi i përshtatshëm për ju.

Bëni një njoftim TANI dhe do keni mundësinë që të fitoni çmime të mahnitshme!

** Ne do japin nga 3 dhuratat për muaj dhe kjo do zgjatë 5 muaj rresht



Zgjedhjet parlamentare


ITALIA ZGJEDH. Kush do të futet në Palazzo Chigi si kryeministër? I majti Bersani? Apo ish-kryeministri Berlusconi? Evropa shpreson për një qeveri stabile. Kjo duket e vështirë.

Italia voton, fiton mosqeverisja

Komiku Grillo trondit Italinë. Zgjidhja, një aleancë e lëkundur

ROMË

Legji elektoral mban në Itali një emër të çuditshëm: "Porcellum". Kjo do të thotë pak a shumë "çorbë derri". Këtë emër nuk e kanë zgjedhur zgjedhës të zhgënjyer, por shkencëtarë dhe politikanë, kur legji elektoral u hartua rreth dhjetë vjet më parë. "Çorbë derri" para së gjithash sepse legji është shumë i komplikuar. Thuaje askush nuk e kupton me të parën ndarjen e vendeve në të dyja dhomat e parlamentit. Në Dhomën e deputetëve është partia më e fortë ajo që merr automatikisht shumicën absolute të vendeve, edhe kur ajo merr vetëm 30 % të votave. Në Senat votat ndahen në bazë të listave rajonale. "Në sajë të Porcellum-it, në dhomën e parë të Parlamentit, në Dhomën e Përfaqësuesve ekziston një shumicë e rehatshme votash. Por kjo nuk vlen aspak për Dhomën e dytë, Senatën. Dhe kjo mund të kishite ndikim shumë të madh në aftësinë për të qeverisur të fitimtarit," deklaroi Lutz Klinkhammer, ekspert për Italinë në Institutin Gjerman të Historisë në Romë. Nëse në Senat krijohet një tjetër shumicë politike nga ajo në Dhomën e Deputetëve, kryeministri i ardhshëm duhet t'i hyjë një koalicioni me shumë parti të vogla. Meqenëse në parlament



Si kanë votuar rajonet? Me ngjyrë të kuqe mbizotëron e majta dhe me ngjyrë të kaltër e djathta

përfaqësohen deri 20 parti, ajo që rezultojnë është vetëm një aleancë e lëkundur. Varianti më i mundshëm, pas anketimeve të fundit është që Pier Luigi Bersani pas zgjedhjeve parlamentare të së dielës dhe së hënës (24/25.02.2013) me një listë

partish të majta të duhet të hyjë në koalicion me listën e re të kryeministrit të deritashëm, Mario Monti. Një aleancë e tillë nuk do të mbajë më shumë se gjashtë ose 12 muaj, supozon eksperti i Italisë, Klinkhammer. Një qeveri stabile, ashtu

siç e dëshirojnë atë BE dhe tregjet financiare kjo nuk do të ishte.

BEPPLO GRILLO SJELL VRULL TË RI

Këto lojëra taktike koalicionare u interesojnë vetëm shkarazi 47

milione zgjedhësve. Një në katër zgjedhës në anketimet e fundit para 14 ditësh nuk e dinte ende, se kujt duhet t'ia jepte votën e vet. "Shumica e njerëzve në Itali janë të lodhur dhe të mospërfillur nga politikanët. Në 20 vitet e fundit ata kanë bërë vetëm pak. Kanë bërë vetëm fjalë boshe," tha Marco Solazzo, dentist në Romë. "Njerëzit kërkojnë diçka të re, diçka tjetër". Ndryshe nga të tjerët është Bepe Grillo. Ai po feston suksese të mëdha me lëvizjen e tij të protestës "5 vje". Anketimet parashikojnë që ish-humoristi dhe aktori të marrë rreth 15 për qind të votave. Me këtë ai do të ishte forca e tretë politike pas socialdemokratit Bersani dhe konservatorit Silvio Berlusconi, por përpara kryeministrit teknokrat, Mario Monti. Me sharjet e tij me humor kundër establishmentit dhe premtimeve boshe, Grillo ka tërhequr dhjetëra mijëra vetë në sheshet e qyteteve italiane. Ai luan muzikë rep me tekstin "Ne jemi qytetarët dhe basta".

NUMËR NJË PA NGJYRË


Pier Luigi Bersani, i cili kryeson në anketime me disa pikë përpara Berlusconi, kandidati kryesor i Aleancës Mes-1 Majtë përshkruhet në mediet italiane si person pa ngjyrë. Ai ka qendruar i rezervuar dhe nuk është futur në polemika të mëdha.

Katër koalicionet

Protagonistët e zgjedhjeve parlamentare të 2013-ës

Katër koalicione të mëdha janë përbërë njëra-tjetër, koalicioni i qendrës kryesuar nga kryeministri në ikje Mario Monti, tjetri kryesuar nga kandidati i qendrës së djathtë, paraardhësi Silvio Berlusconi, i treti nga lideri i së majtës, Pier Luigi Bersani dhe i katërti, trazuesi i jetës së politikës italiane, ish-komiku Beppe Grillo.

Sipas sondazheve të fundit, Partia Demokratike e Bersanit është favorite me 34 për qind të votave. Por nuk është e sigurt nëse ai do të mund të sigurojë një stabilitet politik. Ajo mund të sigurojë dhomën e deputetëve, pa pasur një maxhorancë të mjaftueshme në Senat, drejtuar nga rregulla zgjedhore të ndryshme, por që kanë një peshë politike të ngjashme. Një hipotezë që ka rritur shqetësimin e tregjeve dhe partnerëve evropianë të Italisë. Është veçanërisht, Beppe Grillo, i vetmi që ka bërë një fushatë të vërtetë në terren duke udhëtuar në mbarë Italinë në bordin e rulotit të tij me



Pier Luigi Bersani



Silvio Berlusconi



Beppe Grillo




Mario Monti

një ekip të ashtuquajtur "tsunami-tour", që mund të turbullojë lojën. Katalizator i akteve të lindura si pasojë e krizës tek të rinjtë e papunë apo te drejtuesit e ndërmarrjeve të vogla, që protestojnë kundër partive tradicionale, ai ka tërhequr disa me


një program të quajtur "populist" nga kundërshtarët, me të ardhura minimale prej 1000 eurosh, reduktimin e pagave të politikanëve, reduktimin e punës javore në 20 orë dhe ... daljen nga zona euro. E panjohura tjetër, pikët e Silvio

Berlusconi, partia e padëshiruar dhe e larguar në muajin nëntor 2011 duke e lënë Italinë në prag të asfiksionit financiar, që pati një rritje spektakolare në sondazhe pasi e zhvilloi fushatën e sajë në bazë të temës për uljen e taksave

duke ndjekur të majtën me disa pikë. Mario Monti, i cili gëzonte një popullaritet shumë të mirë në vend për rikthim e besueshmërisë të Italisë në tregje, rrezikon të vuajë pasojat e politikës shtrënguese që ka zhytur vendin në recesion.



DHOMA E DEPUTETËVE



Të majtët marrin deputetët, ndërsa të djathtët Senatin

PDL-Lega përmbysën parashikimet

ROMË

Emajta italiane kryeson në zgjedhjeve legjislatve për Dhomën e Përfaqësuesve, por e djathta e Berlusconi mbizotëron në Senat duke shtuar kështu shqetësimet për paqëndrueshmërinë e qeverisë së ardhshme. Në Dhomën e Përfaqësuesve, koalicioni i së majtës i kryesuar nga kreu i Partisë Demokratike (PD) Pier Luigi Bersani mori 34.5 për qind të votave duke dalë përpara koalicionit të djathtë të Silvio Berlusconi me 29 për qind, sipas sondazheve nga rrjeti televiziv "Sky TG-24". Kështu që e majta do të ketë shumicën absolute të vendeve në Dhomën e Përfaqësuesve, që sipas sistemit zgjedhor ka një përparësi koalicioni në krye. Por në Senat është koalicioni i djathtë i kryesuar nga Silvio Berlusconi është në krye, sipas shifrave të "exit poll"-eve. Sipas Institutit "Tece", që ka realizuar "exit poll"-e për llogari të rrjetit televiziv "Sky", e djathta ka marrë 31,9 për qind dhe e majta 28,7 për qind. Institutit "Piepoli", që ka realizuar "exit poll"-e për llogari të rrjetit televiziv "RAI", i jep 31 për qind të votave të djathtës, kundrejt 29,5 për qind për të majtën. Perspektiva e shumicave të kundërta e Dhomën e Përfaqësuesve dhe në Senat tregon shqetësimet e tregjeve financiare, që dyshojnë më tepër se kushdo në një paqëndrueshmëri qeverisjeje të ekonomisë së tretë të eurozonës, aktualisht në recesion dhe me një borxh prej me më tepër se 120 për


qind të GDP-së. Bursa e Milanos regjistroi një rënie në -0,10 për qind menjëherë pas publikimit të parashikimeve në favor për të djathtën në Senat, që kundërshtuan "exit poll"-et e para duke nxjerrë të majtën fituese në të dy dhomat. Partia e Beppe Grillo

marrë rreth 20 për qind të votave në Dhomën e Përfaqësuesve duke dalë përpara koalicionit të qendrës i kryesuar nga kryeministri në detyrë Mario Monti, i cili renditet në vendin e katërt me rreth 10 për qind. Partia e Beppe Grillo do të jetë gjithashtu partia e parë në Senat me 25,1 për qind të votave, para Partisë Demokratike (PD), lëvizja kryesore e të majtës italiane mori 25 për qind, e ndjekur nga partia Populli i Lirisë (PDL) e Silvio Berlusconi, me 22,7 për qind. Pas votimit dje rreth orës 10:00 GMT i rrethuar nga një turmë gazetarësh, Berlusconi deklaroi: "Historia do të ndryshojë pak, do të shohim se si".

Kriza dhe masat e shtrëngimit ekonomik të vendosura 15 muajt e fundit nga qeveria teknokrate e Mario Montit kanë ndikuar gjithashtu në këto zgjedhje. Silvio Ber-

lusconi, i cili u largua në nëntor të vitit 2011 duke lënë pas një Itali në prag të asfiksionit financiar, kreu një rikthim spektakolar duke premtuar uljen e taksave dhe madje shlyerjen e një takse për pronat, e vendosur nga qeveria Monti.

Për sa i përket "profesorit" Monti, i cili gëzon një popullaritet të fortë për vendosjen e besimit në Itali, ai po e pëson si pasojë të efekteve të masave të shtrëngimit ekonomik. Për sa i përket përqindjes së pjesëmarrjes, ajo arrin në 75,41 për qind për votimin e Dhomës së Përfaqësuesve dhe 74 për qind për Senatin, sipas shifrave të fundit në dispozicion, realisht në ulje krahasuar me vitin 2008.



Senati

Projeksioni për shpërndarjen e vendeve në dhomën e lartë të parlamentit italian. Qendra e majtë ka më shumë vota, por më shumë senatorë ka marrë qendra e djathtë e Berlusconi

REZULTATET E PARA	
DHOMA E DEPUTETËVE	
1. Qendra e Majtë - Pier Luigi Bersani Bersani i PD	32.0 %
2. Qendra e Djathtë Silvio Berlusconi	29.5 %
3. Lëvizja 5 Yje Pebbe Grillo	24.0 %
4. Koalicioni i Qendrës Mario Monti	9 %
5. Revolucionari Civile	0.9 %
SENATI	
1. Qendra e Majtë - Pier Luigi Bersani Bersani i PD	32 %
2. Qendra e Djathtë Silvio Berlusconi	29 %
3. Lëvizja 5 Yje Pebbe Grillo	24 %
4. Koalicioni i Qendrës Mario Monti	9.1 %
5. Revolucionari Civile	0.9 %
RAJONET – Rinovimi i këshillave rajonal dhe Presidentët	
LOMBARDIA	
Umberto Ambrosoli	Qendra e majtë
Roberto Maroni	Qendra e Djathtë
Gabriele Albertini	Qendra
Silvana Carcano	Lëvizja 5 Yje
Carlo Maria Achille Pinardi	Të ndalojmë rrëzimin
MOLISE	
Paolo Di Laura Frattura	Qendra e majtë
Angelo Michele Iorio	Qendra e Djathtë
Antonio Federico	Lëvizja 5 Yje
Antonio De Lellis	Revolucioni Demokratik
Massimo Romano	Të bëjmë Molisen
Camillo Colella	Lavoro Sport e Sociale).
LAZIO	
Nicola Zingaretti	Qendra e Majtë
Francesco Storace	Qendra e Djathtë



AKU sot jep përgjigjen e analizave për qumështin

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka Amarrë mostra për të verifikuar qumështin që tregtohet në vend. Këto vijnë pas alarmit të dhënë nga Autoriteti i Ushqimit dhe Veterinarisë në Kosovë se disa lloje qumështi që tregtohen atje rezultojnë me përbajtje të aflatoksinës. Nga zyrtarë të AKU përgjigjet e analizave të qumështit pritet të bëhen publike për

konsumentin ditën e martë. Deri tani, përveç alarmit të dhënë nuk ka ende një përgjigje zyrtare mbi vërtetësinë e dyshimeve për mbingarkesë të aflatoksinës në këto produkte. Aflatoksina mund të shkaktojë tumor të mëlçisë, hemoragi, enjtje, probleme në tretje, probleme në metabolizmin e organizmit, probleme mendore e deri në gjendje kome. Vetmë

pak ditë më parë u hodhën dyshimet për prezencën e aflatoksinës në disa lloje qumështi që eksportoheshin në Kosovë nga vendi ynë. Pas bërjes publike të dyshimeve, Ministria e Bujqësisë deklaroi se janë marrë mostra për analiza të menjëhershme dhe u shpreh se AKU ka bërë kontrole periodike apo dhe të befasishme tek prodhuesit dhe importuesit e qumështit.

LAJME SHKURT

■ Minibashkive do t'u shtohen funksionet

Kryetari i Bashkisë Basha, i ka propozuar Këshillit Bashkiak në mbledhjen e datës 28 shkurt, të miratojë delegimin tek 11 njësitë bashkiake të kompetencave që lidhen me kontrollin e territorit të tregjeve, me sigurinë etj. "Njësitë vendore të Tiranës nuk do të ekzistojnë më vetëm për të firmosur certifikata, por ato do të kenë një sërë kompetencash", u shpreh nënkryetari i Bashkisë së Tiranës, Jorida Tabaku. Pas miratimit në Këshillin Bashkiak, njësitë vendore do të ushtrorjnë pjesërisht funksionet e sigurimit, të rendit e qetësisë dhe mbarëvajtjes së punëve publike brenda territorit përkatës, funksionet e kontrollit dhe zbatimit të ligjshmërisë e të standardeve teknike në fushën e ndërtimit.

■ Mediu: Duhet marrë masa për pyjet

Gjatë viteve të fundit në Shqipëri janë, shkatërruar nga zjarri por edhe nga prerjet e paligjshme të firmave, me qindra hektar pyje. Ministri i mjedisit në lidhje me këtë çështje u shpreh se duhet të forcohen masat jo vetëm nga strukturat e shërbimit pyjor, por edhe nga Ministria e Ekonomisë për firmat që shfrytëzojnë tregun minerar dhe atë drusor. "Janë sipërfaqe të mëdha pyjesh që për shkak të ligjit që është në fuqi hiqen nga fondi pyjor", tha Mediu. Deri më tani rreth 450 hektarë ose 16 për qind e sipërfaqes së vendit ka status specifik të mbrojtjes

■ ISHKSH: për 2012 pagat u rritën deri në 5 përqind

Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor të të vija me rritje e pagave për të gjithë mjekët dhe infermierët e sistemit shëndetësor edhe përgjatë këtij viti. Sipas ISKSH-së, "ritja e pagave është dyfishuar që nga viti 2005. Për vitin 2012, sipas ISKSH-së, rritja ka qenë nga 2 deri në 5% për pagat e mjekëve të familjes dhe infermierëve të qendrave shëndetësore në të gjithë vendin. Kështu, gjatë vitit të kaluar, paga mesatare për një mjek në kujdesin parësor arriti në 61 mijë lekë në muaj. Ndërsa për infermierët, pagat në qendrat shëndetësore variojnë nga 35.500 deri në 40.000 lekë.

Vendimi për "Anti-Bllokun" diskutohet të enjten Bashkia, memorial pa leje te vila 30

Ervin Bushati: Bëhet për efekt elektoral

Lajmi
Bashkia e Tiranës, ka filluar punën për memorialin "Post-blok" endepa marrë miratimin në këshillin bashkiak. Që një punë publike të fillojë nga bashkia, duhet që ajo të marrë miratimin nga këshilli, të bëhet projektim, preventiv dhe më pas tenderimi. Ndërkohë që puna për memorialin "POSTBLOK" nuk ka kaluar në asnjë nga këto etapa.

■ ■ ■ TIRANE
JONIDA LATE



NË FOTO: Pamje nga punimet për memorialin "Postblok" (në rreth) në lulishten përballë Hotel Rogner

Deri para pak javësh, një bunker në qoshe të Kryesisë së Kuvendit, aty ku ndodhet busti i Ismail Qemalit, kujtonte më së miri afro 50 vjet diktaturë të egër. Ndërsa sot, në vend të tij, një memorial, do të kujtojë të njëjtën periudhë, por në një aspekt tjetër. Bunkeri që dikur mund të "mbronte me zjarr" hyrjen e Komitetit Qendror, pranë lulishtes së "Vila 30", është hequr. Disa dërrasa e llamarinat kanë rrethuar zonën e pikërisht, aty ka nisur të ndërtohet një memorial që do të përkujtojë të burgosurit e "viteve të bunkerit". Por, duket se, memoriali që do të marrë emrin "POSTBLOK", ka nisur të ndërtohet pa asnjë leje. Ndërsa vendimi për këtë memorial do të diskutohet të enjten. Ervin Bushati këshilltar i majtë në Bashkinë e Tiranës, njëkohësisht edhe kryetar i komisionit të këshillimeve publike ka deoncuar këtë fakt. Ai në një prononim për "Shqiptarja.com" është shprehur se puna për memorialin nuk ka kaluar në asnjë etapë. "Puna për këtë memorial nuk ka kaluar as në komision ekonomik, as nuk është miratuar nga këshilli bashkiak. Sepse për të filluar një punë duhet të kalojmë njëherë në këshillin bashkiak për miratim, duhet të diskutohet në komision ekonomik, duhet të bëhet preventivi, pas bërjes së preventivit duhet të bëhet tenderimi. Dhe pas tenderimit hapen fondet dhe fillon puna. Kurse aty ka filluar puna pa kaluar në këto etapa" u shpreh Bushati. Më tej këshilltari i bashkisë ka thënë se me çështje e memorialit po bëhet një pazar i madh "Kjo puna që po bëhet ka një vlerë monetare,

Këshilltari i PS Florian Pullazi: Ulja e taksave nga bashkia bëhet për qëllime elektorale

■ ■ ■ TIRANE

Bashkia e Tiranë ka nxjerrë një vendim ku thuhet se do të hipotekohen 260 objekt, si e shkoni ju këtë vendim?

Çdo pallat ka kapacitetin e tij sa duhet të mbaj nga shtesat që janë bërë. Ndërsa Bashkia nuk ka sjellë asnjë dokumentacion të tillë, por vetme ka sjellë një projekt vendim. E nuk na është dhënë asnjë lloj relacioni, por vetëm na është sjellë një listë me emra pa asnjë lloj dokumenti. E gjithë çështja e hipotekimit është për efekt elektoral. Edhe në vendim thuhet që përfitojnë 50 mijë banorë dhe këtu është bërë ana politike e çështjes.

Çfarë pritet të sjellë kalimi

atë që filluar puna pa u bërë tenderi, firma që ka filluar punë aty e di që do fitojë tenderin. Këtu po bëhet një pazar i madh, është një korrupsion i madh. Se si mund ta fillojë punë një njëri nëqoftëse e di që nuk do



NË FOTO: Florian Pullazi këshilltar i majtë në Bashkinë e Tiranës

i disa kompetencave tek minibashkítë?

Edhe kjo është një lëvizje politike. Këto kompetenca duhet të kishin kaluar më parë. Në mbledhjen e fundit të Këshillit Bashkiak, nga mazhoranca u miratua

e fitojë tenderin. Punën aty e ka filluar një firmë dhe ku e di kjo që nesër do fitojë tenderin, ku e di që do miratohet ky si fond, ku e di që do miratohet ky si projekt" thotë Bushati. Eksperti i çështjeve ekonomike në PS, u

personel shtesë në çdo strukturë e bashkim. Ndërkohë para dy vitesh akuzon të numër shumë të madh të personelit në Bashkinë e Tiranës, ndërsa tani për çdo sektor në bashki ka shtuar 50 vetë personel. Kjo e gjitha bëhet për të hapur dyert për militantët para zgjedhjeve të qershorit.

Pse po bëhet pikërisht tani ulja e taksave për biznesin e vogël?

Në kemi disa muaj që i kemi bërë thirrje Bashkisë së Tiranë, qeverisë, që të rishikojë tatumit për biznesin. Madje kjo është një kopje e keqe e programi që ka Partia Socialiste, për të ndihmuar biznesin e vogël. Kjo gjë duhet të ishte bërë më parë. Në si këshilltari të Partisë Socialiste e kemi kërkuar me forcë heqjen e taksimit për biznesin e vogël. Sepse kjo e ndihmon këtë biznes, ndaj ne kemi kërkuar që të hiqet taksat për këtë biznes.

financiare e këtij memoriali ende nuk dihet. Ndërtimi i memorialit "PostBlok" nuk ka qenë në buxhetin e vitit 2013, por u ka ardhur si ide vetëm këto ditë e fundit është shprehur Ervin Bushati.

Krujë, arrestohet grabitësi i makinave luksoze

Policia e Krujës ka ndaluar një grabitës makinash luksoze. Ai është Afrim Xhixha, 33 vjeç, banor i Niklës, që rezultoi i dënuar më parë për shkatërrim prone me eksploziv dhe armëmbajtjes pa leje. Sëbashku me të, u arrestuan edhe dy persona të tjerë, të përfshirë në vjedhje, Eduard Xaka, 24 vjeç dhe Naim Murati, 44 vjeç, të dy banorë të

Krujës. Burime nga Drejtoria e Policisë së Durrësit, kanë bërë të ditur, se Xhixha ishte shpallur në kërkim në 14 janar 2013 nga komisarati i policisë së këtij qyteti, pasi është dokumentuar, se është bashkautor në vjedhjen e të paktën 10 automjeteve në zonën e plazhit, Durrës, duke përdorur teknikën e vjedhjes së autoveturave të ndezura në kohën, kur

drejtuesit e mjeteve shkëputeshin për pak minuta nga mjete. Grupi në fjalë synonte kryesisht vjedhjen e automjeteve të kushtueshme nisur nga marka apo kapaciteti. Gjatë kapjes, shtetasit të kërkuar Afrim Xhixha, iu gjet në trup një pistoletë, model 56 së bashku me krëhërin me fishekë, që u sekuestruan në cilësinë e provës materiale.

KAKAVIJE Blllokohen në kufi 5 kilogramë hashash

Trafikantët, armë e drogë drejt Greqisë


Dy të rinj, luftë me policinë helene

KAKAVIJE
ARTAN LILI

Lajmi

151 kg

Një sasi droge prej 5 kilogramësh është bllokoar në Kakavijë. Në pranga ka rënë Angelos Llazari, i cili e kishte blerë hashashin në Lazarat dhe po e dërgonte në Greqi. Ndërsa në Janinë, policia ka shkëmbyer zjarr me dy trafikantë shqiptarë, të cilët kishin një arsenal armësh me vete.



Droga e kapur dhe në Kakavije

Gomen rezervë të makinës e kishte shndërruar në çantë. Pasi kishte blerë 5 kilogramë hashash, i kishte ambalazhuar në 4 pako, duke i futur në gomën rezervë, të cilës i kishte hequr ajrin dhe e kishte rifitur në bagazh. Kështu, një plot 5 kilogramë mariuanë janë sekuestruar dje nga strukturat e drejtorisë së kufirit të Kakavijes, gjatë kontrollit në vijën e dytë në një automjet Citroen me targa greke YPN 1263. Drejtuesi i mjetit, Angelos Llazari, 27 vjeç, nga Himara është arrestuar menjëherë si poseduesi i marijuanës, të cilën kërkonte t'a trafikonte për 5 mijë euro në kryeqytetin grek, Athinë. Automjeti me marijuanën në bord është gjendur në Kakavije, në orët e mesditës së të hënës, ndërkohë që kontrollorët e pikës kufitare, kanë insistuar në kontrollin fizik të automjetit, pasi dyshohet se fshihej një sasi e pacaktuar

droge në pjesën e bagazhit. Kontrolli i kryer, nxori zbuluar 27-vjeçarim himariot, i cili nxitonte për t'u larguar menjëherë nga territori shqiptar. Kjo mesa duket, nxiti kurreshtjen e policëve kufitarë, për të ndërmarrë një kontroll të imtësishtëm në vijën e dytë kufitare. Marijuana prej 5 kilogramësh, është gjetur brenda gomës rezervë dhe ishte vendosur aty disa orë më parë në Lazarat, vend ku dhe ishte blerë.

Ndërkaq, një incident i rëndë është shënuar në kufirin shqiptaro-grek, mes Policisë Kufitare helene dhe dy shqiptarëve, trafikantë armësh. Ngjarja ka ndodhur në orët e mëngjesit të ditës së djeshme,

në thellësi të territorit grek, ku protagonistë kanë qenë dy të rinj shqiptarë, që kanë guxuar të luftojnë me arsenal armësh me forcat greke të sigurisë rajonale të Janinës. Situata ka qenë mjaft e ndezur por nuk ka pasur lëndime nga ana e policëve grek, të cilët luftuan deri sa janë larguar në thellësi të territorit shqiptar, dy të rinjtë tepelena. Policia e Gjirokastrës, ka konfirmuar egzistencën e konfliktit të armatosur në thellësi të territorit grek, ndërkohë që pranon se autorë të konfliktit janë dy të rinj nga tepelena, 25 dhe 27 vjeç. Për Policinë e Gjirokastrës, personat janë elementë të rrezikshëm dhe potencial krimi, pasi rezultojnë të jenë

HASHASH
U sekuestruan të premtën në mbrëmje nga policia greke. Droga shkante nga Lazarati dhe kishte udhëtuar përmes Sarandës, me një makinë të Ministrisë greke të Drejtësisë

autorë të një sërë vjedhjesh me armë në territorin grek. Policia e Janinës, kishte angazhuar në luftën e armatosur 30 minutëshë buzë kufirit me Shqipërinë, forca të shumta speciale. Dy të rinjtë shqiptarë, që guxuan të kalojnë kufirin, injoruan paralajmërimet e policëve grekë në kufi, për t'u kthyer në territorin shqiptar, ndërkohë që këtu u ndez konflikti i armatosur mes dy palëve. Shqiptarët e armatosur, kanë qëlluar pa paralajmërim me armë automatike në drejtim të patrullës greke, ndërkohë që në

largësi, veprimet e trafikantëve shqiptarë, janë vëzhguar mjaft mirë përmes mjeteve të avancuara logjistike. Lufta e armatosur nuk ka zgjatur më shumë, se 30 minuta ndërkohë që mbërritja e forcave shtesë nga Janina, eklipsoi luftimet e mëtejshme të dy shqiptarëve të armatosur. Policia Greke e Janinës, pasi nuk mundi dot të kapte dy trafikantët e armëve, arriti të sekuestronte disa armë dhe municioni luftarak, por nuk mësohet numri i tyre. Në aksionin e djeshëm, në luftën kundër trafikut të armëve luftarake mes dy shteteve, janë angazhuar forcat e Policisë së Qarkut dhe asaj Kufitare të Gjirokastrës, si dhe ajo e Janinës.

"Boboshtica"



Shtyhet gjyqi për dhunimin e varreve

Shtyhet për herë të dytë Seanca në ngarkim të tre të akuzuarve për dhunimin e varreve në fshatin Boboshticë, Naum Disho, Alqi Koroveshi dhe Luan Zaçe. Seanca në Apel është shtyrë pasi organi i akuzës kërkoi caktimin e një eksperti të dytë urban, i cili së bashku me ekspertin Evana Vangjeli, të caktuar në seancën e kaluar do të përcaktojnë nëse ndërtimi i platformës prej betoni, si dhe shkallët e memorialit të ushtarve grekë, quhet ndërtime, në kuptimin e ligjit të urbanistikës, njëkohësisht nëse kjo sipërfaqe quhet apo jo varrezë. Edhe në këtë seancë, ka munguar i akuzuari kryesor, kreu i "Omonias", Naum Disho.

Reshjet e shiut

Blllokohen rrugë e përmblyten banesa në Jug

Gjanica del nga shtrati, Vlora shndërrohet në Venecia. Shëmbje dhe edhe në rrugë

Moti i keq me reshje të dendura shiu ka shkaktuar probleme të shumta në disa rrethe të vendit duke vështirësuar lëvizjen e automjeteve që kanë kaluar në akset kryesore. Po ashtu, janë shkaktuar përmbutjet e shumë zonave e shtëpive. Në qytetin e Vlorës shirat intensivë të rënë gjatë 24 orëve e fundit kanë mbuluar disa nga rrugët e qytetit, pasi kanalizimet, që thithin ujën nuk e përballojnë dot intensitetin e shirave, duke e bërë kalimin e qytetarëve apo të automjeteve tepër të vështirë. Moti i keq shkaktoi defekte edhe në sistemin e energjisë elektrike, duke lënë pa drita disa lagje të Vlorës. Kapiteneria e Vlorës thotë, që moti i keq do të vijojë edhe për 24 orët në vazhdim duke pezulluar punën në det. Edhe në aksin nacional



Ballsh-Fier është bllokuar qarkullimi i mjeteve, për shkak të rënies së një masivi gurësh nga skarpitetet e maleve. Drejtuesit e mjeteve janë bllokuar në trafik për rreth 1 orë, ndërsa specialistë të Drejtorisë së rrugëve po marrin masa për hapjen e aksit. Shirat e orëve të fundit të ditës së djeshme, sidomos ai mbrëmshmi dhe ai gjatë gjithë ditës, që ka rënë me intensitet të madh në zonën e Mallakastrës dhe në jug të vendit tonë, ka bërë që të dalë nga shtrati për të disatën herë lumi Gjanica. Lumi, i cili kalon mes për mes qytetit të Fierit, ka nisur të vijë më rëmbim në orët e mbsaditës së djeshme dhe më pas furia e tij e madhe ka arritur kulmin rreth orës 19:00. Gjanica ka rrembyer gjithçka i ka dalë përpara. Kanë qenë pikërisht

tregtarët e tregut industrial të vendit të quajtur "Ura me Shkallë", ngritur në breg të lumit që kanë dhënë alrmin të parë duke njoftuar njëri-tjetrin për situatën e krijuar. Uji ka arritur deri në brendësi të disa banesave pranë lumit duke shkatëruar dëme të shumta material. Mësohet se nga shirat e rrembyer ka rreshqitur toka në vendin e quajtur Visok, duke bllokuar rrugën nacionale përreth një orë. Po ashtu, edhe në aksin Gjirokastrë-Tepelenë, në vendin e quajtur Shkalla e Zezë, një masiv shtufor ka zënë një pjesë të rrugës, çka ka penguar qarkullimin normal të automjeteve. Moti i keq ka krijuar paqëndrueshmërinë e formacionit shtufor nga skarpitetet e malave dhe mund të përsërisë situatën e një muaji më parë, në këtë aks nacional.



DOSSIER

Dokumenti

RELACIONI i ish-ministrit për Hysni Kapon, hartuar në kulmin e periudhës së sistemit të kaluar, përbën një dokument të rëndësishëm për të bërë krahasimin me fenomenin që në ditët e sotme ka marrë përmasa shqetësuese

Kadri Hazbiu në '70: Ja arsytet e vetëvrasjeve në RPSH

Raporti i Ministrisë së Brendshme: Për shkak të kritikave "para kolektivit", ka të rinj "sedërliinj" që shkojnë me ndërgjegje drejt vdekjes

TIRANE
ARMAND PLAKA

Fenomeni nuk është produkt i rendit tonë ekonomik-shoqëror. Kështu konstatonte diku në relacionin e nisur për shefin e tij në vijë hierarkike partiake, ish-Ministri i Brendshëm, Kadri Hazbiu në vitin e largët 1970. Ky është një vit që mbart shumë simbolikë, pasi mund të merret si etalon i gjithë periudhës së sundimit komunist në Shqipëri, duke përfshirur kohën që i mbeti për të "qeverisur". Bëhet fjalë për një informacion në formën e një analize mbushur me statistika e të dhëna konkrete, ku rreshtohen me pika të veçanta edhe arsytet që i shtynin njerëzit në atë kohë të vrisnin veten, dhe sigurisht në fund jepjen edhe "recetat" që do të çonin në minimizimin apo shuarjen e këtij fenomeni. Në pamje të parë të duket një dokument fare rutinor, por diskutimi mbi vetvrasjen ishte një temë shumë e rezervuar, apo më mirë le të themi një tabu, për të cilën duhet të kishin dijeni në shifra të plota e të sakta, vetëm krerët më të lartë të shtetit. Ai na jep një panoramë të qartë mbi shtrirjen e këtij fenomeni në fshat e qytet, prevalencën moshore, shkaqet dhe pasojat etj. Të bie në sy, se në rrethet malore për shembull, në raport thuhet se nuk ishin regjistruar fare ose shumë pak vetvrasje. Por pohej se veten e vrisnin më shumë në fshat se sa në qytet, çka ndoshta rezultoi në vijojë me të njëjtën tendencë edhe në ditët e sotme, megjithëse ky është vetëm një perceptim publik e nuk përbën rezultatet e një studimi të mirëfilltë empirik. Rezultonte se: "në vendin tonë çdo vit ka pasur mesatarisht 2.8 vetvrasje për çdo 100.000 banorë", dhe krahasimi bëhej me vendet "kapitalisto-revizioniste", ku thuhej se ky numër ishte rreth 18 herë më pak se mesatarja e tyre, porse në mungesë të të dhënave të plota nuk mund ta pohojmë apo mohojmë këtë konstatim. Kjo i korrespondonte një numri total prej 282 rastesh vetvrasje gjatë periudhës 5-vjeçare 1966-1970. Ndërsa ndër shkaqet që e shkaktonin vetvrasjen në ish-Republikën Popullore të Shqipërisë, renditeshin: sëmundjet psikike, patriarkalizmi në familje dhe zakonet të zakonit pranike të fejesës dhe martesës, sëmundjet trupore, "amorpropi mikroborgjez" dhe sedra e sëmurë, ndjenja e pronës private dhe bestytnitë fetare, thashethemet, shpifjet dhe intrigat. Po ashtu rezultonte se më shumë, në atë kohë vendin ndër shqiptarët e vrisnin meshkujt, që zinin pothuajse dyfishin e përqindjes në krahasim me seksin e kundërt, kurse në aspektin moshor, përqindja më e madhe, ishte ajo e moshës 50 vjeç e lart. Interesant është pohimi se: për shkak të kritikave "para kolektivit" (e

ku të vijnë më së pari ndërmend edhe fletë-rufetë famëkeqe), haseshin të rinj me "sedër të sëmurë", e tipa të ndjeshëm, që arrinin deri në vetvrasje.

Nëse hyn më thellë dhe tenton të bësh një krahasim me kohën e sotme, konstaton lehtësisht se shumë nga arsytet që i çonin njerëzit atëherë në vetvrasje, sot ndoshta nuk ekzistojnë më fare dhe na duken tërësisht qesharake, por nga ana tjetër, sot mund të pohojmë me siguri se janë shtuar arsytet e reja (përveç shumë prej të vjetrave që akoma ekzistojnë) e fenomeni ka marrë përmasa edhe më shqetësuese. Materiali që po botojmë sot, ka qenë i klasifikuar SEKRET (AQSH, F14 /AP STR V.1970, D. 68, fl.3-9) dhe botohet për herë të parë. Ai përbën kështu një bazë të mirë krahasuese për publikum e gjerë, por sidomos për ekspertët e fushave përkatëse, për të parë "evolimin" që ka bërë shoqëria shqiptare, për mirë apo për keq në këtë aspekt, dhe sot. Në vijim, ju ftojme të lexoni raportin e plotë (ku janë hequr vetëm shumë pak pjesë të konsideruara si të "parëndësishme" nga pikëpamja aktuale):

REPUBLIKA POPULLORE
E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
DREJTORIA E POLICISË POPULLORE

Sekret

Tiranë më 5. 12. 1970

Lënda: Informacion mbi vetvrasjet

SEKRETARIT TË KOMITETIT
QËNDROR TË PPSH
(SHOKUT HYSNI KAPO)

TIRANË

Nga analiza që i bëmë kohët e fundit shkaqeve të vetvrasjeve të ndodhura në vendin tonë, kemi arritur në disa konkluzione që po i radhim më poshtë:

Patriarkalizmi në familje dhe zakonet pranike të fejesës dhe martesës, zënë afro 25% të rasteve. Këto kanë ndodhur më tepër te femrat në moshë të re dhe mesatare

I. Gjatë periudhës 1966-1970, në vendin tonë kanë ndodhur 282 raste vetvrasje. Duke marrë si bazë për krahasim vitin 1966, më 1967 ato patën një rritje prej 37%, më 1968 21%; ndërsa më 1969 u ulën 2%, dhe më 1970, 9%.

Të marra në krahasim me numrin e popullsisë, në këto 5 vjet në vendin tonë çdo vit ka pasur mesatarisht 2.8 vetvrasje për çdo 100.000 banorë, ose rreth 18 herë më pak se mesatarja e publikuar në vendet kapitalisto-revizioniste.



Ish-ministri i Brendshëm, Kadri Hazbiu

Sipas seksit, 67.7% kanë qenë meshkuj, kurse 32% femra: sipas moshës, 4.4% kanë qenë 14-18 vjeç (nga këta 35% femra), 26% të moshës 18-25 vjeç (nga këta 60.9% femra), 16.5% të moshës 25-36 vjeç (nga këta 49.4% femra), 18.5% të moshës 35-50 vjeç (nga këta 37.4% femra) dhe 34.5% të moshës 50 vjeç e lart (nga këta 22.5% femra).

Nga tërësia e rasteve të vetvrasjeve, rezultoi se 65% e tyre kanë ndodhur në fshat, ndërsa 35% në qytet. Më të theksuara këto kanë qenë në rrethet Tiranë, Durrës, Shkodër e Elbasan (të cilat në përqindjen më të madhe e kanë patur në qytet) dhe Korçë, Vlorë, Kukës e Dibër (të cilat përqindjen më të madhe e kanë pasur në fshat). Bie në sy që në disa rrethet malore si Tropoja, Skrapari, Përmeti, Pogradeci e Kolonja, raste të tilla nuk ka patur fare, ose ato kanë qenë të pakta.

..në rrethet malore, në raport thuhet se nuk ishin regjistruar fare ose shumë pak vetvrasje. Por pohej se veten e vrisnin më shumë në fshat se sa në qytet

II. Vetvrasjet në vendin tonë nuk janë produkt i rendit tonë ekonomik-shoqëror, por shfaqje të disa fenomeneve kontraktore që hasen gjatë zhvillimit e ecjes përpara të revolucionit socialist. Sipas studimit tonë, shkaqet kryesore të vetvrasjeve janë:

1. Sëmundjet psikike, që zënë afro 39% të rasteve. Këto janë shfaqur në formën e depresioneve të ndryshme, maninë e persekutimit, etj. më shumë në meshkuj e në


persona të moshave mesatare dhe të kaluara. Kjo shpjegohet edhe me atë që thekson shkenca e psikiatrisë e që vërteton praktika kriminalistike se, kur këto sëmundje shfaqen në këto moshë, ato çojnë në të shumtën e rasteve në vetvrasje, për vetë ndryshimet regressive organiko-fiziologjike, psikiatrike e të tjera që ndodhin në këta persona.


2. Patriarkalizmi në familje dhe zakonet pranike të fejesës dhe martesës, që zënë afro 25% të rasteve. Këto kanë ndodhur më tepër te femrat në moshë të re dhe mesatare, kryesisht në fshat, të cilat, të dëshpëruara nga keqtrajtimi në familje dhe nga mospërkrahja e opinionit shoqëror, nuk kanë patur kurajon të ngrihen hapur për të mbrojtur të drejtat e tyre dhe kanë vrarë vehten.

3. Sëmundjet trupore që zënë afro 19% të rasteve. Këto janë shfaqur më tepër në meshkuj dhe femra të moshave të kaluara, të cilët kanë vuajtur nga sëmundjet të tilla si kancer, ulçera, koleksione sëmundjesh, etj., e që kanë patur dijeni për llojin e sëmundjes, kanë humbur shpresën e shpëtimit e kanë rënë në dëshpërim dhe e kanë konsideruar vetvrasjen si të vetmen rrugë për të shpëtuar nga dhimbjet.

4. Amorpropi mikroborgjez dhe sedra e sëmurë, që zënë afro 8% të rasteve. Këto janë shfaqur më shumë në femra për shkak xhelozie dhe meshkuj në moshë të re, në disa raste ushtarë, që janë kapur në shkelje të disiplinës, në delikte të vogla ose dëme në bujqësi, grindje, etj., për të cilat do të jepnin llogari e do të kritikoheshin para kolektivit, por që duke qenë me temperament shumë të ndjeshëm, janë prekur në sedër e kanë vrarë vehten.

5. Ndjenja e pronës private dhe bestytnitë fetare, që zënë afro 5% të rasteve. Këto janë shfaqur kryesisht në meshkuj të moshave të kaluara, njerëz që nuk janë pajtuar me masat revolucionare që janë marrë në drejtim të forcimit të marrëdhënieve socialiste në prodhim (siç janë shkurtime i kopshteve personale të





TABUJA Si shumë çështje të tjera në atë kohë, edhe diskutimi mbi vetvrasjen ishte shumë i rezervuar, apo një temë tabu, për të cilën duhet të kishin dëjani në shifra të plota e të sakta, vetëm krerët më të lartë të shtetit


RAPORTI:

Vetëvrasjet në Shqipëri, nuk janë produkt i rendit shoqëror!

e ndjeshme në rast se do të mënjanohehin disa të meta të punës sonë në këtë drejtim. Sipas mendimit tonë, çështja kryesore e themelore për evitimin e vetvrasjeve është zbulimi i shkaqeve të vërteta, e sidomos e atyre indirekte. Kjo kërkon një kuptim të thellë ideologjik e politik të faktit se në shoqërinë tonë nuk ka arsye objektive për të patur një shtrirje të tillë të vetvrasjeve (veç sëmundjeve psikike të pashërueshme, që kanë

të moralit etj.) dhe, kur

Baza këtu është si konservatorizmi, prindëror e shoqëror, maskuar kryesisht me "përvojën", ashtu edhe gjykimet e qëndrimet e shfrenuara të të rinjve, të maskuara me "emancipimin e liritë individuale". Moskuptimi i këtij lloj fenomeni, çon në konflikt të herë pashershëm në familje e në sfaqje e veprime të tjera të dëmshme (bojkotime ose largime nga prindërit etj.) dhe, kur çështjet dramatizohen nga thashethemet e të nxitura nga një sedër e sëmurrë, ose nga pazotësia e të rinjve për të gjetur rrugëdalje, ato çojnë në kryerjen e aktit të vetvrasjes. Këtu e kanë burimin kryesor edhe vetvrasjet e personave me moshë të re (14-25 vjeç), të cilat zenë 30,4% të të gjitha vetvrasjeve. Në trajtimin e kësaj çështje, nuk ka patur një kuptim në shkallën që kërkohej.



Faksimile e relacionit të ish-Ministrit të ish-Brendshme të Brendshme për Hysni Kapon, më 5. 12. 1970

Një kujdes më i madh duhet t'i kushtohet këtij problemi, mendojmë ne, edhe nga organet e pushtetit në bazë dhe organizatat shoqërore, të cilat disa herë nuk i vlerësojnë sa duhet indicet që bëhen shkak për vetvrasje, siç janë grindjet në familje, pakujdesia për të sëmurrët, kundërshtimi i martesës së imponuar nga prindi, shpifjet dhe thashethemet, etj. Dhe nuk ngrihen në luftë për t'u prerë rrugën. Në disa raste, kritika publike për njerëzit që kryejnë delikte të vogla është përdorur shabllon, pa shikuar temperamentin e personit, sidomos kur ky është i ri, në mënyrë që të menjanohehin disa pasoja të hidhura, duke përdorur ndaj tyre forma të tjera edukative.

tendencë të tillë). Rrjedhimisht, çdo shkak që në sipërfaqe mund të duket normal me ngjarjen konkrete, me një kujdes e qëndrim korrekt nga ambienti familjar e shoqëror, është plotësisht i evitueshëm.

Problemi i forcimit të përgjegjësisë dhe edukatës në familje, i futjes më mirë në botën shpirtërore e psikologjike e njeriut dhe, në varësi me të, të ndërtohet edhe metoda e trajtimit drejt të tij, që ai të lehtësohet në vuajtjet dhe të kalojë vështirësitë e krijuara nga pesimizmi për të jetuar, del në dy drejtime:

a) Në kujdesin më të madh që duhet të tregojnë fëmijët ndaj prindërve, për t'u siguruar atyre një jetë më normale, sidomos nga ana ekonomike. Këtu, në keqtrajtimin dhe mos sigurimin e jetesës nga ana e fëmijëve, e kanë burimin rastet e vetvrasjeve të disa prindërve (babë e nënë) me moshë të kaluar.

b) në kujdesin më të mirë që duhet të tregojnë prindërit për fëmijët, sidomos në moshën e parajekurisë së tyre, për mjaft çështje të jetës. Rrjedhimisht, kujdesi prindëror e shoqëror, kryesisht ai i organizatës së rinisë, duhet të konsistojë në atë që kontradiktat që lindin midis kërkesës së të rinjve për të hedhur hapa përpara dhe jekurisë relativisht të pamjaftueshme të tyre në këto moshë, të zgjidhen pa kaluar në gjykimet e veprime ekstreme në mjaft çështje: të dashurisë, qëndrimit ndaj punës e normave

Mjaft preokupant paraqitet edhe problemi i shtrimit e kurimit në spitalet neuropsikiatrike për të sëmurrët psikikë, të cilët paraqesin agresivitet e rrezikshmëri të madhe dhe, që siç dihet, veç vetvrasjes, kanë arritur të kryejnë edhe vrasjet të shëmtuara (21 raste brenda viteve 1966-1970). Është vendosur që për sistemin e tyre brenda tremujorit të parë të vitit 1971, të shtohet një aneks në spitalin e Elbasanit, por deri më tani, në këtë drejtim nuk punohet aspak seriozisht.

Ndjenja e pronës private dhe bestytnitë fetare, ... afro 5% të rasteve. Kryesisht në meshkuj të moshave të kaluara, që nuk janë pajtuar me masat revolucionare

Ne jemi të bindur se mobilizimi i organeve të brendshme dhe i organeve të tjera shtetërore e organizatave shoqërore nën udhëheqjen e Partisë, në drejtimet që u përmendën më lart, do të sjellë uljen në minimum të këtyre akteve në vendin tonë në të ardhmen.

MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME KADRI HAZBIU

kooperativistit, etj.) dhe me luftën kundër ideologjisë fetare, sidomos ish-klerikë, ungjillore e elementë fanatikë, etj..

6. Thashethemet, shpifjet dhe intrigat, që zenë afro 3% të vetvrasjeve (pa llogaritur këtu rastet e shumta që janë evituar, si dhe ato që kanë përfunduar në plagosje, tronditje psikike e pasoja të rënda). Këto kanë ndodhur në minimum të këtyre akteve në vendin tonë në shtetërorë e organeve të tjera shtetërore e organeve të Partisë, në drejtimet që u përmendën më lart, do të sjellë uljen në minimum të këtyre akteve në vendin tonë në të ardhmen.

ndodhur në të rinj, meshkuj e femra, të cilëve u është krijuar situatë e rëndë dhe u ka munguar kurajua ose nuk kanë gjetur mbështetje për të demaskuar shpifjet e intrigantët.

III. Tendenca e uljes së vetvrasjeve, që vihet re dy vjetet e fundit, është fenomen objektiv që lidhet me ecjen përpara të shoqërisë sonë, por kjo ulje do të ishte akoma më



Intervista

DEBATI mbi kthimin e eshtrave të Sami Frashërit. Flet Studiuesi Jorgo Bulu: Ja argumentet pse duhen kthyer në atdhe eshtrat e tij

JORGO BULO:

Sami Frashëri na takon më shumë neve, ikona e Rilindjes

Ja letra surprizë e Jani Vretos dërguar Thimi Mitkos, ku flitet për fjalorin e shqipes hartuar nga Samiu

TIRANE

DHURATA HAMZAI

Një histori që përsëritet. Pas refuzimit për kthimin e eshtrave të Sami Frashërit nga shteti turk në kohën e regjimit komunist në Shqipëri...shteti shqiptar i rikthehet kërkesës. Por duket se refuzimi është sërish gati, duket si punë e mbaruar që në atë kohë.

Pse nuk mund të kthehen në atdhe eshtrat e atdhetarit Sami Frashëri, autori i veprës themelore të Rilindjes "Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhet", që njihet edhe si traktat i kësaj periudhe historike. Me akademik Jorgo Bulon, studiues dhe njohës i veprës së Sami Frashërit, diskutojmë sot për këtë çështje, që duket se është sa më e madhore për shqiptarët, po aq edhe për turqit.

Profesor Jorgo Bulu na zbulon me këtë rast edhe një letër që flet për veprën e panjohur, një fjalor të madh të shqipes me mbi 6 mijë fjalë rrënjë, ose sicc llogarit Bulu gjithsej 15-20 mijë fjalë, që Sami Frashëri e kishte përfunduar e bërë gati për botim.

Zoti Bulu, si e dini ju historinë e mbajtjes së eshtrave të Sami Frashërit nga shteti turk. Dihet që një kërkesë për ardhjen e tyre është bërë edhe në kohën e Enver Hoxhës. Kërkesa është përsëritur sërish nga qeveria dhe Turqia sërish nuk pranon të kthehen eshtrat e tij në atdhe...

-Kur erdhën eshtrat e Abdyl Frashërit nga Turqia dhe të Pashko Vasës nga Libani, qeveria shqiptare i bëri një kërkesë qeverisë turke për të sjellë edhe eshtrat e Sami Frashërit, por natyrisht që qeveria turke nuk ka qenë dakord se Sami Frashëri i përket edhe kulturës turke. Ai është autori i disa veprave të rëndësishme siç është edhe fjalori i Turqishtes moderne. Besoj se me të njëjtat argumente, qeveria turke kundërshton edhe sot kthimin e eshtrave të tij në Shqipëri.

Si e shpjegoni përpjekjen e kryeministrit për ta rikërkuar kthimin e eshtrave, ka ardhur si propozim i Akademisë, apo është iniciativë e tij?

-Nuk di të jetë bërë ndonjë përpjekje nga Akademia, por e shoh si një tentativë tjetër për të sjellë në Shqipëri eshtrat e Sami Frashërit. Këtu nuk ka asgjë të keqe, përkundrazi mendoj që pala jonë ka të drejtë që vazhdimisht ta riaktualizojë këtë kërkesë.

Thuhet se ka bërë shumë për kulturën turke, siç është pretendimi i tyre, po ju si studiues si e na e prezantoni kontributin e Sami Frashërit për kulturën shqiptare?

-Kontributet nuk maten me vendin për të cilin ka kontribuar, maten me rezultatet e kontributit kulturor dhe historik që ka dhënë një personalitet për historinë e një vendi e të një kombi. E në qoftë se i masim me këtë duhet të themi që Sami Frashëri është ai që ka themeluar manifestin ideologjik të kulturës kombëtare "Shqipëria, ç'ka qenë ç'është e ç'do të bëhet". Sami Frashëri është autori i Gramatikës së

Gjuhës Shqipe. Në këtë mënyrë Sami Frashëri ka dhënë disa kontribute themelore që ka vënë vulën në gjithë rilindjen e kulturës sonë kombëtare, në zgjimin e ndërgjegjes kombëtare dhe në realizimin e ëndrrës shekullore të shqiptarëve, për një shtet të pavarur kombëtar.



Jorgo Bulu

A ndikon në marrëdhëniet politike mes shteteve një përgjigje e "Jo", apo ka një arsytim tjetër...?

-Nuk besoj.

Atëherë mos është çështje xheloze mbi përkatësinë e personalitetit...Si shpjegohet kjo këmbëngulje e Turqisë?



Sami Frashëri

-Po dihet. Është i njohur fakti që në shumë shtete bëjnë luftë për të përvetësuar një personalitet të madh, siç ndodh me Homerin e me personalitetet si Nënë Tereza etj. Dhe natyrisht edhe me Sami Frashërin që është një personalitet i përmasave kombëtare dhe më gjerë. Padyshim secili vend ka të drejtën që të përvetësojë emrin e tij, figurën e tij. Natyrisht ne na takon më shumë, sepse ai është shqiptar, sepse është një nga figurat qendrore të një periudhe kulmore të historisë shqiptare, të Rilindjes Kombëtare, sepse ka dhënë kontribute themelore në historinë kulturore dhe politike të Shqipërisë.

Midis Abdyl Frashërit dhe Sami Frashërit, cila është figura

më e rëndësishme për secilin vend?

-Natyrisht Abdyl ka qenë deputet në parlamentin turk, dhe sigurisht edhe për historinë e Shqipërisë Abdyl ishte një figurë qendrore në historinë politike, por dihet roli që ka luajtur në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, kontributin që ka dhënë në historinë publicistike të kohës. Në këtë pikëpamje mund të themi se në historinë politike Abdyl Frashëri ka zënë një vend të rëndësishëm, por Samiu ka zënë një vend të veçantë në një plan më të gjerë, në historinë politike kulturore, duke pasur parasysht këtu veprën e tij "Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhet", por edhe me publicistikën e tij me interes të veçantë për zhvillimin e mendimit politik shqiptar të kohës.

Siç e kemi studiuar në është një ndërgjegje më e ndjeshme, më sensibilizuese për ta bërë atë themeluesin e Rilindjes?

-Sigurisht, turqit thonë se bëri Fjalorin por mos harroni se Sami Frashëri është edhe themeluesi i një fjalori të gjuhës shqipe, që deri më tash nuk njihet dhe nuk dihet ku është. Shpresoj të mos ketë humbur dhe të kërkohet, por ka të dhëna të mjaftueshme, që ai e ka kryer dhe e ka dorëzuar këtë veprë.

Nga dalin të dhënat?

-Të dhënat vijnë prej një letre të vitit 1885, që Jani Vreto ia dërgon Thimi Mitkos, ku midis të tjerave shkruan "fjalëtores ka zënë e bën edhe Sami Beu, edhe unë vetë ia numërova 6 mijë fjalë rrënjë, që me të dalat, me të përjashurat, të paktën bëhen dy a tri herë aq". Do të thotë që Jani Vreto që drejtoje botimet e letërsisë shqipe në Bukuresht ka pasur në dorë fjalorin shqip të Sami Frashërit, i cili ka pasur 6 mijë fjalë rrënjë, ndërsa po të bësh llogari ka apsur 15-20 mijë fjalë rrjedhëse fjalori. Sigurisht leksikografia turke i ka mjaft detyrime Sami Frashërit, por do të ishte paradokse që Sami Frashëri të mos hartonte një fjalor për gjuhën e mëmës. Ashtu siç dëshmonte se Samiu i ka hyrë vërtet kësaj pune në ato përmasa, për të cilat dëshmon Jani Vreto. Letrën e këtij të fundit e ndajmë 11 vjet kohë nga një fakt i mëparshëm që tregon për ekzistencën e fjalorit. Është letra e Naim Frashërit në vitin 1896 që thotë se "ne e kemi zënë edhe fjalëtores, por e bëjmë". Fakti që Naimi do t'ia dërgojë fjalorin sa të mbarohet së shtypuri veprat e tjera, do të thotë se puna me fjalorin nuk ishte në fillim, por në të mbaruar.

Letra e Jani Vretos dërguar Thimi Mitkos

"Të 23 n' e vjeshtës së tretë 1885 në Bukuresht Mitkoja im** (J.B: në krye letra është e dëmtuar) Kartën tënde të së 10/22 këtij muaj e mora dhe u gëzoza. Edhe Thimiun kartën që i kesh shkruar bashkë me të tjerat që i kesh mbyllur ndë atë. Edhe muarën vesh. Zoti A. Avramidi është jashtë, muanë fjalrë na tha vjen. Shkronjëzat edhe s'na kanë ardhur që të zënë punë, po i presëm tani shpejt. Gjithë çka shkruar bëni gati dhe dërgoja Thimiut. Edhe nga ato që shtypen unë e shof të udhësë të të dërgohem. Nuk vetëm 50 cope po dhe 250. Për fjalëtores që thua se ke shkruar harrin të jetë e pasurë me fjalë që ka gjuha dhe ndë dëftesë (emërtime) që i përdor gjuha pa punë e pragogjisë*** (J.B: anës letër në krye është shkruar: Kartën që ojen këtu brenda, kenadoje edhe mbylle e dërgojua) për

ato që të merr mendja shkruaj. funt le të marrë prej atyre që të vijnë pas (...) për punërat që ke frikë të msonjë vëllzërish si ma merr mendja. Edhe më vjen mirë, ashtu të më mësojsh. Për fjalët e gjalla që përdor gjuha duhet të jesh i lirë t' shkruahs pas çdo të foli (dhialekteje) që ka gjuha. Veç të mos i ndryshojsh e të mos i mbrujsh sic nuk i ka asnjë të folë. Edhe për ato që duhet të bëjsh të ra duhet të jesh i lirë t' bëjsh si ta mer mendja më mirë se i do gjuha kur je i zot i gjuhës. Pa në mos qençin të gjitha të goditura do të jenë ca. Edhe këstu ca njëri e ca tjetri bëjnë punë të madhe. Fjalëtores ka zënë e bën edhe Sami beu, edhe unë vetë ia numërova mbi gjashtë mijë fjalë rrënjë që me të dalat, ndajshimit të paktën bëhen dy a tri herë aq. Nuk di Jojta pe sa fjalë është. Duhet të vësh ndë mos të ka rënë ndë mënt, fjalët e gjithë shkronjave që gjendenë gjer më sot shqip. Edhe merru vesh me Sami bejne...""...etj...

Botim i UET

Vijnë në shqip kujtimet e zëdhënësit të Blair

S shumë debate ka ngjallur shënime. Por, si Tony Blair nën drejtimin e Laburistëve. Por tani, shqiptarët do të njohin atë çka ka ndodhur në gjithë këto vite, nëpërmjet një "Ditari" të Alanstair Campbell, ish zëdhënësit të tij, i përkthyer në shqip nga Alfred Lela, me parathënie nga gazetarja Ilva Tare, e i sjellë nga UET press për opinionin publik. Dje në Hotel Tirana International u bë promovimi i librit nga shtëpia botuese, ndërkohë që botuesi Henri Çili nuk ngurroi të tregonte edhe momentet se si vendosi të merrej me botimin e këtij libri. Për gazetaren Ilva Tare, ky nuk është thjesht një ditar, edhe pse deri në detaje vetë

zëdhënësi ka mbajtur shënime. Por, momentet më të rëndësishme, që Campbell tha edhe për të gjithë ata që e dëgjonin, kanë qenë vitet e luftës në Kosovë, mënyra sesi Tony Blair dhe Clinton, ndërmerrnin vendimet për fatin e shqiptarëve që vuanin nën regjimin e Millosheviçit. Korrotacionet politike, që u thanë përpara të pranishmëve, nuk kishin vend për moskuptim. Vetë Alanstair tha shumë pak për veten e tij. Ilva Tare, ndër gazetaret e para që kishte lexuar librin,

tha se një vit më parë, kur e kishte intervistuar zëdhënësin në emisionin Tonight në Ora Neës, nuk e kishin kuptuar shumë vetë. Sot, ai po kthehej një star për publikun shqiptar. Por Alanstair nuk ngurroi që të bënte një fotografi për të gjithë të pranishmit në momentin që nisi fjalën e tij. U tha të pranishmëve se vajza e tij nuk do ta besonte sesa njerëz ishin mbledhur në këtë ceremoni për promovimin e librit të tij. Nxorri nga xhepi telefonin e tij i plotë, bëri fotografinë, dhe më pas filloi të

fliste për vitet e punës së tij në krah të kryeministrit laburist. Në fund të fundit, aty është pasqyruar një jetë shumë e vështirë e tij, që në momentin që pranoi të punonte me Tony Blair. Shumë intriga ka në këtë libër, aq më tepër po të mendosh se vetë Shirli Blair dhe Tony kanë shkruar librat e tyre të kujtimeve. Dhe për më tepër, kur mendon se bashkëshortja e kryeministrit britanik, nuk e ka pasur shumë "follë" muhabetim me zëdhënësin e Tony Blair. Por sikurse Ilva Tare thotë në parathënie e këtij libri, ky nuk është thjesht një ditar, është një moment historie për gjithkënd që do të shohë sesi është qeverisur bota pas viteve '90.



VITET ME PAPA BLAIR

Nxorri nga xhepi telefonin e tij i plotë, bëri fotografinë, dhe më pas filloi të



Intervista

■ ■ ■ TIRANE

ANILA ÇULI

Ishte Robert Aliaj ai që solli në qershorin e vitit 2010 për herë të parë në kryeqytetin shqiptar Festivalin e Filmit të Shkurtër "48 orë projekt filmik". E ideoi dhe e nisi punën me një grup të vogël filmik e fleksibël që ishte i përbërë nga drejtori, regjisorin, skenaristin, aktorët, dhe duke marrë përsipër vetëfinancim dhe krijimin e një filmi "brenda 48 orësh". Ishte e para provë në rrugën e improvizimeve filmike. Kompeticioni erdhi edhe me çmime të rëndësishme për regjisorin, aktorin, skenarin, muzikën më të mirë, si dhe filmin më të mirë të shkurtër të vitit. Pastaj projekti ishte edhe me interesant, sepse fituesi i këtij festivali shqiptar pati të drejtën të konkurronte me të drejta të plota krahas filmave fitues nga e

Vërtet "Gjeniu..." mungoi, por unë nuk kam munguar. Kam një festival filmi në vit për të realizuar, "Tirana 48 Hour Film Project". Kam projektet e mia personale si piktor.

gjithë bota për titullin "Filmi më i mirë 48 orësh për vitin 2010". "Festivali i Filmit të Shkurtër 48 orësh përcjell problematikën shqiptare, jehonën që fenomenet e ndryshme sociale lënë në mendësinë tonë", thotë Robert Aliaj. Ka kohë që jeta e tij ndahet mes Belgjikës dhe Tiranës. Këto ditë artisti Robert Aliaj, gjendet në Tiranë me angazhimet për projektet e tij artistike, ndërsa premon një edicion të ri për "Tirana 48 Hour Film Project". Jemi mësuar së fundmi ta shohim si opinionist i "rreptë" dhe i pakompromis tek "Gjeniu i vogël". Por ai nuk do të jetë më aty, pasi mendon se duhet t'ia lërë vendin edhe të rinjve pasardhës. Tashmë jemi mësuar me sportivitetin e tij, të thënit të gjërave troc. Ashtu siç është i drejtpërdrejtë, Robert Aliaj shpreh opinionin e tij në një intervistë për Shqiptarja.com. Aliaj shprehet në lidhje me këtë spektakël si dhe projektet e tij më të fundit artistike, ku nuk do të mungojnë edhe provokimet e kritikave më të ashpra ndaj realitetit politik.

Nuk jeni pjesë e "Gjeniu të vogël", në këtë edicion, përse?
-Jo nuk do të jem. Mua nuk më ka pëlqyer kurrë ideja që të zë një vend dhe të mos e lëshoj deri sa të vdes. Kjo ndodh masivisht në politikë, por kjo ndodh fatkeqësisht edhe në domenin e artit ku artistët që okupojnë me vite mediat nuk

ROBERT ALIAJ:

Në art dhe politikë nuk ka vend për të rinjtë

Çfarë fshihet pas "Tirana 48 Hour Film Project" dhe personalitetit tim si piktor



Robert Aliaj ne qytetin e Beratit

lejojnë asnjë shans ose hapësirë për të rinjtë, të cilët mund të sjellin ide të reja. Gjeniu për mua ishte një eksperiencë në të cilën mu desh të luftoj për të qëndruar korrekt me vetveten, ndërsa përballesh me të shkuarën time të largët. Dhe kjo në dy drejtime: E para, me fëmijërinë time, e cila evokohet nga konkurrenca të vegjël pjesëmarrës në konkurs me ëndrrat, ethet, stresin, magjinë e të qenit i pafajshëm, etj. Dhe e dyta: Përsëri me fëmijërinë time që duhet të përballesh me një mentalitet të zhvendosur në kohë, njëkohësisht në të dyja kahet. Pra, ishte një përzjerje e pasionit me nevojën për të sjellë diçka ndryshe dhe të vërtetë që krijoi një situatë problematike. Unë si artist, isha i ndërgjegjshëm për misionin dhe vendin që më takonte në atë ambient kolektiv. Nuk me mjaftonte të dialogoja vetëm me fëmijët që kërkonin një orientim dhe formim, jo vetëm komplimente, por duhej të përballesh me një panel që duhet reformuar ose transformuar para se të merrnin përsipër të gjykonin fëmijët. Pra, vështirësia për të qenë sa më i drejtë dhe direkt me fëmijët, e bëri obsesion nevojën për të qenë i tillë. Gjeniu ishte një ndërmarrje

e guximshme për t'u përhëndetur dhe organizatorët sigurisht që kërkonin nga gjithë ky angazhim të fitonin më të mirët. Ata fëmijë që rëmbyen notat e mia më të mira, po rëmbejnë vëmendjen e publikut nëpër konkurset e ndryshme që po zhvillohen sot. Për mua misioni është i kryer me sukses.

Dy vjet ju munguat, po ashtu mungoi edhe ai spektakël. Përse mungoi?

-Vërtet "Gjeniu..." mungoi, por unë nuk kam munguar. Kam një festival filmi në vit për të realizuar, "Tirana 48 Hour Film Project". Kam projektet e mia personale si piktor. Sigurisht kam edhe nevojë për hapësira boshe, ku unë nuk duhet të bëj asgjë tjetër veçse të argëtohem pa asnjë qëllim të përcaktuar. Ndoshta "Gjeniu" mungoi për arsye të përzgjedhjes së më të mirës, nuk është e thjeshtë të zbulosh elementë të talentuar.

Me anëtarët e tjerë të jurisë kishit mjaft përplasje...?

-Anëtarët e tjerë të jurisë, ishin anëtarët e tjerë të jurisë.

Një përplasje e madhe ishte kundër opinionit të pjesëtarëve të tjerë të stafit, pasi ju i "akuzonit" se i mjaltonin fëmijët?

-E thashë edhe pak më parë, ne vinim nga background-e të ndryshme. Paneli kishte dy anët e tij të medaljes, por me identitete të ndryshme. Nga njëra anë ishte pjesa konformiste, që nuk kishin kuptuar asgjë nga aspekti i bekuar i kreativ-

itet dhe konceptimit artistik, por që komprometonte nga paaftësia ose arsye të tjera qëllimin fisnik të vlerësimit. Nga ana tjetër unë (që nuk jam aspak miku i Leonardo Di Caprio (qesh) fatmirësisht, duhej të mos bëja asnjë lloj kompromisi me këtë mentalitet provincial, që ma vështirësoj shumë misionin, sepse sig e kenë vënë re, u katandisëm në një pikë ku nota kërkohet me dhunë nga fëmijët dhe prindërit e tyre, të nxitur nga vlerësimet precedentë pa asnjë logjikë profesionale dhe etike. Kishte fëmijë të frustruar të cilët më kërkonin të arsyeoja përse ai merrte të njëjtin notë me një tjetër që ndoshta nuk duhej të ishte fare në konkurrim. Fëmijët manifestonin në skenën e Gjeniu hapat e tyre të para të ndërgjegjes artistike. Ata duhej të transformonin preokupimet e tyre estetike në një gjuhë emocionale me interpretimet e tyre, dhe prisnin nga goja jonë të dilnin fjalë me gjykim premtues, fjalët tona që duhej të përmba-

Mua nuk më ka pëlqyer kurrë ideja që të zë një vend dhe të mos e lëshoj deri sa të vdes. Kjo ndodh masivisht në politikë, por kjo ndodh fatkeqësisht edhe në domenin e artit

nin të vërtetën të pa infektuar nga mendimi i izoluar.

Ky lloj emocioni që ato provojnë a mos është disi shumë për moshën e tyre?

-Në Shqipëri është bërë e zakonshme të abuzohet me konkluzione të tilla aspak koherente me realitetin tonë këtu. I keni menduar ndonjëherë emocionet që provojnë fëmijët nga dhuna në familje, konfliktet konjugale, kaosi dhe kakaofonia urbanistike, televizionin me luftë permanente politike dhe lajme terrori etj? Ato janë njëqind herë më të tmerrshme. "Gjeniu" është një sfidë, një sfidë ku ti duhet të përballesh së pari me vetveten, pastaj me aftësitë e tua për të më bindur mua që ti meriton më të mirën. Një sfidë ose pranohet ose refuzohet. Emocionet që ata provuan atje nuk ishin negative, por emocione pozitive të një gare për të bërë më të mirën. Unë duhej ta orientoja konkursin në këtë drejtim. Perceptimi se goja fëmijët po provonin emocione të forta nuk ishte veçse një interpretim i gabuar keqdashës.

Cilat janë projektet tuaja më të afërta?

-Sapo mbylla një ekspozitë në Bruksel, tani i jam përveshur punës dhe po përgatitem për një tjetër në qytetin mesjetar të Gentit. Këto janë projektet e mia të afërta jashtë Shqipërisë. Këtu kam të tjera interesa.



Robert Aliaj



Oferta (a)morale e pushtetit



NGA AFRIM KRASNIQI

vijon nga faqja 1

...Shqipërisë, gjatë ndarjes mes tyre të lejeve të ndërtimit për pallatet e reja në sheshin "Skënderbej", në amnistimin e politikaneve përgjegjës për ngjarjet e vitit 1991, 1997 si dhe në amnistinë e fundit për të mbyllur përgjithmonë hetimet për politikanët e përfshirë në tragjedinë e Gërdecit dhe në ngjarjet e 21 janarit.

Në 22 vite PS ka qëndruar 10 vjet në pushtet, nga të cilët shtatë vite i përkasin dy kryeministrave të së majtës që bëjnë pjesë në koalicionin e sotëm të qeverisë, Nano e Meta. Tre ministra aktualë të së djathtës kanë qenë ministra apo funksionarë të lartë në rang ministrior edhe gjatë qeverisjes së majtë, siç të tjerë politikanë mbijetuan përmes sponsorizimit indirekt të së majtës. P.sh, zonja Topalli ishte zv/kryetare parlamentare gjatë viteve 1997-2005 e zgjedhur nga shumica socialiste në konkurrimin e saj me Pjeter Arbrorin. Një nga deputetët më aktivë sot e nisi karrierën si zyrtarë e lartë politike e kryeministrit Majko më 1998, sic pjesa më radikale e grupit parlamentar i përket kryerriave personale e familjare të mesme ose të larta gjatë regjimit komunist. Në koalicionin qeverisës bëjnë pjesë edhe parti si PAA, të cilat drejtohen nga deputetë të ish Partisë së Punës, figura historike të së majtës, madje me lidhje të forta edhe me sistemin e kaluar. Në diplomacinë e djathtë bëjnë pjesë tre kandidatë apo anëtarë të KQ të PPSH, kurse zyrtarët më të fuqishëm në administrim publik të PD-së janë ish sekretarë rinie, kandidatë të Bashkimit të Rinisë më 1991, militantë të shoqatës Vullnetarët e Enverit, personat e vetëm të cilëve u janë hapur dosjet për shërbime në sigurimin e shtetit janë zyrtarë drejtes në kryeministri apo kandidatë të qeverisë për postet më të larta drejtuese të shtetit.

Ky bilanc real nuk cenon dhe as komprometon nevojën për një bashkëpunim institucional dhe logjik midis të majtës dhe të djathtës në Shqipëri. Në çdo vend ish komunist ku reformat kanë qenë të suksesshme një nga bazat e suksesit ka qenë konsensusi i gjërë politik në reformat kushtetuese, në çështjet e pronësisë, drejtësisë, privatizimit, integritetit dhe interesave

kombëtare. Tek ne konsensusi i vetëm në këto fusha u shënua më 1991, midis PD dhe PPSH për çështjet e pronësisë, ligj që nuk zgjidhi, përkundrazi e komplikoi edhe më shumë këtë çështje themelore për zhvillimin ekonomik të vendit. Bashkëpunimi institucional kërkoi dialog dhe marrëveshje për gjërat themelore që lidhen me shtetin, qytetarët dhe shoqërinë. Ato bëhen transparente, marrin mbështetje publike dhe kthehen në norma kushtetuese. Modeli shqiptar i deritanishëm është i kundërt: palët kanë bashkëpunuar vetëm në raste ekstreme, kryesisht për nevojë mbijetese në politikë, ose për qëllime fitimi ekonomik e politik, ndërsa kanë kontestuar njëra tjetrën

edhe në ngjarje me rëndësi për shtetin, siç janë rastet e miratimit të kushtetutës, luftën e Kosovës apo procesin integruar. Apeli i SHBA dhe BE për reforma serioze dhe gjithëpërfshirëse periodikisht ka rënë në vesh të shurdhër, ndaj edhe sot shumica e sfidave të politikës dhe shtetit shqiptar janë ende të papëmbushura.

Paradoksi më i madh është se ndërsa de facto palët janë dakord për interesat ditore, retorika publike e tyre është e ashpër, përjashtuese dhe denigruese. Kryeministri flet për 50% të shqiptarëve që përfaqësojnë opozitën si e keqja e vendit, fton qytetarët të rrëzojnë fëmijët si prindërit e tyre 22 vjet më parë, thotë

se ata janë kërcënimi i të ardhmes së vendit dhe premtori i mundë, ti shkatërrojë dhe ta çlirojë Shqipërinë prej tyre. Nga ana tjetër edhe vetë opozita e majtë bën thaujse të njëjtën gjë, në stil e formë më të ndryshme. Mjafton të kujtojmë humbjen e shanseve të integritetit më 1996, 2002 dhe 2010-2012 apo rreth 3 mijë qytetarë që humbën jetën më 1997 për të lexuar bilancin shkatërrimtar të këtij konflikti absurd dhe joparimor. Edhe tani në prag të fushatës elektorale dy palët janë në luftë "ballë për ballë" duke ndarë qytetarët dhe shoqërinë, kur në fakt, tej fasadës, dalin në jetë skenarë kompromentues, të cilat flasin se gjithçka ndodhë është thjesht një lojë

e radhës, dhe se palët janë të gatshme të merren vesh në çdo kohë dhe për gjithçka tjetër, përveç nevojave publike dhe interesave madhore të vendit. PD nga njëra anë premtori ta mundë PS si më 1992 dhe nga ana tjetër jep garanci për ofertën e një koalicioni të madh me PS pas zgjedhjeve. PS nuk e refuzon ofertën e saj, dhe duke premtuar fitore, është e gatshme të marrë pjesën e majtë të korrupsionit të qeverisë në aleanca para e paszgjedhore.

PD ka sloganin e ecjes përpara, se ajo është ndryshimi, dhe jashtë çdo sjellje morale e politike kërkon me çdo mjet të vijojë në pushtet, në aleancë me ish kryeministrat e majtë, me komunistët

e Hoxhës dhe me socialistët e Ramës. Nuk kanë rëndësi parimet, identiteti, moraliteti dhe as përgjegjësia qytetare, nuk kanë rëndësi as premtimet, retorika, programi e statuti, - gjithçka ka rëndësi është pushteti, me çdo mjet dhe me çdo kusht. PD ka refuzuar modelin morale të Merkel në Hanover apo të Berlusconi në Itali, madje edhe atë të LDK në Kosovë apo kryeministrit në ikje në Bullgari. Ajo ka zgjedhur rrugën unike, të pashembullit në një kontinent vlerash: ofertat amoralë, të cilat në gojë. Stilin dhe metamorfozën e saj shtetin si zgjidhje morale për qytetarët. Tri janë arsyet kryesore të këtij degradimi moral: moshë natyrale në ikje e kryetarit të saj, pamundësia e tij për rikthim pas humbjes; humbja tërësisht e identitetit politik dhe shndërrimi i forcës politike në kompani fitimi ekonomik, e vetmja parti në botë që ka në kryesi drejtor hipotekash, legalizimesh dhe burgjesh; dhe e treta, mentaliteti parademokratik në atë parti, pa respekt për votën dhe fjalën, pa respekt për shtetin, institucionet dhe qytetarët, në babëzi dhe bindje të marrë mesjetare se e drejta e pushtetit nuk është përgjegjësi periodike, por duruar e zotit që nuk negocihet, rinovohet dhe as vlihet në dyshim.

Në një vend të korrumpuar në çdo segment vendimmarrës të tij, pa elita serioze dhe qytetarë aktivë në mbrojtje të parimeve nuk besojnë, me vota që trafikohen me standardet e domateve të tregut, me një pakicë që sundon dhe shumicë të nënshtruar, me lobe politike e biznesi që kontrollojnë jetën publike e private dhe me parti të mbyllura që drejtojnë shtetin, ofertat amoralë nuk përbejnë lajm. Ato shihen dhe shiten si aftësi politike ku fiton më i forti, më i pasuri, më i afti për pazare dhe më i gatshmi për të ndarë torta pushteti. Ky mjedis pashallëku qesh e përqesh të urtin, të aftin, qytetarin e politikanin me dinjitet, personalitet dhe kurajë për tu distancuar nga ofertat moçalore të pushtetit. 2013 nis shekullin e ri shqiptar, shumë për një bashkësi demokratike dhe pak për një tokë sundimtarësh mesjetarë. Tej shpresës për ndryshim, për ringritje dhe për kthesë historike kjo ende mbetet Shqipëria e tranzicionit, një shoqëri në rënie morale, ku dominon frika, frika nga pushteti dhe frika për humbjen e pushtetit, - të dyja tipare penalizuese për projektin dhe nevojën e madhe për një shoqëri qytetare në moral, identitet e sjelle politike, për një Shqipëri vërtetë demokratike, të zhvilluar dhe të integruar.

Liria personale dhe lumturia



NGA ANILDA NOÇKA

Shumë herë dëgjojmë të flitet se si personat me të cilët shoqërohemi, ndikojnë në sjelljen tonë në shoqëri dhe jetën e përditshme. Duhet të shoqërohemi me njerëz të suksesshëm, që të bëhemi të tillë apo të tregojmë që dhe ne jemi të tillë. Ose duhet të shoqërohemi me njerëz me standarte të larta shpirtërore në qoftë se duam të arrijmë qetësinë e duhur brenda vetes. Ose duhet të shikojmë në njerëz negativ në qoftë se duam të kemi një jetë pozitive dhe të qetë.

Këto ide janë gjithmonë intriguese dhe stimuluese në të njëjtën kohë. A është gjithmonë e rëndësishme të rrethohemi me njerëz që kanë të njëjtat ide dhe qëndrime si ne? Është ky një element i rëndësishëm për qetësinë shpirtërore, rritjen e brendshme dhe lumturinë tonë? Mendoj se jo gjithmonë është e vërtetë. Ne mund të shoqërohemi dhe bashkëpunojmë me këdo në qoftë se kemi sjelljen e duhur brenda vetes tonë. Aktualisht, shumë shpesh, është mirë për çdo njeri të jetë midis individësh që janë ndryshe nga ajo që mendojmë ne, rreth individësh jo dhe "aq të mbushur me energji pozitive" apo "me ide më të larta se standartet tona individuale". Përsa i takon shoqërisë, ne të gjithë zgjedhim me kë duam të shoqërohemi. Kjo është ndryshe nga situata familjare, sepse në atë drejtim ne nuk kemi asnjë kontroll mbi lidhjet familjare, sepse nuk kemi atë mundësi zgjedhjeje si në shoqëri.

Shumë nga ne mendojnë, pse të mos kemi standarte të tjera kur vjen puna për zgjedhjen e shoqërisë dhe të rrethohemi vetëm me "shoqëri të zgjedhur"? A arrijmë në një pikë të jetës tonë të mos e vrasim më mendjen për të bërë këto zgjedhje? Gjatë rritjes dhe transformimit në jetën tonë, në mënyrë instinktive, dëshirojmë të rrethohemi dhe punojmë me njerëz që kanë të njëjtat qëndrime dhe ide. Midis tyre ne rritim shpirtërisht, intelektualisht dhe integrojmë këto elemente në jetën tonë dhe të njerëzve që na rrethojnë.

Në momentin që individualiteti jonë është formuar, del në plan të parë dëshira dhe nevojja jonë për të shfaqur individualitetin tonë. Në momentin që ky element fillon të zhvillohet, fillojmë të shikojmë dhe kërkojmë gjëra dhe aspekte të tjera, realiteti që na rrethon nuk është më i mjaftueshëm apo ai që na kompletion si individë. Automatikisht fillojmë të kërkojmë diçka tjetër, të re, vibrante. Në shumë raste, individët që ishin pjesë e grupit të parë fillojnë t'i lëshojnë vendin kësaj nevojë për energji të re. Miqësitë e vjetra fillojnë të mos jenë më të mjaftueshme dhe lidhjet e reja, me individë të tjerë, apo grupe njerëzish, fillojnë të integrohen në jetën e përditshme. Kjo nuk do të thotë, që miqtë e vjetër, nuk janë më të mirë. Është thjesht që çdo njeri ka të drejtë të ndjehet i kompletuar në jetën e përditshme. Në anën tjetër, shumë individë shkëputen nga një grup i caktuar në momentin që gjejnë diçka më të shëndoshë dhe të pastër. Kjo ndodh më shumë me individët që kanë kaluar pengesat e tyre me alkokin apo substancat e ndaluarra-është i nevojshëm distancimi nga ata njerëz që mund të ndikojnë në mënyrë negative në ndryshimin apo rritjen e brendshme.

Njëherë që kjo balancë e brendshme është ngritur dhe forcur, nëpërmjet forcës së karakterit dhe

mbështetjes së duhur, njëherë që jemi në paqe të brendshme me veten dhe shoqërinë që kemi rreth vetes, atëherë jemi të lirë të mos shqetësohemi aq shumë për të seleksionuar shoqërinë që kemi në çdo moment të jetës. Kur jemi në paqe me veten dhe jetën tonë, çdo situatë rreth nesh, familje apo shoqëri, e shikojmë me sy dhe zemër të hapur, pa gjykuar, nga një vend ku zemra dhe shpirti flet me dashuri dhe paqe. PA GJYKUAR, vetëm duke pranuar, që çdo individ është unik dhe ndeshet çdo ditë me betejet dhe problemet e tij. Në këtë pikë, çdo njeri që është rreth nesh, është në një mënyrë i bukur, i mrekullueshëm, i hapur për bashkëpunim, për përkrahje po ashtu si dhe ne.

Cfarë ndodh, është që duke zgjedhur njerëzit me të cilët shoqërohemi, ne i gjykojmë ata, edhe sado pak. Atëherë fillojmë të seleksionojmë individët apo grupet me të cilët do të krijojmë dhe ruajmë shoqërinë. Në këtë mënyrë, ne fillojmë të gjykojmë individët që kemi rreth vetes. Në qoftë se, ne do të lejonim njerëzit, të hyjnë dhe të dilnin në mënyrë të lirshme nga jeta jonë, pa gjykuar se kush mendojmë ne se ata janë, jeta do të lejojë në mënyrë të natyrshe, që të ngelen rreth nesh ata individë dhe situata që na kompletajnë pa gjykuar. Nuk do të kemi më nevojë të afrohemi apo largohemi nga grupe të caktuara në bazë të gjykimit tonë, do të kemi mundësi të jetojmë dhe shijojmë jetën në mënyrë paqësore dhe me dashuri, duke jetuar çdo detaj me zemër të hapur. Duke mos i gjykuar marrëdhëniet tona, i lejojmë vetes të lidhemi dhe kontaktojmë me një grup më të madh njerëzish, na lejon të jemi të hapur me të gjitha aspektet e jetës së përditshme, dhe me një shumëllojshmëri individësh me gjithë ngjyrat dhe nuancat e tyre. Kjo është bukuria e një jete të plotë dhe të jetuar në çdo aspekt.



Big Brother

MODELI Valer Kolnikaj pohon në faqen e rrjetit të tij social se Marselino është personazhi i zhigolosë, në spektaklin e Big Brother. Ish-modeli i Inis Gjonit në një nga klipet e saj sot personazhi i reality Show-ut.

Zhigoloja? Është Marselino...

Sekreti zbulohet nga modeli Valer Kolnikaj në faqen e tij në facebook

TIRANE

ANILA ÇULI

“Ua shuaj kuriozitetin... Zhigoloja” në Big Brother është Marselino Hitollari... Është një model në tentativë. Ka qenë mister e poashtu tek Klipi i Ingrid Gjonit”. Ky është koment që ka bërë në faqen e tij të rrjetit social Facebook, i riu Valer Kolnikaj i cili pohon me bindje të plotë duke zbuluar një nga sekretet e reality show-ut më të famshëm që po zhvillohet në Shqipëri. Kolnikaj një model i njohur pohon se e njeh personalisht konkurrentin e Big Brother-it duke e konsideruar një model në tentativë dhe që kohë më parë paska qenë pjesë e klipit “Përse me mua”, të këngëtares Ingrid Gjonit. Duke qenë se Kolnikaj, vjen nga fusha e modës ku ai më 2011 ai ka qenë pjesëmarrës në “Best Model of the World Albania”, pretendon se e njeh djalin i cili ka hyrë në garën për shumën e madhe prej 100 milionë lekësh në këtë spektakël. E menjëherë pas kësaj deklaratë nga i riu Kolnikaj, në facebook kanë shpërthyer komente të ndryshme lidhur me Marselino të shkuarën dhe të



Marselino

fansë në këtë rrjet social ta besojnë një gjë të tillë është thënia e shprehur nga vetë Marselino gjatë prezantimit të tij, ku e konsideron veten një “gjitëkabërës”.

POR KUSH ËSHTË MARSELINO HITOLLARI

Marselino Hitollari për herë të parë u prezantua përpara publikut shqiptarë, gjatë natës së celes së spektaklit të “Big Brother”, të shtunën e kaluar. Djaloşi brun etpër simpatik u shfaq, mes banorëve të tjerë gjatë natës së parë të spektaklit. Marselino është 25 vjeç dhe jeton në qytetin e Barit. Ai është me origjinë nga Berati, por prej vitesh jeton familjarisht në Bari. Kohët e fundit ka punuar si security, por ai nuk ka një profesion të tijin të mirëfilltë, pasi e konsideron veten një “gjitëkabërës”, duke qenë se nuk lodhet e nuk merrzetin nga asnjë lloj pune fizike. Prej një viti është bërë baba i lumtur i një djalë. Familja është pjesa që e bën të ndjehet më krenar për veten. Big Brother-in e sheh si mundësi që të rikthehet në Shqipëri dhe ta ndërtojë jetën me familjen e tij të re këtu.



Faksimile e deklaratës së modelit Valer Kolnikaj në faqen e tij në Facebook

Fituesit dhe surprizat


Triumfi në Oscar i filmit “Argo” dhe rekordi i Daniel Day-Lewis

Në ceremoninë e 85-të të ndarjes së çmimit Oskar në Los Anxhelos, filmi “Argo”, me regji të Ben Affleck u cilësua si filmi i më mirë i vitit, ndërsa çmimet për aktorin dhe aktoren më të mirë i fituan Daniel Day-Lewis për rolin e tij në filmin historik “Lincoln” dhe Jennifer Lawrence për rolin e saj në komedinë romantike “Në kohë të mira dhe të këqija.” Daniel Day-Lewis ka hyrë në historinë e kinematografisë duke u bërë aktori i parë i cili ka fituar tre çmime Oscar si aktori më i mirë protagonist. Britaniku u vlerësua për interpretimin e tij në filmin “Lincoln” me regji të Steven Spielberg. Në fjalimin e tij pas marrjes së çmimit, Daniel Day-Lewis theksoi: “Nuk e di se si ndodhi. Kam pasur shumë fat në jetë.” Në këtë mënyrë Daniel Day-Lewis ka kaluar legjenda si Jack Nicholson, Marlon Brando, Dustin Hoffman dhe Tom Hanks, të cilët kanë nga dy çmime Oscar në karrierën e tyre si aktori më i mirë protagonist.

Thrilleri “Argo” me regji të Ben Affleck, i shpallur si filmi më i mirë i vitit është i pari që nga viti 1989 që shpallet si më i miri pa pasur në nominim për Oscar regjisorin e tij. Në atë vit kishte fituar Oscar-in filmi “Driving Miss Daisy”.

BEFASIA E MBRËMJES


Akush nuk priste në Los Anxh-



Ben Affleck

elos që para ndarjes së çmimit të fundit për filmin më të mirë në ekranin e madh të inkuadrohej nga zonja e parë e shtetit, Michele Obama, përmes një transmetimi live nga Shtëpia e Bardhë. “Ndihehem nderuar që mund të prezantoj nominimet e këtij viti për filmin më të mirë”, tha gruaja e presidentit Barack Obama. Ajo pastaj hapi zarin me emrin e filmit “Argo”, i cili u cilësua si filmi më i mirë i vitit.

Çmimin për regjinë më të mirë e fitoi Ang Li për filmin “Jeta e Pi-së”. Ky film u vlerësua me katër Oscar krahas regjisë edhe në kategorinë kamera, muzikë dhe efekte vizuale.



Daniel Day-Lewis

Quentin Tarantino u nderua me një Oskar për skenarin më të mirë original, ndërsa Anne Hathaway fitoi çmimin për rolin më të mirë dytësor në “Të mjerët”. Filmi vizatimor i Disney-t “Paperman” fitoi në kategorinë për filmin më të mirë të animuar të shkurtër. Jacqueline Duran fitoi një Oskar për kostumografinë më të mirë në film “Ana Karenina”.

Përzgjedhja e fituesve bëhet nga rreth 5 mijë e 800 profesionistë të industrisë filmike, anëtarë të Akademisë amerikane të Arteve, Filmit dhe Shkencave. Ceremonia sivjet u drejtua nga Seth MekFarlane.

TË GJITHA ÇMIMET OSCAR 2013

- Filmi më i mirë: Argo
- Aktori më i mirë: Daniel Day-Lewis (Argo)
- Aktorja më e mirë: Jennifer Lawrence (Silver Linings Playbook)
- Aktori më i mirë joprotagonist: Christopher Waltz (Django Unchained)
- Aktorja më e mirë joprotagoniste: Anne Hathaway (Les Misérables)
- Regjisorin më i mirë: Ang Lee (Life of Pi)
- Filmi më i mirë i huaj: Amour (Austri)
- Skenari më i mirë: Quentin Tarantino (Django Unchained)
- Filmi më i mirë i animuar: Brave
- Produksioni më i mirë: Lincoln
- Çmimi i kinematografisë: Life of Pi
- Kolona zanore më e mirë: Skyfall (Adele Adkins dhe Paul Epworth)
- Kostumografia më e mirë: Anna Karenina
- Dokumentari më i mirë: Searching for Sugar Man
- Dokumentari më i mirë me metrazh të shkurtër: Inocente
- Makiazi më i mirë: Les Misérables
- Filmi më i mirë i animuar me metrazh të shkurtër: Paperman
- Efektet vizuale më të mira: Life of Pi

Yjet pa asnjë Oscar

Aktorët e mëdhenj që s’kanë marrë kurrë të marrin çmimin prestigjioz

Një diskutim interesant u zgjua nën atmosferën e Oscar-ve, mbi emrat më të njohur të aktorëve të Hollywoodit, të cilët asnjëherë deri më tani nuk kanë fituar trofeun prestigjioz. Shembulli më i njohur është Leonardo DiCaprio, ylli i “Titanikut”, por edhe i realizimeve të tjera të shumta të rëndësishme siç është “Romeo e Zhuljeta”, “Plazhi”, “Bandat e New Yorkut” apo “Loja e dyfishtë”. Njësojë i pasuksesshëm, që me shkathtësitë e tij artistike mund të bind anëtarët e Akademisë amerikane të filmit është edhe Brad Pitt i cili për transformimet e tij, si vrasësi me pagësë deri tek rolet e tij sociale dhe historike ka marrë deri tani vetëm dy nominime. Po ashtu një nga legjendat e Hollywoodit të cilët asnjëherë nuk e kanë marrë këtë çmim është edhe John Malkovich, Tom Cruise, Johnny Depp, Will Smith, Eddie Murphy por edhe disa nga kolegët më të vjetër si Piter Otul, Kirk Douglas, Richard Barton dhe James Dean.

Intervista

BESIMI E nëse kam një fije shprese, ajo lidhet me Fidel Yllin, tek i cili kam besim që mund t'i bëjë të gjitha ato që thotë, pasi e do sportin

Birçe: Qeveria ka vjedhur sportin duhet Rilindje

Pushteti në vend të fushave, pallate

Lajmi

Bejkush Birçe gjatë një interviste për gazetën "Shqiptarja.com" analizon problemet me të cilat përballlet futbollit shqiptar dhe qëndrimin e komisionit të Etikës ditë e fundit për dënimet për trukim ndeshjes. Fajtor për këtë histori për situatë është shteti që ka harruar sportin duke e vjedhur dhe braktisur.

TIRANE
DYLBER BALLA

Trajneri i mirënjohur i disa ekipëve, por edhe i ekipit kombëtar të futbollit Bejkush Birçe gjatë një interviste për gazetën "Shqiptarja.com" analizon problemet me të cilat përballlet futbollit shqiptar dhe qëndrimin e komisionit të Etikës ditë e fundit për dënimet për trukim ndeshjes. Birçe është Presidenti i Shoqatës së Trajnerëve Shqiptarë si dhe nënkryetar i Komisionit të Etikës pranë FSHF-së. Ai e drejtoi ekipin Kombëtar në periudhën 1990-1994.

Z. Birçe pas 100 vitesh shtet, cili është niveli i futbollit shqiptar?

Më vjen shumë keq të them, por niveli i futbollit tonë është shumë i dobët. Jemi katandisur në një gjendje për të ardhur keq. Niveli është zero dhe kjo gjendje duhet të zgjidhet shqetësimin e komitetit sportiv, pasi janë në një gjumë letragjik prej kohësh.

Kush janë disa nga problemet me të cilat përballlet futbollit?

Problemet janë disa duke filluar nga gjeneza, terrenet sportive, mungesa e një strategjie të qartë nga klubet dhe shteti për të organizuar projektet për të ardhmen. Më vjen keq, por pas viteve 90' nuk është ndërtoar një stadium, një fushë, një projekt, përkundrazi nga mbi 20 fusha futbollit që ndodheshin në Tiranë para 90' tani nuk ke i asnjë. Janë mbushur të gjitha me pallate.

Kë fajtoni ju për këtë gjendje që është krijuar?

Sigurisht që fajin për të gjithë këtë kaqokofoni që është krijuar e ka shteti, i cili nuk ka bërë asgjë për sportin. Qeveria dhe ministria përkatëse bashkë me ministrin e kanë dërguar në pikën e fundit. Le të dalë dikush dhe të më thotë se çfarë ka bërë qeveria për sportin në gjithë këto vite. Përkundrazi, përveç se nuk ka bërë gjë, por ka shkatërruar të gjithë terrenet duke e katandisur rininë në mos më keq.

Pra, fajtor është politika dhe



Bejkush Birçe, ish-trajneri i Kombëtares

politizimi i sportit?

Në vend që politika të japë ide se si mund të rrisin një rini të shëndetshme që merret me sport, ata e kanë i kanë politizuar me forumet që kanë krijuar duke e ndarë në dy kampe. Ndaj dhe politizimi erit rininë menjëfrymë negative që e sheh shokun dhe shoqen si kundërshtarë, me të cilin duhet të ndeshjet me të gjitha mjetet si liderët e tyre.

Por në institucionet arsimore si trajtohet ora e edukimit fizik?

Kjo lëndë është harruar plotësisht, të rinjtë në orën e edukimit fizik i sheh në kafe, disko, loto. Ministria nuk e vë ujën në zjarr për këtë, por përkundrazi erëndësishme është që në cdo miting rinia t'i mbushë sheshet për fushatë. Ky brez është degraduar, pasi nuk ka ku të çlirojë energjinë negative, prandaj është rritur edhe niveli i kriminalitetit vitet e fundit.

Rikthehemi edhe njëherë te futbollit...

Më falni, por si mund të pretendojmë ne për futboll, kur shteti na e ka vjedhur këtë sport kaq popullor, pasi

na mori fushat, palestrat dhe nxori jashtë qarkullimit shumë sporte elitare si qiça që ishin gjithmonë në zonën e medaljeve.

A kanë tentuar që t'ju joshin me ndonjë post drejtues dhe ku e shihni shpëtimin e sportit?

Po, më kanë bërë disa oferta, por s'kam pranuar, pasi nuk dua të jem vegël. Ndërsa për të ardhmen jam pesimist nuk kam besim se sporti do të ringrihet në Shqipëri.

Si ju duket platforma e opozitës për sportin?

E nëse kam një fije shprese, ajo lidhet me Fidel Yllin, tek i cili kam besim që mund t'i bëjë të gjitha ato që thotë, pasi e do sportin. Por ai është i vetëm dhe shumë pak për të sjellë në normalitet gjithë këtë katrahurë që kanë bërë pushtetarët.

Çfarë mendoni për Partizanin, Dinamon dhe Superligën?

Partizanin e vodhën, e grabitën i morën fushat e dërguan në pikën e fundit, e njëjta gjë edhe për Dinamon. Tani duan t'ju marrin edhe trofetë,

pasi i cilësojnë se janë zhvilluar në kohën e luftë. Kjo është e pabesueshme, nëse do merrej një vendim i tillë do ishte absurde. Ndërsa Superliga vetëm emrin ka super, pasi nuk meriton as notën zero se e ka shumë, ekipit duhet të privatizohen urgjentisht, shembulli i qartë është Vllaznia.

Ju jeni anëtar i komisionit të Etikës, si e komentoni dënimin e fundit për dy ekipet e Superligës?

S'mund të komentoj vendimet, pasi janë kolegjiale. Ajo që mund të themë është që në Shqipëri ka trukime si në të gjithë botën. Mendoj që duhet mjetet me të sofistikua për të hyrë në më brendësi të fenomenit dhe për ta parandaluar.

Ndalemi te ekipit kombëtar që këtë edicion pretendon finalen e botërorit. A mund të arrihet një objektiv i tillë?

Personalisht mendoj që është e pamundur, dëshira mund të jetë e madhe, por unë e shoh lart ditën që mund të shkojmë në finale të një kompeticioni. Trajneri ka bërë një punë të mirë, por është shumë pak për pretendimet. Ekipi përbëhet nga futbollistë të rinj që nuk kanë eksperiencë për të përballuar presionin kualifikimit.

Çfarë mendimi keni për futbollistët me origjinë shqiptare, të cilët e kanë refuzuar fanellën kuqezinj?

Kam dëgjuar shumë për këtë çështje dhe më vjen keq që futbollistët që kanë refuzuar Shqipërinë cilësohen si tradhtarë. Në duhet të jemi krenar që ata luajnë me ekipe të mëdha dhe janë shqiptarë. Me Shqipërinë nuk do të arrijn kurrë atë sukses. Por ta themi hapur, çfarë kemi bërë ne për ata, që ata të pranojnë ftesën. Përse i duam gjërat e gatshme, kur në Shqipëri nuk ndërtojmë një fushë për talentet, por ju marrim lekë për stërvitje.

Ku e shihni futbollin shqiptar pas 20 vjetësh?

Pyetjes suaj do i përgjigjem me përgjigjen e Peles, të cilën kur e pyetën se kush do të dominonte futbollin në të ardhmen ai deklaroi se do të ishte Afrika, pasi atje ka hapësira të bollshme kur të rinjtë mund të stërviten. Në Shqipëri nuk kemi hapësira, kështu që përgjigja dihet se ku do të jemi pas 20 vjetësh.

Kupa Real-Barça sonte në orën 21:00

Trajneri i Realit të Madridit Jose Murinjo në prag të ndeshjes me ekipin e Barcelonës në Kupën e Mbretit ka zgjedhur ironinë për të komentuar sfidën e shumëpritur nga të gjithë. Reali pas Kupës do të luajë sërish me Barcelonën për kampionat në fundjavë, ndërsa në mesjavë do të udhëtojë drejt Anglisë për tu ndeshur me Manchesterin. Por për ndeshjen e Kupës, Murinjo deklaroi se "Preferoj të kujtoj leksionet që na ka dhënë Barcelona në të shkuarën kui mëshojnë përqendrimit vetëm te loja e futbollit, të mos flitet për arbitrat, të mos simulosh për të ndëshkuar me të verdhë kundërshtarin. Filozofia e tyre bazohet thjesht në idenë e futbollit të luajtur brenda fushës, gjë të cilën arrijnë ta bëjnë shumë mirë". Ndërsa për formacionin nuk ka asnjë të dhënë se cili do të ishte në fushë, apo me çfarë skeme mund të përballonte kundërshtarin. Ndeshja e parë mes dy ekipeve ka përfunduar me rezultatin 1-1.



Kombëtarja Talenti i Realit me Shqipërinë?

Giani De Biasi sipas mediave kosovare thuhet se e ka bindur talentin e huazuar te skuadra ruse rusë Zenit, boshnjako-kosovarin Sadiz Susic që të luaj për kombëtaren shqiptare. Husic është lojtar në pronësi të Real Madridit ndërsa çmimi i tij është 25 milion euro. Husic ka lindur në Austri, ka prejardhje kosovare, ndërsa ka aktualisht pasaportë boshnjake. Talenti i Zenit konsiderohet si një nga talentet që ka sot futbollit evropian duke qenë shumë i kërkuar edhe nga Barcelona, Lazio e shumë skuadra tjera. De Biasi thuhet se ka përfunduar të gjitha detajet me të dhe se ai do të debutoj për Shqipërinë në ndeshjen ndaj Norvegjisë. Vetë futbollisti thuhet se ka qenë para pak ditësh në Tiranë për të marrë pasaportën shqiptare. De Biasi po bën të gjitha përpjekjet për të bindur lojtarët shqiptarë që luajnë në Evropë që të luajnë për Shqipërinë. Deri më tani nuk ja ka dalë mbanë vetëm me Ergys Kacen.




PARADE FJALEKRYQESH

INGA Kadri Vokopola



FJALEKRYQI SPORTIV



HORIZONTAL

- Një pjesë e satelitëve.
- Luan në shtëpi në Loro Borçi.
- Fillojnë javën.
- Eshhtë yll i skuadrës.
- Fillojnë vrapin.
- Një mohim i prerë.
- Një shtet aziatik.
- Personazhi në foto.
- Heroi kombëtar... i Korçës.
- I ka tek thana.
- Inicialet e Delon.
- Mbetet në fund.
- Emër vajze.
- Mirashi që qe futbollist.
- Fillojnë largimin.
- Jean aktor.
- Eddie ish-pilot i Ferrari-t.
- Pak stabilitet.

VERTIKAL

- Derisa janë në fund.
- Fillojnë takimin.
- Në fillim të vitit.
- Inicialet e Aqulani-t.
- Lendi ish-tenist.
- Emri i Schwarzenegger.
- Maliq këngëtare.
- Mund të jenë bretkosë dhe butterfly në not.
- Trulli ish-pilot.
- Eshhtë gjarpër më syze.
- Ente Civile Tiranë.
- Scirea që qe as i Juventus.
- Mauricio te


Juventus.

- Ka rivale Mediaset.
- Një shtëpi botuse e jona.
- Ndërmarrje Autonome Berat.
- Zanore për kolopuç.
- Një gjigant me ski.
- Ekstreme në merak.
- Ajgenci Europiane Juridike

Një vend nisjeje.


- Eljero mesfushor holandez.
- Sampras ish tenist.
- Mbyllin portat.
- Fillojnë vlerësimin.
- Diftong në dietë.
- Mbyllin një koment.
- Dy anët e një elementi.
- Sapo fillojnë.
- Në krye të armatës.

PËRGJIGJA E FJALEKRYQIT SPORTIV



FJALEKRYQI PA SKEME

DUHET TË NXINI 34 KUTI



HORIZONTAL

- Një virtuel në computer.
- Guardiola trainer -Iosseliani regjisor.
- Eshhtë sundim shtypës.
- ... de Oro siç thihret Maradona.
- Nota e diapazonit.
- Eshhtë gjurmë... meteori.
- Qe mbretëri e Pirros.
- Një faze gjumi.
- Eshhtë emë uji.
- Qe filozof sofist.
- Incizlet e Magritte piktor.
- Mbarojnë farenë.
- Ishin pushtetë e Decablist.
- Vjedhin me dhunë.
- Pak elegante.
- Mbahen në bllok -Eshhtë pisku i vapës.
- Një sigël maunesh.
- Freeman aktor -Kështu filon filmi.
- Në krye të masave.
- Bukur pa binjaket.
- I ka tek stema

-Casillas portier.

- Gjysmë silure.
- Haan, ish-trainer i yni.
- Teste pa zanoze.
- Janë pronarët e anjeve.
- Një bënëje turke
- Eshhtë vulkan në Sicili
- Inicialet e Munch që qe piktor.
- Bisha aktore.
- Qe poet dhe filolog i lashtë grek.
- Fillojnë titrat

-Film i Jerry Zucker.

- Emri i Sinatra-s.
- Janë dhëmbët e parë.
- Qendër votimi.
- Janë simbol i skllaverisë.
- Eshhtë gjimnastikë me muzikë.
- Inicialet e Ljarja aktor
- Ishte një nga muzat.
- Janë nofkat.
- Janë shok armësh.
- Janë princër arabë.
- Memoria në computer
- Eshhtë sipend deti.

13. Luna regjisor.

- Diftong poetik.
- Mund të bëhet pilaf -Një T greke.
- Një figurë gjeometrike që tregon edhe... përafërsi.
- Një shok armësh.
- Janë princër arabë.
- Memoria në computer
- Eshhtë sipend deti.

VERTIKAL


- Thyhen me kohë më të mirë.
- Sahat pa kufij.
- Maria që qe mevo-soprano.
- Një sulm kardiak.
- Shpallet për të zhdukur.
- Janë për të lidhur të tillë.
- Skuadra merengue.
- Papas aktore.
- Ekstremë në studim.
- Fillojnë majtas.
- Reid aktore

PËRGJIGJA E FJALEKRYQIT PA SKEME



I KRIPTOGRAFUAR

SHKRONJA E NJËJTË PËR NUMËR TË NJËJTË



PËRGJIGJE E NUMRIT TË KALUAR



HOROSKOPI nga zonja MERI



DASHI
Sot do jetë një ditë më e këndshme dhe më e favorizueshme për sa i përket argetimit daljeve ferte dhe veprimtarisë tuaj krijuese. Më së shumti do keni një ndikim të mirë tek fëmijët si dhe do favorizoheni në cështje udhëtimi.



DEMI
Dita e sotme do jetë në vëmendjen tuaj si një ditë ku cështjet familjare do marrin zgjidhje apo më mirë do keni mundësinë të jeni më të qetë në këtë drejtim. Ana ekonomike shkon drejt një përmirësimi.



BINJAKET
Dita e sotme sa duket ka shumë mundësi të jetë e mirë për sa i përket takimeve kontaktive dhe planëve që mund të keni. Udhëtimet nuk mungojnë gjatë kësaj periudhe si edhe cështjet studimore apo tregëti, turizëm e shkrimi.



GAFORRJA
Për ju sot dita do jetë më e favorizuar ana ekonomike si edhe cështje të punës. Ka mundësi të merrni rritje page apo të merren parasysh kërkesat tuaja. Më të afërmit do vazhdoni të keni marrëdhënie të mira apo të merrni lajme të mira.



LUANI
Dita e sotme do sjell më shumë munsësi sin e jetën personale ashtu edhe në çdo veprimtari tuajën. Hëna do jetë në shenjë tuaj duke ju bërë më të gëzueshëm në një moment ku kishit filluar të ndjeheshit paksa të blokuar.



IRGJËRESHA
Dita e sotme për ju ndoshta sjell kujtimet e mira të një dite më parë ku sodo që të jetë punët ju duhet ta keni kaluar mirë apo të keni qënë në shoqërinë e njerzve të dashur që ju kanë dhënë më shumë besim.



PESHORJA
Dita e sotme për shenjë tuaj me hënë në shenjë tuaj sjell pranë jush më shumë miq shokë apo të afërm të cilët ju ndihmojnë në realizimin e qëllimeve tuaja. Mund të ndjeheni pak të pasigurt në aspektin sentimental.



AKREPI
Dita e sotme me hënë në shenjë tuaj e Luani jush jeli shanse për oferta të reja për sa i përket punës. Më mirë ndoshta do jetë edhe jeta personale ku ju mund të ndjeni shkëlqimin dhe afirmitetin e partnerëve tuaj.



SHIGJETARI
Dita e sotme do sjell ndryshime të mira në lidhje me planet tuaja. Keni udhëtime dhe takime të mira për cështje ligjore apo për kontrata të ndryshme. Në aspektin erotik do ndjeni afirmitetin e dikujt që punon me ju.



BRICJAPI
Dita e sotme me hënë në shenjë tuaj sjell disa cështje ekonomike të cilat do ju duhet ti shikoni me vëmendje. Mund të merrni edhe një lajm të mirë ekonomik i cili vjen nga bashkëpunimet që mund të keni.




UJORI
Dita e sotme nën ndikimin e hënës përball jush do jetë nën efektin e mendimit që për të tjerët nuk keni bërë aq sa duhet dhe si rrjedhim i kësaj do bëni një përpjekje për të përmirësuar marrëdhënet.




PESHQIT
Dita e sotme mbas shumë përpjekjesh do ju jap guxim të merrni vendime për një ndryshim që lidhet me punën apo me një investim që mund të shihet si një fillim i ri në çështje të punës tuaj. Mund të merrni edhe me pamjen tuaj të jashtme.

SUDOKU



PËRGJIGJE E NUMRIT TË KALUAR



LAJME
NGA BOTA

■ Jakup Krasniqi:
Nuk iki nga PDK

Vetëm pak ditë pasi tha se refuzon të jetë pjesë e Kryesisë së Partisë Demokratike të Kosovës, kryeparlamentari i Kosovës, Jakup Krasniqi, u ka dhënë fund pyetjeve nëse do ta braktisë PDK-në për ndonjë parti tjetër. Ish-sekretari i deritanishëm i PDK-së i ka quajtur të pavërteta pretendimet se ai mund të kalojë në ndonjë parti tjetër. "Unë nuk kam ç'të shtoj për atë që e kam thënë, veç një gjë mund t'ju sqaroj që nuk mendoj të ndërroj subjektin politik për subjekt politik", ka deklaruar Krasniqi.

■ Benedikti XVI ndryshon rregullat e konklavës

Papa Benedikti XVI urdhëroi ndryshimin e rregullave shekullore të Kishës Katolike mbi datat dhe procedurën e mbledhjes së kardinalëve, të cilët do të zgjedhin pasardhësin e tij. Ndryshimi i rregullave u bë me synim që të përshpejtohet zgjedhja e një Pape të ri. Në bazë të këtij amendimi, kardinalët nuk do të jenë të detyruar të presin 15 ditë, pasi Benedikti XVI të largohet nga funksioni. Dorëheqja e parajlmëruar e Atit të Shenjtë të Romës do të hyjë në fuqi në datën 1 mars dhe konklava (mbledhja e kardinalëve në ambientet e Vatikanit), tashmë mund të mbahet përpara 15 marsit.

■ SHBA: Bërthmoret, në duart e iranianëve

Kreu i Departamentit amerikan të Shtetit, John Kerry deklaroi dje lidhur me dosjen bërthamore iraniane se "aktualisht zgjedhja ishte në duart e palës iraniane dhe se kjo e fundit duhet të zgjidhte rrugën e duhur për një zgjidhje të çështjes në fjalë. "Zgjedhja aktualisht ndodhet në fushën e iranianëve dhe urojmë që këta të fundit të ndërmarin itinerarin e duhur për zgjidhjen e çështjes së dosjes bërthamore të Teheranit", theksoi sekretari amerikan i Shtetit, John Kerry, ku i referohej programit bërthamor të Iranit, gjatë një konference të zhvilluar në Londër pas një takimi me homologun e tij, kryediplomatit britanik, William Hague.

■ Rikthehet tensioni në territoret palestineze

Funerali i një palestinezi, i cili ndërroi jetë ndërsa mbahej i burgosur në një burg izraelit ditën e shtunë riktheu tensionet në Rripin e Gazës. Në funeralin e nisur mëngjesin e së hënës, me dhjetëra mijëra palestinezë protestuan dhe hodhën slogane anti-izraelite në qytete të ndryshme të Palestinës. Manifestimi u karakterizua nga përfshije me forcat izraelite në disa vatra të ndryshme protestash në Gazë dhe rrethina.

■ Izraeli teston sistemin anti-raketë

Ministria Izraelite e Mbrojtjes lajmëroi ditën e hënës për kryerjen e suksesshme të testimit të një raketë të re të sofistikuar, e cila është në gjendje të shkatërrojë në ajër raketat që drejtohen kundër Izraelit. "Shigjeta 3" përdor një teknologji të avancuar për të shënjestruar një raketë ardhëse dhe për ta shkatërruar në ajër, përpara se raketa të rifutet në atmosferën e Tokës.

■ Presidenti i ri i Qipros

Me 100% të votave të numëruara në raundin e dytë të votimeve, Nikos Anastasiades konfirmohet si Presidenti i ri i Qipros. 66-vjeçari, një prej figurave kryesore të qendrës së djathtë të ishullit me 1.2 milionë banorë, fitoi 57.47% të preferencave. Kundërshtari i tij, Stavros Malas, një kandidat i pavarur i mbështetur nga komunistët e "Akel"-it, grumbulloi 42.53% të votave.

DIGITALB

TOKESORE
KANALI 48

Do na ndiqni në gjithë Shqipërinë

DIGITALB

SATELITOR
KANALI 50

Do na ndiqni në gjithë Shqipërinë, Maqedoni, Kosovë, Itali, Greqi dhe në pjesën tjetër të Europës

VALË UHF

NË PREFEKTURAT:
TIRANE - DURRES - LEZHE - FIER



kasketa

nga KASTRO ZIZO

cdo të mërkurë
dhe të shtunë
ora 23:00

NË TELEVISIONIN

A1 REPORT!

Origjina e Lajmit

• Alba Malltezi
Drejtores e Përgjithshme
e Free and Fair Media Group

• Anila Basha
Drejtores e Shqiptarja.com
• Arben Rozhani
Kryeredaktor

• Genc Kondi
Zv. Kryeredaktor

Politika: Jakin Marena
Ekonomia: Genc Kondi
Sociale: Esmeralda Keta
Kulturë: Admirina Peçi

Design: Altin Aliaj
Genti Manelli
Website: Suela Gera
Indrit Maraku

Departamenti i Marketingut:
Cel: +355696060419
marketing@shqiptarja.com

Shpërndarja:
Saimir Zenelaj
cel: +355696060418
Ermal Kacaniku
cel: +355696088847